



# ANALIZA VJETORE

E PERFORMANCËS SË  
SHËRBIMIT PËRMBARIMOR  
GJYQËSOR SHTETËROR

## 2025



Tiranë, Janar 2026

Sheshi “Mustafa Qemal Atatürk”

[www.dpp.gov.al](http://www.dpp.gov.al)



**ANALIZA VJETORE  
E PERFORMANCËS  
2025**

**SHËRBIMI PËRMBARIMOR GJYQËSOR  
SHTETËROR**

## **TABELA E PËRMBAJTJES**

- 1. Hyrje**
- 2. Misioni / Vizioni i Drejtorit të Përgjithshëm të Përmbarimit**
- 3. Kuadri ligjor dhe struktura organizative e DPP-së**
  - 3.1 Baza ligjore;
  - 3.2 Struktura organizative e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror;
  - 3.3 Akte që lidhen me veprimtarinë inspektuese, administrative dhe procedurale;
  - 3.4 Infrastruktura dhe logjistika.
- 4. Verifikimi i Ankesave, hetimi administrativ dhe inspektimi**
  - 4.1 Ankesa të depozituara pranë DPP;
  - 4.2 Shqyrtimi dhe verifikimi i ankesave;
  - 4.3 Hetimi disiplinor;
  - 4.4 Propozime për procedim disiplinor dhe vendimet e Këshillit Përmbarimor/Drejtorit të Përgjithshëm;
  - 4.5 Inspektimet tematike dhe inspektimet e përgjithshme;
  - 4.6 Problematikat lidhur me mosekzekutimin e titujve ekzekutivë;
  - 4.7 Rekomandimi i inspektimeve;
  - 4.8 Monitorimi i rekomandimeve.
- 5. Bashkëpunimi ndërinstitutional kombëtar dhe ndërkombëtar**
  - 5.1 Bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë;
  - 5.2 Bashkëpunimi me institucionet qendrore dhe lokale;
  - 5.3 Bashkëpunimi me organizatat kombëtare/ndërkombëtare dhe donatorët;
  - 5.4 Raportimet e DPP-së në kuadër të strategjive ndërsektoriale.
- 6. Organizimi i Brendshëm i SHPGJSH**
  - 6.1 Drejtimi administrativ i Zyrave Vendore Përmbarimore;
  - 6.2 Transferime të përkohshme;
  - 6.3 Transferime të përhershme;
  - 6.4 Komandime si inspektor në Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbarimit;
  - 6.5 Rekrutimi i përmbaruesve gjyqësorë shtetërorë dhe punonjësve me Kod Pune;
  - 6.6 Veprimtari në kuadër të rritjes së kapaciteteve të stafit;
  - 6.7 Përmbarusit gjyqësorë shtetërorë në periudhë prove;
  - 6.8 Procesi i vlerësimit fillestar dhe i vazhdueshëm i përmbaruesve gjyqësorë shtetërorë, sipas parashikimeve në dispozitat e Ligjit nr. 8./2023;

## **7. Transparenca dhe marrëdhëniet me publikun**

- 7.1 E drejta e informimit;
- 7.2 Kordinatori për të Drejtën e Informimit;
- 7.3 Komunikimi me masmedian;
- 7.4 Rrjetet sociale. FC/INSTA;
- 7.5 Edukimi Ligjor si mënyrë komunikimi.

## **8. Analiza Financiare**

- 8.1 Shpenzimet buxhetore. Realizimet buxhetore;
- 8.2 Të ardhurat buxhetore.

## **9. Statistikat e dosjeve të ekzekutuara nga çdo përmbarues gjyqësor dhe nga çdo Zyrë Vendore Përmbare**

- 9.1 Statistikat për çdo zyrë\Statistikat për çdo përmbarues.
- 9.2 Vërtetimet e detyrimeve dhe vërtetimet e pensioneve ushqimore.

## **10. Përmbledhje e Arritjeve për vitin 2025**

## **11. Objektivat për vitin 2026**

### **Lista e Shkurtimeve**

- Agjencia Shtetërore e Kadastrës – ASHK
- Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit – DPP
- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor - DPSHTRR
- Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit - IKMT
- Ministria e Drejtësisë – MD
- Shkolla Shqiptare e Administratës Publike – ASPA
- Shërbimi Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror - SHPGJSH
- Zyrtat Përmbartimore – ZP

## 1. HYRJE

Analiza e Performancës Vjetore të Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror për vitin 2025 paraqet një vlerësim të përgjithshëm të veprimtarisë institucionale, rezultateve të arritura dhe sfidave të evidentuara gjatë këtij viti, në funksion të përmbushjes së misionit ligjor për ekzekutimin e titujve ekzekutivë dhe garantimin e një procesi të rregullt ligjor. Kjo analizë mbështetet në të dhënat zyrtare statistikore, raportimet periodike të zyrave përmbartimore dhe zhvillimet kryesore ligjore, organizative dhe financiare të institucionit.

Gjatë vitit 2025, Shërbimi Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror ka ushtruar veprimtarinë e tij në përputhje me Ligjin nr. 8/2023 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror”, duke vijuar procesin e konsolidimit institucional pas hyrjes në fuqi të kuadrit të ri ligjor. Në këtë kuadër, janë ndërmarrë masa për përmirësimin e organizimit të brendshëm, rritjen e efikasitetit operacional dhe forcimin e mekanizmave të kontrollit dhe mbikëqyrjes.

Performanca e shërbimit gjatë vitit 2025 karakterizohet nga rritja e numrit të çështjeve përmbartimore të ekzekutuara tërësisht, krahasuar me vitet paraardhëse, si dhe nga përmirësimi i treguesve financiarë, të reflektuar në rritjen e të ardhurave të derdhura në buxhetin e shtetit. Këto rezultate lidhen me intensifikimin e veprimtarisë përmbartimore, menaxhimin më aktiv të dosjeve në ekzekutim dhe orientimin e zyrave përmbartimore drejt përmbushjes së objektivave të përcaktuara në planifikimet institucionale.

Në periudhën Janar – Dhjetor 2025 janë derdhur në buxhetin e shtetit **120,841,555 lekë**. Krahasuar me periudhën Janar – Dhjetor 2024, të ardhurat janë rritur me **24,671,627 lekë**, pasi në vitin 2024 të ardhurat e derdhura në buxhet kanë qenë **96,169,928 lekë**.

Në periudhën Janar– Dhjetor 2024 janë ekzekutuar tërësisht 7012 dosje përmbartimore, ndërsa në periudhën **Janar – Dhjetor 2025 janë ekzekutuar tërësisht 8896** dosje përmbartimore. Pra numri i dosjeve përmbartimore të ekzekutuara tërësisht është rritur me 1884 dosje më shumë se viti 2024.

Paralelisht, gjatë vitit 2025 janë miratuar një sërë aktesh nënligjore dhe dokumentesh strategjike, përfshirë Planin e Zhvillimit të SHPGJSH dhe Planin e Punës për uljen e numrit të dosjeve përmbartimore të mbartura, Planin e Integritetit të SHPGJSH, të cilat synojnë rritjen e efikasitetit, transparencës dhe standardizimit të praktikave përmbartimore. Gjithashtu, janë ndërmarrë hapa për forcimin e funksionit inspektues, rritjen e kapaciteteve profesionale të stafit dhe përmirësimin gradual të infrastrukturës së zyrave përmbartimore.

Në kuadër të vlerësimit të performancës, në analizë pasqyrohen edhe të dhënat mbi shqyrtimin e ankesave dhe kontrolleve të ushtruara në veprimtarinë procedurale dhe administrative të përmbartuesve gjyqësorë shtetërorë. Si rezultat i kontrolleve të ushtruara, në rastet kur janë konstatuar shkelje disiplinore është vendosur fillimi i hetimit disiplinor ndaj përmbartuesve gjyqësorë shtetërorë, dhe në përputhje me Ligjin nr. 8/2023 janë marrë masa disiplinore përkatëse.

Në përfundim, kjo analizë për vitin 2025 synon të ofrojë një vlerësim objektiv dhe gjithëpërfshirës të veprimtarisë së Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror, duke identifikuar arritjet, të dhënat statistikore, problematikat dhe objektivat prioritare për vitin 2026.

## **2. MISIONI /VIZIONI I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË PËRMBARIMIT**

Misioni i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror është të sigurojë funksionimin e një shërbimi përmbarimor efikas, të ligjshëm, të paanshëm dhe transparent, i cili garanton zbatimin e vendimeve gjyqësore dhe titujve ekzekutivë në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke respektuar të drejtat dhe liritë themelore të palëve.

Nëpërmjet drejtimit strategjik, mbikëqyrjes dhe forcimit të kapaciteteve institucionale, synohet rritja e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, përmirësimi i cilësisë së shërbimit dhe garantimi i një ekzekutimi efektiv dhe proporcional të detyrimeve ligjore.

Vizioni i Drejtorit të Përgjithshëm është ndërtimi i një Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror modern, profesional dhe të besueshëm, i mbështetur në integritet, përgjegjshmëri dhe transparencë.

Në këtë kuadër, synohet:

- konsolidimi i rolit të shërbimit përmbarimor si hallkë thelbësore e funksionimit të shtetit të së drejtës, nëpërmjet forcimit të kuadrit ligjor rregullator;
- rritja e eficiencës së ekzekutimit të vendimeve gjyqësore;
- forcimi i mekanizmave të kontrollit dhe inspektimit;
- digjitalizimi i proceseve përmbarimore nëpërmjet hedhjes së të dhënave përmbarimore në sistemin ALBIS;
- zhvillimi fillestar dhe i vazhdueshëm i trajnimeve të përmbaruesve gjyqësorë shtetërorë;
- garantimi i një balancimi të drejtë ndërmjet interesave të kreditorëve dhe mbrojtjes së të drejtave të debitorëve.

Përveç ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, shërbimi përmbarimor gjyqësor shtetëror ushtron edhe funksione të tjera në mbështetje të ligjit nr. 8/2023 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror”, përfshirë:

- njoftimin e akteve gjyqësore dhe dokumenteve zyrtare;
- mbledhjen e detyrimeve financiare në mënyrë vullnetare me mirëkuptim, me kërkesë të të interesuarve;
- konstatimin e fakteve, sendeve apo dukurive lehtësisht të verifikueshme, pa njohuri specifike teknike, sipas legjislacionit në fuqi, me kërkesë të të interesuarve;
- shitja e sendeve në ankand publik, me kërkesë të të interesuarve.

Drejtimi i institucionit është zhvilluar mbi baza të qarta të ligjshmërisë, përgjegjshmërisë, transparencës dhe përmirësimit të vazhdueshëm. Objektivat e ndjekura gjatë këtij viti dhe në vijim janë në përputhje me strategjitë ndërsektoriale të drejtësisë, ku Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit është institucion përgjegjës dhe kontribues.

## **DREJTORI I PËRGJITHSHËM I PËRMBARIMIT**

**Z. ERGYS QIRICI**

### **3. KUADRI LIGJOR DHE STRUKTURA ORGANIZATIVE E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PËRMBARIMIT.**

#### **3.1 BAZA LIGJORE**

- Ligji nr.7961, datë 12.07.1995, Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar;
- Ligji nr. 8/2023 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror”;
- Ligji nr. 49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 79/2020 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”;
- Ligji nr. 9969/2020 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar;
- Ligji nr.8678 datë 14.05.2001 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”;
- Urdhër nr. 432, datë 30.06.2023 i Ministrit të Drejtësisë “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për organizimin, zhvillimin, përmbajtjen e provimit të pranimit, si dhe procedurën e vlerësimit të shpalljes së rezultateve për përmbaruesin gjyqësor shtetëror”;
- Urdhër nr. 433, datë 30.06.2023 i Ministrit të Drejtësisë “Për përcaktimin e rregullave për organizimin dhe përmbajtjen e programit të trajnimit, pjesëmarrjen në trajnime, si dhe testimin e njohurive të përfituara për përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë në periudhë prove”;
- Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”;
- Udhëzim nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar;
- Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Udhëzimit të Ministrisë së Financave, Nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 115/2024 “Për Buxhetin e vitit 2025”;
- Udhëzimi i Përbashkët Nr.1276/5, datë 27.07.2017 “Për Përcaktimin e Tarifave për Shërbimet e Ofruara nga Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror”, i ndryshuar me Udhëzimin e Përbashkët Nr.32, datë 30.08.2018 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e Përbashkët Nr.1276/5, datë 27.07.2017 “Për Përcaktimin e Tarifave për Shërbimet e Ofruara nga Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror”;
- Ligji nr. 92/2014 “Mbi Tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH”;
- Ligji nr. 87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”;
- Ligji nr. 9975 datë 28.7.2008 “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar;
- Urdhër nr.6 datë 30.06.2023 "Për caktimin e rregullave të hollësishme për procedurën e komandimit të përmbaruesit gjyqësor";
- Urdhër nr.432 datë 30.06.2023 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për organizimin, zhvillimin, përmbajtjen e provimit të pranimit, si dhe procedurën e vlerësimit të shpalljes së rezultateve për përmbaruesin gjyqësor shtetëror”;
- Urdhër nr. 475, datë 20.07.2023 “Për miratimin e formës së dokumentit të identifikimit të përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë”;
- Urdhër nr. 433, datë 30.06.2023 “Për përcaktimin e rregullave për organizimin dhe përmbajtjen e programit të trajnimit, pjesëmarrjen në trajnime, si dhe testimin e njohurive të përfituara për përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë në periudhë prove”;

- Urdhër nr.447, datë 10.07.2023 “Për përcaktimin e numrit të përgjithshëm të përmbauesve gjyqësorë të shërbimit të përmbaimit gjyqësor shtetëror”;
- Urdhër nr.434 datë 30.06.2023 “Për përcaktimin e rregullave me të detajuara për kriteret dhe procedurat për dhënien e lejes së papaguar për përmbauesin gjyqësor shtetëror”;
- Udhëzimi i përbashkët nr.3 datë 16.04.2024, nëpërmjet Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Brendshëm “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për kriteret, procedurën dhe mënyrën e bashkëpunimit dhe mbështetjes së përmbauesve gjyqësorë shtetërorë nga Policia e Shtetit”;
- Urdhri nr.333, datë 18.06.2024 “Për miratimin e programit të formimit vazhdues për përmbauesit gjyqësorë shtetërorë”;
- Udhëzimi nr. 4, datë 18.06.2024 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për procedurën dhe afatet e dorëzimit të dokumentacionit nga përmbauesi gjyqësor shtetëror”;
- Urdhër nr. 167, datë 25.03.2024 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Përmbaimit”;
- Udhëzimi nr. 1, datë 25.03.2024 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të përmbauesit gjyqësor shtetëror”.
- Urdhër nr.334 datë 18.06.2024 “Për miratimin e marrëveshjes tip për mbledhjen e tarifës së suksesit nga shërbimi përmbaimit shtetëror”;
- Udhëzimi i përbashkët nr. 3, datë 15.7.2025 “Për përcaktimin e masës së tarifës fikse të veprimit përmbaimit, llojet e veprimeve përmbaimore të tarifuara dhe rastet e përjashtimit nga parapagimi i tarifës për kategori të caktuara”;
- Udhëzim i përbashkët nr. 4, datë 15.7.2025 “Për përcaktimin e nivelit minimal dhe maksimal të zbatimit të vlerës së tarifës së suksesit për veprimet përmbaimore të ofruara nga Shërbimi Përmbaimit Gjyqësor Shtetëror”;
- Urdhër i përbashkët nr. 444, datë 15.7.2025 “Për përcaktimin e ndarjes së të ardhurave, kriterëve e procedurave të administrimit dhe shpërndarjes së të ardhurave”;
- Urdhër nr. 644, datë 31.10.2025 të Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbaimit”;
- Vendim i KM nr. 563, datë 14.7.2010 Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të hollësishme të bashkëpunimit të shërbimit përmbaimit me Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, si dhe pagesën përkatëse për shërbimin e përmbaimit - Ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 626, datë 7.9.2011;
- VKM nr. 590, datë 7.9.2022 “Për mënyrën e mbajtjes së regjistrit Qendror të Kërkesave për vënie në ekzekutim të urdhrave të ekzekutimit dhe ndërveprimit me bazat e tjera të të dhënave shtetërore”;
- Udhëzim i KM nr. 5, datë 12.12.2012 Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për zhvillimin e ankandit nga përmbauesi gjyqësor;
- Urdhër nr. 128 datë 14.10.2025 është miratuar “Metodologjia e vlerësimit të kandidatëve për punonjës pranë Shërbimit Përmbaimit Gjyqësor”;
- Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2024–2030;
- Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë për të Mitur 2022 - 2026;
- Strategjia Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024 - 2030.

### **3.2 STRUKTURA ORGANIZATIVE E SHËRBIMIT PËRMBARIMOR GJYQËSOR SHTETËROR.**

#### **✓ Miratimi i Strukturës së re Organizative të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit**

Gjatë vitit 2025, struktura organizative e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror ka pësuar ndryshime në funksion të rritjes së eficiencës institucionale, forcimit të mekanizmave të drejtimit dhe mbikëqyrjes, si dhe përshtatjes me nevojat reale të veprimtarisë përmbarimore.

Me Urdhër nr. 117, datë 26.08.2025 të Kryeministrit “Për disa ndryshime në Urdhrin nr. 222, datë 14.12.2023 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor Shtetëror””, u miratua ristrukturimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit, bazuar në një vlerësim të funksionimit praktik të strukturës ekzistuese.

Ristrukturimi i miratuar synoi adresimin e problematikave të evidentuara gjatë zbatimit të ligjit nr. 8/2023, veçanërisht në drejtim të ndarjes së qartë të kompetencave, shmangies së mbivendosjes së funksioneve dhe forcimit të kapaciteteve drejtuese, administrative dhe inspektuese. Ndryshimet strukturore u orientuan drejt krijimit të një organizimi më funksional dhe të balancuar ndërmjet sektorëve të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit.

Në këtë kuadër, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit u ristrukturua me funksione të përforcuara drejtimi, koordinimi, monitorimi dhe kontrolli, duke mbajtur përgjegjësinë për mbikëqyrjen e zyrave përmbarimore vendore, menaxhimin e burimeve njerëzore, administrimin financiar dhe ushtrimin e kompetencave disiplinore, sipas parashikimeve të ligjit.

Në strukturën e re të DPP-së, janë të ndara qartë funksionet inspektuese nga ato administrative dhe mbështetëse.


Ristrukturimi nuk solli asnjë ndryshim në organizimin e zyrave vendore përmbarimore. Të 22 zyrat vendore përmbarimore vazhdojnë të funksionojnë me të njëjtën strukturë dhe organikë ekzistuese, pa efekte në përbërjen, kompetencat apo përgjegjësitë e tyre. Ndryshimet e parashikuara janë të kufizuara vetëm në nivelin qendror dhe synojnë rritjen e eficiencës administrative dhe koordinimit institucional, pa prekur funksionimin e strukturave territoriale.

Kjo ndarje e brendshme nuk solli efekte financiare, pasi nuk u krijuan pozicione të reja, por vetëm u riemërtuan dhe u riorganizuan pozicione ekzistuese.

Nga këndvështrimi i analizës së performancës, ristrukturimi i miratuar gjatë vitit 2025 përbën një zhvillim me ndikim të drejtpërdrejtë në eficiencën e shërbimit përmbarimor, pasi synon të përmirësojë kapacitetin e institucionit për të planifikuar, monitoruar dhe vlerësuar veprimtarinë përmbarimore, si dhe për të reaguar në mënyrë më efektive ndaj shkeljeve procedurale dhe disiplinore. Ndryshimet strukturore krijojnë një bazë më të qëndrueshme organizative për rritjen e cilësisë së shërbimit, forcimin e kontrollit të brendshëm dhe përmirësimin e rezultateve në ekzekutimin e titujve ekzekutivë.

Me Urdhrin nr. 447, datë 10.07.2023 të Ministrit të Drejtësisë, është përcaktuar numri i përgjithshëm i përmbauesve gjyqësorë shtetërorë në 144. Në këtë kontekst, si dhe me miratimin e buxhetit për vitin 2026, evidentohet nevoja për rishikim të strukturës së përgjithshme të Shërbimit Përmbaues Gjyqësor Shtetëror, me qëllim përshtatjen e saj me veprimtarinë procedurale dhe administrative të zyrave përmbauese vendore. Për vitin 2026 parashikohet paraqitja e propozimeve për ndryshimin e strukturës organizative, duke synuar shtimin e numrit të përmbauesve gjyqësorë shtetërorë dhe të personelit mbështetës, si dhe shpërndarjen e tyre në zyrat përmbauese vendore, në bazë të nevojave konkrete dhe ngarkesës faktike të punës.

### **ORGANIGRAMA E SHËRBIMIT PËRMBARIMOR GJYQËSOR SHTETËROR**



**Struktura organizative në Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbaimit përbëhet si më poshtë:**

- a) Drejtori i Përgjithshëm;
- b) Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm/Drejtori i Inspektimit
- c) Drejtori i Drejtorisë;
- ç) Përgjegjës Sektori;
- d) Inspektor;
- dh) Specialist;
- e) Punonjës administrativ.

**Struktura organizative e 22 zyrave vendore përmbauese, përbëhet si më poshtë:**

- a) Kryetari i zyrës përmbauese;
- b) Përmbauesit gjyqësorë shtetërorë;
- c) Personeli administrativ dhe teknik.

**Në total, shërbimi përmbarimor gjyqësor shtetëror në nivel vendor është i organizuar në 22 zyra vendore përmbarimore:**

- Zyra Përmbarimore Tiranë;
- Zyra Përmbarimore Durrës;
- Zyra Përmbarimore Shkodër;
- Zyra Përmbarimore Elbasan;
- Zyra Përmbarimore Kavajë;
- Zyra Përmbarimore Lushnjë;
- Zyra Përmbarimore Krujë;
- Zyra Përmbarimore Kurbin;
- Zyra Përmbarimore Lezhë;
- Zyra Përmbarimore Berat;
- Zyra Përmbarimore Fier;
- Zyra Përmbarimore Vlorë;
- Zyra Përmbarimore Gjirokastrë;
- Zyra Përmbarimore Sarandë;
- Zyra Përmbarimore Përmet;
- Zyra Përmbarimore Mat;
- Zyra Përmbarimore Dibër;
- Zyra Përmbarimore Kukës;
- Zyra Përmbarimore Tropojë;
- Zyra Përmbarimore Pukë;
- Zyra Përmbarimore Pogradec;
- Zyra Përmbarimore Korçë.

Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror funksionon sipas strukturës organizative, të miratuar me urdhër të Kryeministrit.

Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror varet nga Ministri i Drejtësisë dhe organizohet në nivel qendror, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit, dhe në nivel vendor, 22 zyrat vendore përmbarimore. Zyrat vendore përmbarimore varen administrativisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit.

Marrëdhënia e punës për përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë rregullohet sipas dispozitave të Ligjit nr. 8/2023 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror”.

Marrëdhënia e punës për nëpunësit e administratës, personelin administrativ dhe teknik të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit dhe zyrave vendore përmbarimore rregullohet sipas dispozitave të Kodit të Punës.

### 3.3 AKTE QË LIDHEN ME VEPRIMTARINË INSPEKTUESE, ADMINISTRATIVE DHE PROCEDURALE

Gjatë vitit 2025, Shërbimi Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror ka vijuar konsolidimin e kuadrit nënligjor dhe administrativ, me qëllim rritjen e eficiencës, standardizimin e praktikave dhe forcimin e mekanizmave të kontrollit, transparencës dhe integritetit institucional.

Në këtë kuadër, në zbatim të Ligjit nr. 8/2023 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror” janë miratuar akte nënligjore me ndikim të drejtpërdrejtë në veprimtarinë përmbartimore, të cilat kanë rregulluar aspektet tarifore, financiare dhe organizative të shërbimit. Miratimi i udhëzimeve të përbashkëta për tarifën fikse dhe tarifën e suksesit ka garantuar qartësi, trajtim të njëjtë të palëve. Ndërkohë, urdhri i përbashkët për administrimin dhe shpërndarjen e të ardhurave ka forcuar kontrollin financiar dhe transparencën në menaxhimin e fondeve. Po ashtu, miratimi i rregullores së organizimit dhe funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit ka përcaktuar qartë rolet dhe kompetencat e sektorëve dhe drejtorive.

Paralelisht, gjatë vitit 2025 janë miratuar akte administrative të brendshme me karakter planifikues, organizativ dhe metodologjik, të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e funksionimit të SHPGJSH-së. Miratimi i Planit të Zhvillimit dhe i Planit të Punës për uljen e dosjeve përmbartimore të mbartura për periudhën 2025–2030 ka orientuar veprimtarinë drejt objektivave konkrete për rritjen e eficiencës dhe reduktimin e stokut të çështjeve të prapambetura.

Në drejtim të forcimit të funksionit inspektues, janë miratuar Metodologjia e Inspektimit, formulari i kontrollit të dosjes përmbartimore dhe kartela shoqëruese e praktikave administrative, duke unifikuar procedurat e kontrollit dhe standardizuar dokumentacionin administrativ. Gjithashtu, miratimi i Planit të Integritetit 2025–2027 ka kontribuar në parandalimin e shkeljeve, forcimin e etikës profesionale dhe rritjen e besimit publik.

Gjatë vitit 2025 janë marrë masa edhe për garantimin e ligjshmërisë së veprimtarisë institucionale në situata të veçanta, përfshirë monitorimin e përdorimit të burimeve gjatë procesit zgjedhor dhe menaxhimin e burimeve njerëzore përmes planifikimit të pushimeve vjetore.

Në përfundim, aktet e miratuara gjatë vitit 2025 kanë krijuar një bazë më të qëndrueshme ligjore dhe administrative për ushtrimin e veprimtarisë përmbartimore, duke kontribuar në rritjen e performancës, transparencës dhe standardeve profesionale të Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror.

Ndërkohë, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit ka dërguar kontributin e saj mbi ndryshimin e Ligjit nr. 111/2017, për përfitimin e ndihmës juridike falas sa i përket përjashtimit të pagimit të shpenzimeve përmbartimore për ekspert psikolog gjatë ekzekutimit të vendimeve gjyqësore me objekt “takim fëmije” dhe “lënie fëmije në kujdestari”.

### **Propozime për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8/2023**

Në kuadër të përgatitjes së projektprogramit të përgjithshëm analitik të projektakteve për Ministrinë e Drejtësisë për vitin 2026, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit ka përcjellë propozime për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8/2023 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror”. Qëllimi i këtij propozimi është përmirësimi i kuadrit ligjor që rregullon veprimtarinë e shërbimit përmbartimor shtetëror, në drejtim të forcimit të funksionimit institucional, rritjes së transparencës dhe sigurimit të një administrimi më efikas dhe të paanshëm të procedurës së ekzekutimit. Ndryshimet e propozuara synojnë qartësimin e dispozitave ligjore që lidhen me caktimin dhe lirimin nga detyra të drejtuesve të zyrave përmbartimore, saktësimin e procedurave për vlerësim, shpërblim dhe përgjegjësi disiplinore të përmbartuesve, garantimin e barazisë ndërmjet kreditorit dhe debitorit në të drejtën për informim, korrigjimin e pasaktësive terminologjike dhe harmonizimin e kompetencave ndërmjet Drejtorit të Përgjithshëm të Përmbartimit, Këshillit të Përmbartimit dhe Ministrit të Drejtësisë. Objektivi kryesor është përmirësimi i shërbimit përmbartimor gjyqësor shtetëror bazuar në profesionalizëm, përgjegjësi, integritet dhe efikasitet, në përputhje me parimet e ligjshmërisë, transparencës dhe standardet evropiane të administratës publike.

### **Akte nënligjore të miratuara në vitin 2025**

- ✓ Në zbatim të Ligjit nr. 8/2023 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror”, për vitin 2025 janë miratuar aktet nënligjore si vijon:

**Udhëzimi përbashkët nr. 3, datë 15.7.2025 “Për përcaktimin e masës së tarifës fikse të veprimit përmbartimor, llojet e veprimeve përmbartimore të tarifuar dhe rastet e përjashtimit nga parapagimi i tarifës për kategori të caktuara”;**

**Udhëzim i përbashkët nr. 4, datë 15.7.2025 “Për përcaktimin e nivelit minimal dhe maksimal të zbatimit të vlerës së tarifës së suksesit për veprimet përmbartimore të ofruara nga Shërbimi Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror”;**

**Urdhër i përbashkët nr. 444, datë 15.7.2025 “Për përcaktimin e ndarjes së të ardhurave, kritereve e procedurave të administrimit dhe shpërndarjes së të ardhurave”;**

**Me Urdhër nr. 644, datë 31.10.2025 të Ministrit të Drejtësisë është miratuar Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit.**

#### **Akte administrative të miratuara në vitin 2025**

Për vitin 2025 janë miratuar akte administrative të brendshme nga Drejtori i Përgjithshëm i Përmbarimit, me karakter planifikues dhe organizativ, si vijon:

- Urdhër nr. 216/2 Prot., nr. 28, datë 07.03.2025 “Për miratimin e Planit të Zhvillimit të Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror”;
- Urdhër nr. 159/3 Prot., nr. 68, datë 20.06.2025 “Për miratimin e Metodologjisë së Inspektimit të Veprimtarisë së Përmbaruesve Gjyqësorë Shtetërorë”;
- Urdhër nr. 810 Prot., nr. 62, datë 12.06.2025 “Për miratimin e Planit të Punës të SHPGJSH për uljen e numrit të dosjeve përmbarimore të mbartura 2025 – 2030”;
- Urdhër nr. 1437 Prot., nr. 153, datë 26.11.2025 “Për miratimin e Kartelës Shoqëruese të praktikave të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit dhe procedurave administrative të hartimit të shkresave sipas kërkesave ligjore”;
- Urdhër nr. 1402 Prot., nr. 148, datë 13.11.2025 “Për miratimin e Planit të Integritetit të Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror 2025 – 2027”;
- Urdhër nr. 964 Prot., nr. 81, datë 15.07.2025 “Për miratimin e formularit të Kontrollit për inspektimin e dosjes përmbarimore”;
- Urdhër nr. 1321/1 Prot., nr. 137, datë 27.10.2025 “Për monitorimin e veprimtarisë së sjelljes apo përdorimit të Burimeve Njerëzore, Financiare dhe Logjistike të Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme vendore për Kryetar në Bashkitë Berat, Tepelenë, Cërrik, Mat dhe Vlorë, të datës 9 Nëntor 2025”;
- Urdhër nr. 720 Prot., nr. 55, datë 19.05.2025 “Për planifikimin e miratimin e pushimeve vjetore, të paguara, për nëpunësit dhe punonjësit në Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbarimit për vitin 2025”;
- Urdhër nr. 128 datë 14.10.2025 “Metodologjia e vlerësimit të kandidatëve për punonjës pranë Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor”.
- Urdhër nr. 171 datë 15.12.2025 për miratimin e Rregullores “Për parandalimin e konfliktit të interesit dhe për deklarimin e pasurive në Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror”.
- Urdhër nr. 170 datë 15.12.2025 për miratimin e Rregullores “Për mbrojtjen, përpunimin dhe sigurinë e të dhënave personale në Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror”.

✓ **Me Urdhër nr. 216/2 Prot., nr. 28, datë 07.03.2025 të Drejtorit të Përgjithshëm të Përmbarimit është miratuar Plani i Zhvillimit të Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror për vitin 2025.**

**Plani i  
Zhvillimit  
të  
SHPGJSH  
2025**

- Masat e parashikuara në këtë plan rrjedhin nga objektivat dhe prioritetet e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024-2030 dhe synojnë përmirësimin e eficiencës, transparencës dhe mbikëqyrjes në Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror. Plani fokusohet në forcimin e kapaciteteve profesionale, rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe adresimin e sfidave në zbatimin e titujve ekzekutivë, me qëllim ofrimin e një shërbimi më të aksesueshëm dhe efektiv për qytetarët, në përputhje me standardet më të mira.

- ✓ Me Urdhër nr. 810 Prot., nr. 62, datë 12.06.2025 të Drejtorit të Përgjithshëm të Përmbarimit është miratuar **Plani i Punës i SHPGJSH për uljen e numrit të dosjeve përmbarimore të mbartura 2025 – 2030**, të cilit i bashkëlidhet edhe Pasaporta e Treguesve. Ky dokument është hartuar në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 8/2023 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror”, si dhe në bazë të gjetjeve në Analizën Vjetore 2024.

**PLANI I PUNËS  
PËR ULJEN E  
NUMRIT TË  
DOSJEVE TË  
MBARTURA  
2025 - 2030**

- Masat e parashikuara në këtë plan rrjedhin nga objektivat dhe prioritetet e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024-2030, Planit të Zhvillimit të Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror, si dhe nevojave institucionale për të adresuar situatën problematike të krijuar nga mbartja ndër vite e një numri shumë të lartë dosjesh përmbarimore, të cilat kanë ngelur pa ekzekutuar apo pa u dhënë zgjidhje ligjore, për shkak të: mungesës së pasurisë së palës debitore; pamundësia në ekzekutimin material; mungesës së bashkëpunimit ndërinstitucional; mos gjetjes së adresave të sakta të palëve debitore; ndryshimet ligjore si ligji për amnistinë etj.

- Ky plan synon reduktimin e ndjeshëm të numrit të dosjeve përmbarimore të mbartura, përmirësimin e efikasitetit të veprimtarisë përmbarimore, me qëllim përforcimin e besimit tek shërbimi përmbarimor gjyqësor shtetëror dhe rritjen e performancës të këtij shërbimi, duke garantuar një proces të rregullt ligjor.

- ✓ Me Urdhër Nr. 159/3 Prot., Nr. 68, datë 20.06.2025 të Drejtorit të Përgjithshëm të Përmbarimit është miratuar **Metodologjia e Inspektimit të Veprimtarisë së Përmbaruesve Gjyqësorë Shtetërorë**.

- Kjo metodologji përbën një dokument standart udhëzues për realizimin e inspektimeve nga struktura përgjegjëse pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit dhe synon rritjen e efektivitetit, transparencës dhe unifikimin e praktikave gjatë proceseve të inspektimit.

- ✓ Në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024–2030, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit ka hartuar dhe miratuar Planin e Integritetit të Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror 2025 – 2027.

#### PLANI I INTEGRITETIT 2025 - 2027 I SHPGJSH

Ky plan përmban analizën e risqeve institucionale, masat parandaluese dhe planin e veprimit për rritjen e transparencës, etikës profesionale dhe integritetit në ushtrimin e veprimtarisë përmbarimore.

- ✓ Me urdhër nr. 171 datë 15.12.2025 është miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Përmbarimit Rregullorja “Për parandalimin e konfliktit të interesit dhe për deklarimin e pasurive në Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror”.

Qëllimi i kësaj rregulloreje është garantimi i një vendimmarrjeje të paanshme, transparente, në interesin më të mirë të mundshëm të publikut nga zyrtarët e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror si dhe përcaktimi i rregullave, mjeteve, procedurave, përgjegjësi dhe kompetencave për identifikimin, deklarimin, regjistrimin, trajtimin, zgjidhjen dhe marrjen e masave ndëshkuese në rastet e konfliktit të interesave.

- ✓ Me urdhër nr. 170 datë 15.12.2025 është miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Përmbarimit Rregullorja “Për mbrojtjen, përpunimin dhe sigurinë e të dhënave personale në Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror”.

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i procedurave organizative e teknike për mbrojtjen e të dhënave personale dhe sigurisë, ruajtjes dhe administrimit të të dhënave personale nga struktura përkatëse pranë Drejtorisë së Përgjithshme e Përmbarimit. Kjo rregullore përdoret për të gjitha të dhënat e përpunuara nga Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe legjislacionin që përcakton objektin e veprimtarisë së shërbimit.

### 3.4 Infrastruktura dhe logjistika

Sa i përket infrastrukturës Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror pas shkëputjes nga gjykatat trashëgoi një infrastrukturë jo të përshtatshme për të ushtruar veprimtarinë përmbarimore, pasojat e të cilës ndikojnë në

veprimtarinë përmbartimore, si dhe ndikojnë në veprimtarinë e ekzekutimit të titujve ekzekutivë. Në kuadër të përmirësimit të shërbimeve të ofruara nga përmbartimi shtetëror si dhe specifikisht në kuadër të përmirësimit të shërbimeve të ofruara në mjedise miqësore në zyrat e shërbimit, është evidentuar nevoja për ambiente si dhe është përsëritur kërkesa për sistemimin e zyrave vendore me ambiente të përshtatshme. Problem shqetësues për zyrat e sistemuara në ambientet e gjykatave ka qenë dhe mbetet jo vetëm kërkesat nga ana e gjykatave për largimin e përmbartimit nga ambientet e këtyre godinave, por edhe ambiente të pamjaftueshme për ushtrim aktiviteti në kushte optimale, por në pamundësi sistemimi, kanë vazhduar të qëndrojnë në këto ambiente. **Gjatë kësaj periudhe është mundur sistemimi i Zyrës Përmbartimore Kavajë, Përmet dhe Mat me ambiente të përshtatshme për ushtrim aktiviteti.** Sistemimi i zyrave vendore përmbartimore është dhe mbetet prioritet në ndjekje të institucionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit.

Me shtimin e numrit të përmbartuesve gjyqësor, me miratimin e buxhetit për vitin 2026, ambientet janë të pamjaftueshme, pasi aktualisht në zyrat përmbartimore vendore rrijnë më shumë se dy përmbartues në një ambient.

Zyrat Përmbartimore Durrës, Lushnjë, Berat dhe Sarandë e ushtrojnë aktivitetin e tyre në ambientet të marra me qera.

Vlen të theksojmë se Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit ka përcjellë pranë Ministrisë së Drejtësisë problematikën e Zyrave Përmbartimore Lezhë, Kurbin dhe Kukës, referuar VKM nr.1292 date 24.09.2008 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë së trojeve dhe ndërtesave të gjykatave dhe të rretheve gjyqësore dhe të gjykatave të apelit”, si dhe VKM Nr.495, datë 21.7.2022, “Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave” godinat e gjykatave apo ish - gjykatave në Republikën e Shqipërisë administrohen nga Ministria e Drejtësisë, pasi nga gjykatat respektive iu është kërkuar të lirojnë ambientet që disponojnë.

Gjatë vitit 2025 Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit ka kryer mirëmbajtjen e zyrave të vetë drejtorisë, duke i lyer ato së bashku me ambientet e përbashkëta si dhe është sistemuar hapësira e jashtme, shkallët, kangjellat dhe ambienti i parkimit të makinave të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit dhe Zyrës së Përmbartimit Tiranë.

Gjithashtu, në muajin Dhjetor 2025 është inauguruar një ambient miqësor për ekzekutimin e titujve ekzekutivë me objekt “takim fëmije” në Zyrën Përmbartimore Tiranë, falë bashkëpunimit me Agjencinë Austriake për Zhvillim dhe Terre des Hommes.

Sistemimi i zyrave vendore përmbartimore është dhe mbetet prioritet në ndjekje të institucionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit.

Gjendja e logjistikës në Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbartimit dhe në zyrat vendore përmbartimore paraqet vështirësi serioze për garantimin e një pune të qëndrueshme dhe efikase. Pjesa më e madhe e pajisjeve kompjuterike është jashtë standardeve të nevojshme për funksionimin normal: kompjuterët janë të vjetëruar dhe funksionojnë me vështirësi, ndërsa problemet e përsëritura me domain dhe rrjetin, veçanërisht gjatë aktivizimit të WIFI, ndikojnë negativisht në aksesin në sistemet digjitale.

## 4 VERIFIKIMI I ANKESAVE, HETIMI ADMINISTRATIV DHE INSPEKTIMI

### 4.1 Ankesa të depozituara pranë DPP-së

Gjatë vitit 2025, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit ka trajtuar në mënyrë të vazhdueshme dhe profesionale ankesat dhe kërkesat e depozituara nga qytetarët dhe institucionet, në funksion të garantimit të ligjshmërisë, transparencës dhe përmirësimit të cilësisë së shërbimit përmbarimor.

Ankesat e depozituara pranë DPP-së janë paraqitur në forma të ndryshme. Një pjesë e tyre janë paraqitur fizikisht nga palët, të cilat janë pritur nga inspektorët përkatës, të cilët kanë ofruar sqarime dhe orientim lidhur me procedurat përmbarimore, ku sipas rastit kanë plotësuar formular kërkesë për informacion apo formular ankese ndaj procedurave përmbarimore të ndjekura nga një përmbarues gjyqësor shtetëror. Në rastin e paraqitjes së një ankese, pas verifikimit të saj nga ana e Drejtorisë së Inspektimit, brenda tre muajve nga paraqitja e ankësës nga Drejtori i Përgjithshëm i Përmbarimit është vendosur fillimi i hetimit disiplinor ndaj përmbaruesit gjyqësor ose arkivimi i ankësës, konform nenit 65, 66 të Ligjit nr. 8/2023 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor”.

Gjithashtu, janë administruar ankesa të paraqitura shkresërisht me postë, nga qytetarë persona fizikë dhe juridikë, të cilat kanë qenë objekt shqyrtimi administrativ në përputhje me ligjin organik. Paralelisht, gjatë vitit 2025, DPP ka trajtuar edhe ankesa dhe kërkesa të përcjella nga Ministria e Drejtësisë, të cilat janë shqyrtuar me prioritet dhe në koordinim institucional.

Të gjitha ankesat e depozituara gjatë vitit 2025 janë trajtuar brenda afateve ligjore dhe procedurale, duke u kthyer palëve përkatëse përgjigje zyrtare me shkrim, të argumentuara dhe të mbështetura në dispozitat ligjore përkatëse. Ky proces ka kontribuar në rritjen e besimit të publikut dhe institucioneve në veprimtarinë e DPP-së.

Përveç ankesave, gjatë vitit 2025 janë trajtuar edhe kërkesa për informacion, të cilat kanë pasur për objekt sqarime mbi procedurat përmbarimore, të drejtat dhe detyrimet e palëve, si dhe fazat e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Këto kërkesa janë trajtuar në përputhje me legjislacionin për të drejtën e informimit dhe kanë shërbyer si një mekanizëm parandalues për uljen e ankesave formale.

Për sa më sipër, për periudhën Janar – Dhjetor 2025 nga Drejtoria e Inspektimit në DPP janë trajtuar brenda afateve ligjore 215 ankesa dhe kërkesa për informacion, lidhur me procedurat përmbarimore të ndjekura nga përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë, si dhe 50 ankesa të përcjella për trajtim nga Platforma e Bashkëqeverisjes.

Në përfundim, trajtimi i ankesave dhe kërkesave për informacion gjatë vitit 2025 dëshmon angazhimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit për një administrim të hapur, transparent dhe në përputhje me standardet ligjore, duke kontribuar në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit përmbarimor.

## 4.2 Shqyrtimi dhe verifikimi i ankesave

Nga Drejtoria e Inspektimit janë shqyrtuar dhe verifikuar ankesat e përcjella pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit, në përputhje me Ligjin nr. 8/2023 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror”, Kreu XI “procedimi disiplinor” – sipas së cilës rregullohet mënyra e verifikimit dhe shqyrtimit të ankesave ndaj veprimtarisë procedurale dhe administrative të përmbaruesve gjyqësorë shtetëror, me qëllim garantimin e ligjshmërisë dhe përgjegjshmërisë institucionale.

Në vijim të shqyrtimit dhe verifikimit të ankesave janë ndjekur brenda afateve respektive të parashikuara në ligjin organik procedurat si më poshtë:

- Njoftimi dhe vënia në dijeni e ankuesit apo institucionit publik mbi fillimin e verifikimit të ankesës.
- Kërkesë për informacion dhe kopje e praktikës përmbarimore të ndjekur për ekzekutimin e çështjes, objekt anese, me qëllim kryerjen e hetimit administrativ të saj, drejtuar zyrës vendore përmbarimore.
- Relacion mbi shqyrtimin dhe verifikimin e ankesës si dhe propozimet përkatëse mbi fillimin e hetimit disiplinor apo arkivimin e ankesës.
- Vendim për arkivimin e ankesës apo fillimin e hetimit disiplinor.
- Kthim përgjigje ankuesit mbi shqyrtimin dhe verifikimin e ankesës si dhe njoftimin mbi vendimin e arkivimit të ankesës apo të fillimit të hetimit disiplinor.
- Urdhër për pezullim hetimi disiplinor në rastet që parashikon neni 69 i Ligjit 8/2023.
- Raport hetimi disiplinor si dhe propozimet mbi arkivimin e ankesës ose fillimit e procedimit disiplinor.
- Njoftimi i palëve si dhe dërgim i raportit të hetimit disiplinor së bashku me dosjen hetimore pranë Këshillit Përmbarimor.

Gjithashtu, është organizuar, në zbatim të urdhrave të deleguara nga Drejtori i Përgjithshëm, pritja e personave fizikë dhe juridikë, të cilët kanë paraqitur kërkesat dhe ankesat e tyre verbalisht pranë Drejtorisë.

## 4.3 Hetimi disiplinor

Për vitin 2025, në bazë të verifikimit të shqyrtimit të ankesave, si dhe në bazë të gjetjeve të pasqyruara në raportet e kontroleve të ushtruara sipas planit vjetor të inspektimit pranë zyrave vendore përmbarimore, nga Drejtori i Përgjithshëm i Përmbarimit është vendosur fillimi i hetimit disiplinor për përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë, në bazë të nenit 65, 66, 67 të Ligjit nr. 8/2023 « Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror ». Në rastet e parashikuara në nenin 69 të ligjit organik, Drejtori i Përgjithshëm i Përmbarimit ka urdhëruar pezullimin e hetimit disiplinor, derisa të marrë formë të prerë çështja civile, penale apo administrative nga organi kompetent, në të cilin një nga palët është përmbaruesi gjyqësorë shtetëror në hetim disiplinor, ndërsa shkelja e dyshuar lidhet me të njëjtat fakte për të cilën do të merret vendimi. Pas hartimit të raportit të hetimit disiplinor, sipas rastit nga Drejtori i Përgjithshëm është vendosur mbyllja e hetimit disiplinor, apo marrja e vendimit për masë disiplinore, në bazë të nenit 86, pika 2 të ligjit nr. 8/2023 « Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror ».

| 17 Vendime Fillimi<br>Hetimi Disiplinor                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              | 2 Urdhra pezullimi të<br>hetimit disiplinor                                                         | 1 Vendim për mbylljen e<br>hetimit disiplinor       | 7 Vendim për masë<br>disiplinore                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <p>Nr. 86, Përmbaues <b>E. I.</b>,<br/>Zp Durrës</p> <p>Nr. 41, Përmbaues <b>M. H. ZP Durrës</b></p> <p>Nr. 83, <b>K. C.</b>, ZP<br/>Pogradec</p> <p>Nr. 32, Përmbaues <b>K. C.</b>, ZP Pogradec</p> <p>nr. 14, Përmbaues <b>A. L.</b></p> <p>Nr. 62, Përmbaues <b>A. C.</b>, ZP Berat</p> <p>Nr. 80, Përmbaues <b>A. C.</b>, ZP Berat</p> <p>Nr. 61, Përmbaues <b>I. Ç.</b>, ZP Berat</p> <p>Nr. 82, Përmbaues <b>E. K.</b>, ZP Korçë</p> <p>Nr. 59, Përmbaues <b>M. D.i</b>, ZP Kavajë</p> <p>Nr. 58, Përmbaues <b>G. Ll.</b> ZP Kavajë</p> <p>Nr. 77, Përmbaues <b>P. C.</b>, ZP Tiranë</p> <p>Nr. 56, Përmbaues <b>P. C.</b>, ZP Tiranë</p> <p>Nr. 64, Përmbaues <b>P. C.</b>, ZP Tiranë</p> <p>Nr. 57, Përmbaues <b>E. D.</b>, ZP Tiranë</p> <p>Nr. 16, Përmbaues <b>B. K.</b>, ZP Tiranë</p> <p>Nr. 65, Përmbaues <b>B. L.</b>, ZP Lushnjë</p> | <p>Nr. 84, Përmbaues <b>M. H.</b>, ZP Durrës.</p> <p>Nr. 154, Përmbaues <b>P. C.</b>, ZP Tiranë</p> | <p>Nr. 76, Përmbaues <b>A. L.</b>, ZP Pogradec.</p> | <p>Nr. 90 "Vërejtje me paralajmërim për shkarkim nga detyra", <b>B. L.</b>, ZP Lushnjë;</p> <p>Nr. 88 "Vërejtje", Përmbaues <b>G. Ll.</b>, ZP Kavajë;</p> <p>Nr. 87 "Vërejtje", Përmbaues <b>M.D.</b>, ZP Kavajë;</p> <p>Nr. 89 "Vërejtje", Përmbaues <b>K. C.</b>, ZP Pogradec;</p> <p>Nr. 70, "Vërejtje", Përmbaues <b>B. K.</b>, ZP Tiranë.</p> <p>Nr. 55, "Vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra" Përmbaues <b>M. H.</b>, ZP Durrës</p> <p>Nr. 54, "Vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra" Përmbaues <b>E. I.</b>, ZP Durrës</p> |

#### **4.4 Propozime për procedim disiplinor dhe vendimet e Këshillit Përmbartimor dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Përmbartimit**

Për vitin 2025, nga Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit janë përcjellë për dijeni raportet e hetimit disiplinor me propozimet përkatëse për procedim disiplinor para Këshillit Përmbartimor. Vendimet e masave disiplinore “Vërejtje” dhe “Vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra” janë marrë nga Drejtori i Përgjithshëm, në zbatim të nenit 86, pika 2 të Ligjit nr. 8/2023 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror”.

#### **4.5 Inspektimet tematike dhe inspektimet e përgjithshme**

Në bazë të Planit të Inspektimit për vitin 2025, Nr. 139 Prot., datë 22.01.2025, të ndryshuar inspektorët e Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit kanë ushtruar kontroll periodik mbi veprimtarinë procedurale dhe administrative të zyrave vendore përmbartimore. Në përfundim të inspektimeve janë hartuar akt kontrollet dhe raportet e inspektimit përkatës, ku janë pasqyruar aktet përmbartimore të cilat janë kontrolluar, konstatimet, shkeljet disiplinore të kryera nga përmbartuesit gjyqësor subjekt kontrolli, propozime për fillimin e hetimit disiplinor dhe rekomandimet përkatëse.

##### **Plani i inspektimit ka pasur në objekt:**

- Veprimtarinë procedurale dhe administrative të zyrave vendore përmbartimore, organizimin e punës nga ana e Kryetarit të Zyrës dhe konstatimet në vend, mbi punën e kryer në zbatim të legjislacionit në fuqi dhe rregullores së Brendshme të Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor.
- Zbatimin e kërkesave të Kodit të Procedurës Civile, urdhrave dhe udhëzimeve të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit dhe akteve të tjera nënligjore, në respektimin e afateve procedurale të ekzekutimit, për dosjet përmbartimore.
- Njohja dhe zbatimi i Kodit të Etikës, bazuar në Urdhrin e Ministrit nr. 3851, datë 08.05.2009, “Për miratimin e Kodit të Etikës, të Përmbartuesve Gjyqësorë, Shtetërorë dhe Privatë”, paraqitja në punë, komunikimi me qytetarët, si dhe ngarkesa ditore e secilit përmbartues.
- Zbatimi i Rekomandimeve të bëra nga grupi i inspektimit pranë Drejtorisë së Inspektimit dhe Shqyrtimit të Ankesave, në Akt- Kontrollat e përcjella pranë Zyrave Përmbartimore Vendore.
- Zbatimi i Urdhrit Nr. 36 datë 18.03.2025 “Për Raportimin Mijor mbi veprimtarinë procedurale dhe administrative të Zyrave Vendore Përmbartimore, Kryetarëve të Zyrave Vendore Përmbartimore dhe Përmbartuesve gjyqësor shtetëror”.

Në akt kontrollet përkatëse janë nxjerrë konkluzionet për secilën zyrë të inspektuar duke evidentuar shkeljet e gjetura, si dhe janë dhënë rekomandimet e nevojshme për përmirësim të veprimtarisë së ekzekutimit.

## METODOLOGJIA E INSPEKTIMIT

Me Urdhër nr. 159/3 Prot., nr. 68, datë 20.06.2025 të Drejtorit të Përgjithshëm të Përmbarrimit është miratuar Metodologjia e Inspektimit të Veprimtarisë së Përmbarruesve Gjyqësorë Shtetërorë”;

Metodologjia e Inspektimit është mjete nëpërmjet të cilit inspektorët që ushtrojnë funksionin në Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbarrimit, kryejnë inspektimet pranë Zyrave Vendore Përmbarrimore Shtetërore, në të cilën parashikohet qëllimi, kuadri ligjor i inspektimeve, mbledhja e të dhënave, si edhe një mori me procedura të tjera tekniko-administrative.

Metodologjia e inspektimit synon të vendosë në dispozicion të grupit të inspektorëve një mjet të dobishëm procedural për zbatimin e legjislacionit mbi përgjegjësinë disiplinore të përmbarruesve gjyqësorë shtetërorë duke synuar përmirësimin dhe efikasitetin e Shërbimit Përmbarrimor Gjyqësor Shtetëror, në funksion të ekzekutimit të titujve ekzekutivë.

Objekti kryesor i metodologjisë së inspektimit është vendosja e disa rregullave dhe standardeve që inspektorët duhet të kryejnë gjatë inspektimeve si dhe procedura që duhet të ndiqet nga momenti i miratimit të planit të inspektimit e deri tek përfundimi i inspektimit. Metodologjia e inspektimit të përmbarruesve gjyqësorë shtetërorë është një proces i strukturuar dhe sistematik që synon të vlerësojë dhe sigurojë që veprimet e përmbarruesve respektojnë ligjin dhe standardet profesionale të caktuara.

Në zbatim të Metodologjisë së Inspektimit është miratuar edhe Plan i Punës së inspektimeve për Zyrat Përmbarrimore Fier, Vlorë, Gjirokastrë, Sarandë dhe Tiranë.

### 4.6 Problematikat lidhur me mosekzekutimin e titujve ekzekutivë.


Referuar akt - kontrolleve nga Grupi i Inspektimit sa i përket inspektimeve të kryera për verifikimin e veprimtarisë procedurale dhe administrative të përmbarruesve gjyqësorë shtetërorë në zyrat vendore përmbarrimore, **rezultojnë ndër të tjera konstatimet si më poshtë:**

- Mosrespektim i afateve të arsyeshme ligjore në ekzekutimin e titujve ekzekutivë, dhe tejkalim të afateve, për shkak të moskryerjes në kohë të veprimeve procedurale.
- Hetimi jo i plotë dhe i pamjaftueshëm administrativ, lidhur me shtrirjen në kohë të kërkimit dhe gjetjes së pasurive të debitorit.
- Veprime procedurale jo të plota mbi gjetjen e adresës së saktë të palës debitore, me qëllim njoftimin mbi procedurat përmbarrimore, konform KPC.
- Mosadministrim i të gjitha akteve procedurale në dosjen përmbarrimore.
- Mosnjoftim i palëve kreditore dhe debitore mbi të gjitha procedurat përmbarrimore të ndjekura nga përmbarruesi gjyqësor mbi ekzekutimin e urdhrave të ekzekutimit.
- Në dosjet përmbarrimore të inspektuara shkresat e prodhuara nga përmbarruesi gjyqësor në funksion të ekzekutimit të Titulli Ekzekutiv kanë numra protokolli dhe datë të njëjtë.

- Shkresat e përpiluara nga ana e përmbartuesit gjyqësor në funksion të ekzekutimit të Titullit Ekzekutiv, kanë gabime materiale, lidhur me gjeneralitetet e debitorit dhe shumën, kur objekti është “kthim shume”.

### Problematika mbi bashkëpunimin ndërinstitucional

Referuar raporteve të hetimit administrativ të çështjeve përmbartimore mbi bazë ankese ndaj veprimeve procedurale dhe administrative të zyrave përmbartimore vendore si dhe referuar konstatimeve të evidentuara në akt kontrollet e inspektimeve të ushtruara në zyrat përmbartimore, rezulton se një pjesë e problematikave mbeten të lidhura me mungesën e bashkëpunimit ndërinstitucional, të cilat ndikojnë ndjeshëm në procesin e ekzekutimit të titujve ekzekutivë.



Konkretisht, një nga problematikat më të përsëritura lidhet me moszbatimin nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës të urdhrave të sekuestros konservative dhe kërkesave për informacion mbi pasuritë e paluajtshme të palës debitoare, pasi kërkohet parapagim i tarifave kadastrale duke e trajtuar urdhrin e sekuestros si një shërbim dhe jo si një procedurë ligjore të detyrueshme të parashikuar në nenin 527 dhe 560 të Kodit të Procedurës Civile, çka pengon në ekzekutimin e titujve ekzekutivë. Drejtoria e Përgjithshme e

Përmbartimit i është drejtuar ASHK-së zyrtarisht duke përsëritur shqetësimin dhe duke sugjeruar mënyra zgjidhjeje për adresimin e këtij problemi, si më poshtë:

1. Të shqyrtohet mundësia e përshtatjes së praktikës së tarifimit për kërkesat që burojnë nga detyrimet ligjore, duke u bërë një ndarje më e qartë ndërmjet shërbimeve kadastrale me pagesë dhe atyre që rrjedhin drejtpërdrejt nga detyrimet e parashikuara në Kodin e Procedurës Civile, siç janë urdhrat e sekuestros. Në këtë kuadër, nuk synohet shmangia e tarifimit, por garantimi që vendosja e sekuestros të kryhet brenda afatit 10-ditor të përcaktuar në nenin 560 të Kodit të Procedurës Civile, pa u kushtëzuar me pagesën paraprake të tarifës kadastrale. Pagesa e këtyre tarifave të kryhet më pas nga pala kreditore ose personi përgjegjës, në përputhje me nenin 525 të Kodit të Procedurës Civile.
2. Të garantohet një akses elektronik i drejtpërdrejtë për përmbartuesit gjyqësorë shtetërorë në regjistrat e pasurive, për verifikimin e pronësisë, me qëllim evidentimin e të dhënave të sakta të pasurisë sikurse parashikohet në Kodin e Procedurës Civile, që më pas të vijohet me vendosjen e sekuestros mbi këtë pasuri.

**Një tjetër problematikë lidhet me moszbatimin nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor të urdhrave të sekuestros konservative mbi mjetet motorike të debitorëve,** gjë që pengon ekzekutimin e vendimeve që kanë si objekt kthim shume. Konstatohet se prej vitit 2020, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor nuk zbaton urdhrat për “Sekuestro Konservative” të lëshuara nga përmbartuesit gjyqësorë mbi mjetet motorike të debitorëve. Ky refuzim bazohet në një interpretim të dhënë nga DPSHTRR me shkresën nr. 20338 Prot., datë 27.09.2019 (urdhër i brendshëm), sipas së cilës kompetenca për vendosjen e sekuestros konservative mbi mjetet motorike i takon Regjistrat të Barrëve Siguruese.

Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit vlerëson se ky qëndrim nuk është në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, i cili në nenin 527 parashikon se në rastet kur detyrimi nuk përmbushet vullnetarisht, përmbartuesi gjyqësor urdhëron vendosjen e sekuestros mbi pasuritë e debitorit, përfshirë edhe pasuritë e luajtshme. Vendosja e sekuestros konservative është veprim ekzekutiv procedural që duhet të zbatohet nga institucionet që administrojnë regjistrat përkatës të pronësisë, në këtë rast nga DPSHTRR. Moszbatimi i këtyre urdhrave ka sjellë pengesa të vazhdueshme në procesin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore dhe ka cenuar mundësinë për realizimin e të drejtave të kreditorëve. Gjatë kësaj periudhe Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit ka adresuar në mënyrë të vazhdueshme problematikën e krijuar nga moszbatimi i urdhrave të sekuestros nga DRSHTRR, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, DPSHTRR dhe Regjistrat të Barrës Siguruese, **e më konkretisht me shkresat: nr. 674 Prot., datë 09.05.2025; nr. 844 Prot., datë 18.06.2025; nr. 844/3 Prot., datë 10.07.2025; nr. 1210/1 Prot., datë 06.10.2025.**

Për këtë arsye, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit kërkon ndërhyrje për qartësimin dhe unifikimin e praktikës ndërmjet institucioneve, në mënyrë që urdhrat për sekuestro konservative të zbatohen në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile dhe legjislacionin në fuqi.

Po ashtu, **zyrat përmbartimore vendore janë përballur me mungesë mbështetjeje nga IKMT dhe IMT gjatë ekzekutimit të titujve ekzekutivë me objekt “lirim–dorëzim sendi”.** Pavarësisht kërkesave të përsëritura të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit dhe zyrave përmbartimore për mbështetje gjatë ekzekutimeve, IKMT dhe IMT nuk kanë ofruar bashkëpunimin, duke u justifikuar me angazhime sipas planeve vjetore të punës. Ky qëndrim bie ndesh me nenin 523 të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet ndër të tjera se kur për ekzekutimin e detyrueshëm është e nevojshme të prishet objekti, të lirohet trualli, të pezullohen punimet, me kërkesë të përmbartuesit gjyqësor, inspektoriati ndërtimor pranë pushtetit vendor dhe

Inspektoriati Kombëtar detyrohen të mbështesin përmbaruesin gjyqësor gjatë procedurave të ekzekutimit. Për sa më sipër, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit ka propozuar zhvillimin e një takimi dypalësh ndërmjet përfaqësuesve të DPP-së dhe IKMT-së, me qëllim trajtimin në mënyrë të drejtpërdrejtë të problematikave të evidentuara dhe përcaktimin e formave konkrete të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve, nëpërmjet një marrëveshjeje të posaçme bashkëpunimi.

Nga IKMT është mbajtur qëndrimi se nuk është e parashikuar në misionin e tyre institucional ofrimi i mbështetjes në ekzekutim të këtyre çështjeve përmbarimore.

**Një tjetër problematik lidhet me mosparapagimin e shpenzimeve përmbarimore nga institucionet publike që ushtrojnë rolin e kreditorit, si Prokuroria, Agjencia e Inteligjencës Financiare etj.** Gjatë zhvillimit të procedurave përmbarimore shpesh lind nevoja për caktimin e përfaqësuesve ligjorë nga gjykata në rastet kur debitori nuk ka vendbanim të njohur, për angazhimin e ekspertëve (topografë apo kontabël), për aplikime në portalin e-Albania lidhur me vendosjen e sekuestrove, si dhe për zhvillimin e ankandëve për pasuritë e sekuestruara. Të gjitha këto procedura përfshijnë kosto që përbëjnë shpenzime përmbarimore, por që në vetvete janë shpenzime kadastrale, gjyqësore apo eksperti, të cilat në shumë raste nuk parapaguhën nga institucionet në cilësinë e kreditorit, duke sjellë vonesa të konsiderueshme në realizimin e ekzekutimit.

Gjithashtu një tjetër vështirësi gjatë ekzekutimit të titujve ekzekutivë **lidhet me mosrealizimin e njoftimeve ndaj palëve debitore**, pasi zarfi shpesh kthehet me shënime si “adresë e pasaktë”, “larguar”, “refuzuar” apo “adresë e pamjaftueshme”. Kjo situatë ndikon drejtpërdrejt në pamundësinë për të kaluar nga një fazë e ekzekutimit në tjetrën, pasi aktet e panjoftuara nuk prodhojnë efektet ligjore të parashikuara dhe mund të bëhen objekt kundërshtimi të veprimeve përmbarimore në gjykatë, duke sjellë vonesa të ndjeshme dhe ngarkesë shtesë në procesin e ekzekutimit. Në shumë raste, problematika lidhet edhe me neglizhencën apo moskryerjen korrekte të procedurës së njoftimit nga punonjësit e shërbimit postar, të cilët nuk ndjekin me përpikmëri kërkesat ligjore për njoftimin e akteve përmbarimore, duke shkaktuar kthimin e zarfave pa u kryer njoftimi real i palës. Në këto kushte, vlerësohet e nevojshme ndërmarrja e një mase institucionale nga DPP, Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me Postën Shqiptare, për forcimin e kontrollit të procedurës së njoftimeve, në mënyrë që të garantohej njoftimi, zbatimi i saktë dhe në kohë i akteve përmbarimore.

**Sa i përket zbatimit të Ligjit 33/2024 “Për dhënie Amnistie”, ka lindur si problematik mosbashkëpunimi dhe mosunifikimi i qëndrimit të prokurorive, lidhur me dosjet përmbarimore me objekt – gjopa penale**, ku debitori është subjekt që përfiton nga amnistia. Disa nga prokuroritë janë treguar bashkëpunuese dhe janë përgjigjur kërkesave të përmbaruesve, ndërsa disa prokurori nuk kthejnë përgjigje, duke mos u dhënë zgjidhje ligjore rasteve përkatëse. Për këtë arsye, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit i është drejtuar shkresërisht Prokurorisë së Përgjithshme me shkresë zyrtare, ku është kërkuar që edhe nga prokuroritë e rretheve të mbahet një qëndrim i unifikuar, sa i përket çështjeve përmbarimore me objekt “gjopa penale” ku nga përmbaruesi gjyqësor është vlerësuar se: subjekti përfiton nga ligji për amnistinë; ka paguar shpenzimet gjyqësore; ka bashkëlidhur të gjitha aktet përmbarimore, si dhe ka kërkuar nga prokuroria që të shpreh dakordësinë mbi pushimin e ekzekutimit të urdhrin të ekzekutimit, sipas nenit 616/b të Kodit të Procedurës Civile. Gjithashtu, në Planin e Punës për uljen e numrit të dosjeve përmbarimore të mbartura, nga DPP është parashikuar si masë edhe evidentimin e dosjeve përmbarimore ku palët debitore janë subjekte që përfitojnë nga ligji për amnistinë dhe njoftimi i prokurorive kompetente, me qëllim dhënien e zgjidhjes ligjore, në zbatim të nenit 616/b të Kodit të Procedurës Civile.

#### 4.7 Rekomandime nga Inspektimet.

Bazuar në Planin e Inspektimit Nr. 139 Prot., datë 22.01.2025 për periudhën Janar - Dhjetor 2025, miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Përmbarimit janë ushtruar inspektime në zyrat vendore përmbarimore, ku në mënyrë të përmblendhur janë dhënë rekomandimet si më poshtë:



#### 4.8 Monitorimi i rekomandimeve

Gjatë vitit 2025, një ndër pikat kyçe të objektit të ushtrimit të kontrollit ka qenë monitorimi i zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga inspektimet e mëparshme. Ky proces është ndjekur me përparësi, me qëllim vlerësimin e nivelit të përmbushjes së detyrimeve të përcaktuara dhe nxitjen e përmirësimeve të vazhdueshme në punën e shërbimit përmbarimor gjyqësor shtetëror.

Rezultatet tregojnë një angazhim në rritje të zyrave vendore përmbareme për të reflektuar mbi gjetjet e inspektimeve dhe për të ndërmarrë masa korrigjuese konkrete, në funksion të forcimit të zbatueshmërisë së ligjit dhe standardizimit të praktikave.

Për më tepër, edhe gjatë vitit 2025, monitorimi i rekomandimeve mbetet pjesë integrale e objektit të kontrollit, duke vijuar si një komponent i domosdoshëm për garantimin e cilësisë dhe efektivitetit të veprimtarisë së përmbareve gjyqësore shtetërore.

## **5. BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL KOMBËTAR DHE NDËRKOMBËTAR**

### **5.1 Bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë**

Gjatë vitit 2025, bashkëpunimi institucional ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbaremit dhe Ministrisë së Drejtësisë është thelluar dhe konkretizuar në disa drejtime. Në bashkëpunim me këtë ministri janë hartuar dhe miratuar disa akte nënligjore të rëndësishme, të cilat kanë shërbyer për përmirësimin dhe standardizimin e veprimtarisë përmbareme, ku ndër të tjera përmendin Rregulloren për organizimin e funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbaremit, të miratuar me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.

Gjithashtu, nga Ministria e Drejtësisë janë përcjellë pranë DPP-së për trajtim ankesat e paraqitura nga palët ndaj veprimeve përmbareme të përmbareve gjyqësore shtetërore, të cilat janë shqyrtuar në përputhje me kuadrin ligjor dhe procedurat përkatëse.

Drejtorja e Përgjithshme e Përmbaremit ka vijuar gjithashtu raportimin periodik pranë Ministrisë së Drejtësisë, në funksion të transparencës, llogaridhënies dhe koordinimit të veprimtarisë institucionale.

### **5.2 Bashkëpunimi me institucionet qendrore dhe lokale**

Gjatë vitit 2025, Drejtori i Përgjithshëm i Përmbaremit z. Ergys Qirici ka forcuar bashkëpunimin ndërinstitutional, si një element thelbësor për rritjen e cilësisë së veprimtarisë përmbareme, forcimin e kapaciteteve të përmbareve gjyqësore shtetërore dhe eficiencës në zbatimin e vendimeve gjyqësore. Në këtë kuadër, një rëndësi të veçantë i është kushtuar marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione kyçe si Shkolla e Magjistraturës, Shërbimi i Provës dhe Urdhri i Psikologut.



### Marrëveshje Bashkëpunimi me Shkollën e Magjistraturës

- Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit ka nënshkruar një **Marrëveshje Bashkëpunimi me Shkollën e Magjistraturës**, me qëllim organizimin e trajnimeve vazhduese dhe të specializuara për përmbartuesit gjyqësor shtetërorë dhe inspektorët e Drejtorisë së Inspektimit.



### Marrëveshje Bashkëpunimi me Shërbimin e Provës

- Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit ka nënshkruar një **Marrëveshje Bashkëpunimi me Shërbimin e Provës**, me qëllim këmbimin e informacionit (në lidhje me adresat e palëve debitoare, orientimin e tyre drejt shërbimeve publike etj.) të të dy institucioneve.



### Marrëveshje Bashkëpunimi me Urdhrin e Psikologut

- Qëllimi i kësaj marrëveshjeje me **Urdhrin e Psikologut** është sigurimi i formave të bashkëpunimit për rritjen e standardeve të ofrimit të shërbimeve përmbartimore, në çështjet në të cilat përfshihen të miturit, në mënyrë që të garantohet parimi i mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijës.

## 5.3 Bashkëpunimi me organizatat kombëtare/ndërkombëtare dhe donatorët

Nëpërmjet mbështetjes së Terre des Hommes, është mundësuar mbështetje në ekzekutimin e dosjeve përmbartimore « takim fëmije » dhe « marrje fëmije », për prindërit që nuk kanë mundësi të paguajnë asistencën e psikologut, dhe kjo gjë është mbuluar financiarisht nga Terre des Hommes.

Në kuadër të Strategjive Ndërsektoriale të Drejtësisë, ky projekt ka qenë një objektiv i rëndësishëm që DPP e ka realizuar me sukses dhe mbi të cilin ka raportuar rregullisht pranë Ministrisë së Drejtësisë.



### Krijimi i një ambienti miqësor për fëmijët.



Falë mbështetjes së Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA), zbatuar nga Terre des hommes Shqipëri, dhe në kuadër të masave të parashikuara në Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë, është përfunduar rikonstruksioni dhe përshtatja e një hapësire të posaçme për realizimin e takimeve të fëmijëve pranë Zyrës Përmbarimore Tiranë. Ky investim synon përmirësimin e mirëqenies së fëmijëve, uljen e konfliktualitetit midis palëve dhe rritjen e efektivitetit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore në këtë fushë.

## 5.4 Raportimet e DPP-së në kuadër të strategjive ndërsektoriale

Në funksion të angazhimeve ndërinstytucionale për zbatimin e reformës në drejtësi, gjatë vitit 2025 Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit ka vijuar raportimin periodik në kuadër të strategjive ndërsektoriale pranë Ministrisë së Drejtësisë.

Raportimi është realizuar në përputhje me detyrimet e përcaktuara në dokumentet strategjike për sistemin e drejtësisë dhe ka pasqyruar progresin, sfidat dhe masat e ndërmarra për përmbushjen e objektivave të reformës, sidomos në fushën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore dhe forcimit të shtetit të së drejtës.

Ky proces ka kontribuar në vlerësimin e ecurisë institucionale dhe në identifikimin e nevojave për ndërhyrje të mëtejshme në funksion të përmirësimit të shërbimeve përmbartimore dhe rritjes së besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.

### STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE E DREJTËSISË 2024 - 2030



Gjatë zhvillimit të takimit ndërinstytucional në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë

Në kuadër të hartimit të raportit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024 -2030 për periudhën Janar – Dhjetor 2025, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit ka raportuar si më poshtë:

#### Masa 1.1.1.1

**Zbatimi i angazhimeve të ndërmarra në SND 2024-2030, Udhërrëfyesin e Shtetit të së Drejtës nga institucionet zbatuese dhe hartimi i Raporteve periodike të monitorimit sipas përcaktimeve ligjore.**

#### Progresi:

Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit është angazhuar në realizimin e masave të parashikuara në SDN, ku ndër të tjera me Urdhër nr. 28, dt. 7.3.2025 “Për miratimin e planit të Zhvillimit të SHPGJSH për vitin 2025”, ka përfshirë për realizim të gjitha masat e parashikuara në Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë.

Gjithashtu nga DPP janë kryer raportime periodike mbi masat e realizuara, pranë Ministrisë së Drejtësisë, brenda afateve të përcaktuara.

**% e realizimit të objektivit specifik për janar-dhjetor 2025:**

100%

**Problematicat:**

Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave nëpërmjet bashkëpunimit midis sektorëve të DPP-së.

Hapat që do të vijojnë:

Në vijim do të vijohet me përmbyshjen e masave të parashikuara për DPP në kuadër të SND. Nga strukturat përgjegjëse të DPP-së do të kordinohet, mblidhen dhe përpunohen të dhënat, mbi të cilat do të përgatitet raportimi periodik dhe do të përcillet pranë Ministrisë së Drejtësisë.

**Statusi:**

Në proces.

**Masa 3.1.6.2**

**Plotësimi i vakancave në referim të gjetjeve të analizës.**

**Progresi:**

Në këtë drejtim, gjatë kësaj periudhe, janë marrë masat në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për plotësimin e organikës në çdo zyre vendore përmbartimore, duke ndjekur procedurat ligjore levizjet si dhe për plotësimin e vendeve vakante të personelit administrativ në nivel qendror dhe vendor apo duke ndjekur procedurat përkatëse për shpalljen e vendeve vakante për përmbartues gjyqësor, si më poshtë:

Është mundësuar plotësimi i 1 (një) vendi vakant për përmbartues gjyqësor në Zyrën Përmbartimore Durrës, nga procedura e ndjekur për shpalljen e publikuar për plotësimin e dy vendeve vakante 1 vend vakant në Zyrën Përmbartimore Durrës dhe 1 (një) vend vakant në Zyrën Përmbartimore Kukës.

Me largimin e një përmbartuesi gjyqësor në Zyrën Përmbartimore Tiranë, me kërkesën e tij, si dhe mosplotësimin të vendit vakant të shpallur për Zyrën Përmbartimore Kukës, DPP ka proceduar për shpalljen e këtyre dy vendeve vakante me qëllim plotësimin e tyre.

Kështu, është mundësuar shpallja e 3 (tre) vendeve vakante për përmbartues gjyqësor, konkretisht 1 (një) vend vakant në Zyrën Përmbartimore Tiranë, 1 (një) vend vakant në Zyrën Përmbartimore Lushnjë dhe 1 (një) vend vakant në Zyrën Përmbartimore Kukës. Në dhjetor të vitit 2025 rezultojnë 1 vend vakant si inspektor në DPP, 1 vend vakant si përmbartues gjyqësor në Zyrën Përmbartimore Gjirokastër dhe 1 vend vakant për përmbartues gjyqësor në Zyrën Përmbartimore Kurbin, për të cilat do të ndiqen procedurat për plotësimin e tyre në vitin 2026.

Gjithashtu, në kuadër të forcimit dhe konsolidimit të shërbimit përmbartimor gjyqësor shtetëror, është kërkuar shtim i organikës së këtij shërbimi duke propozuar dhe kërkuar konkretisht shtim të burimeve njerëzore, përmbartues gjyqësor.

**% e realizimit të objektivit specifik për janar-dhjetor 2025:**

100%

**Problematikat:**

Mosmiratimi i kërkesës së planifikuar në projektbuxhetin e shërbimit për vitin 2026 me staf të shtuar.

**Hapat që do të vijnë:**

Ndjekja në vijimësi e procesit të rekrutimit të përmbaruesve sipas organikës aktuale. Përsëritje e kërkesave për shtim të burimeve njerëzore. Miratimi i kërkesave në buxhetin e shërbimit, në organikë. Ndjekja e procedurave të rekrutimit dhe plotësimi me staf profesional.

**Statusi:**

Në proces.

**Masa 3.1.6.3****Vlerësimi periodik i nevojave për trajnim vazhdues dhe trajnim i specializuar sipas fushave****Progresi:**

Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit ka ndërmarrë hapa konkretë për realizimin e kësaj mase, nëpërmjet vlerësimit të vazhdueshëm të nevojave për trajnim të përmbaruesve gjyqësorë, bazuar në fushat ku identifikohen mangësi ose nevoja të reja profesionale. Është realizuar një marrëveshje bashkëpunimi me Shkollën e Magjistraturës për organizimin e trajnimeve vazhduese dhe të specializuara për përmbaruesit gjyqësor dhe inspektorët.

Gjithashtu, është lidhur marrëveshje me Urdhrin e Psikologut, e cila parashikon edhe zhvillimin e trajnimeve për përmbaruesit gjyqësor në lidhje me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore që përfshijnë të mitur, duke synuar rritjen e kapaciteteve profesionale dhe ndjeshmërinë në raport me të drejtat e fëmijëve.

Përmes këtyre bashkëpunimeve, janë hedhur bazat për ndërtimin e një programi të qëndrueshëm dhe të strukturuar trajnimesh, i cili do të mundësojë zhvillimin profesional të vazhdueshëm të përmbaruesve gjyqësor në përputhje me kërkesat e ligjit dhe zhvillimet aktuale në praktikë.

**% e realizimit të objektivit specifik për janar-dhjetor 2025:**

100%

**Problematikat:**

Mungesa e burimeve financiare të dedikuara për zhvillimin e trajnimeve. Pjesëmarrja e pabarabartë nga përmbaruesit në varësi të juridiksionit dhe distancës nga Tirana.

**Hapat që do të vijnë:**

Hartimi dhe miratimi i një kalendari vjetor trajnimesh në bashkëpunim me institucionet partnere. Zbatimi i një ankete periodike për të vlerësuar në mënyrë sistematike nevojat për trajnim sipas fushave të specializuara. Monitorimi i pjesëmarrjes dhe vlerësimi i performancës përmes instrumenteve të matjes pas çdo trajnimi.

**Statusi:**

Në proces.

#### **Masa 3.1.6.4**

### **Trajnimi vazhdues i punonjësve të shërbimit përmbarimor gjyqësor lidhur me procedurat e ekzekutimit**

#### **Progresi:**

Për të garantuar trajnimin e vazhdueshëm për përmbaruesit gjyqësor në detyrë është ndjekur procesi për finalizimin e marrëveshjes së bashkëpunimit të nënshkruar më datë 10.06.2025 me Shkollën e Magjistraturës, e cila ka si objekt të saj forcimin e bashkëpunimit për përfshirjen në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës module dhe tema trajnimi të përshtatshme në interes të inspektorëve dhe përmbaruesve gjyqësorë shtetërorë, në funksion të rritjes së eficensës së veprimtarisë dhe zhvillimi profesional të inspektorëve dhe përmbaruesve gjyqësorë shtetëror. Është lidhur marrëveshje me Urdhrin e Psikologut, e cila parashikon edhe zhvillimin e trajnimeve për përmbaruesit gjyqësor në lidhje me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore që përfshijnë të mitur, duke synuar rritjen e kapaciteteve profesionale dhe ndjeshmërinë në raport me të drejtat e fëmijëve.

Gjithashtu, nga Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit është bërë kërkesë për bashkëpunim në realizimin e trajnimeve vazhduese, duke evidentuar tematika konkrete për trajnimin e përmbaruesve gjyqësorë, inspektorëve si dhe punonjësve të administratës, drejtuar ASPA.

Në kuadër të rritjes së kapaciteteve të stafit të shërbimit përmbarimor gjyqësor shtetëror, struktura e burimeve njerëzore ka marrë masat duke evidentuar nevojat për trajnim për stafin e administratës së shërbimit përmbarimor gjyqësor shtetëror dhe i ka dërguar të dhënat e stafit për trajnim, si dhe temat për të cilat janë evidentuar dhe vlerësuar sipas nevojave pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike. Nga Drejtori i Përgjithshëm i Përmbarimit është nxjerrë urdher nr. 53, datë 14.05.2025 "Për organizimin dhe funksionimin e trajnimit të detyrueshëm për përmbaruesit gjyqësor në periudhë prove pranë Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror".

Janë duke u zhvilluar trajnime për përmbaruesit gjyqësor në periudhë prove, bazuar në Urdhrin nr.162 datë 04.12.2025.

#### **% e realizimit të objektivit specifik për janar-dhjetor 2025:**

100%

#### **Problematikat:**

Pjesëmarrja e pjesshme e punonjësve të shërbimit përmbarimor për shkak të ngarkesës së lartë në punë dhe mungesës së trajnimeve të decentralizuara (në rrethe). Mungesë fondesh specifike të alokuara për trajnime praktike apo simuluese mbi procedurat e ekzekutimit. Përditësim i ngadaltë i njohurive në përputhje me ndryshimet ligjore apo praktikë më të mira ndërkombëtare.

#### **Hapat që do të vijojnë:**

Hartimi dhe miratimi i një kalendari vjetor trajnimesh në bashkëpunim me institucionet partnere. Zbatimi i një ankete periodike për të vlerësuar në mënyrë sistematike nevojat për trajnim sipas fushave të specializuara. Organizimi i workshop -eve praktike me pjesëmarrjen e përmbaruesve me përvojë dhe ekspertë të fushës për të diskutuar raste konkrete dhe sfida në praktikë. Monitorimi i pjesëmarrjes dhe vlerësimi i performancës përmes instrumenteve të matjes pas çdo trajnimi.

**Statusi:**

Në proces.

**Masa 3.1.6.5****Rishikimi dhe përditësimi i programeve të trajnimit të punonjësve të shërbimit të përmbartimit gjyqësor për procedurat e ekzekutimit****Progresi:**

Drejtorja e Përgjithshme e Përmbartimit ka ndërmarrë veprime për të rishikuar dhe përditësuar programet ekzistuese të trajnimit për punonjësit e shërbimit të përmbartimit gjyqësor, me fokus në përmirësimin e përmbajtjes, përshtatjen me ndryshimet ligjore dhe nevojat praktike në terren. Janë ndërmarrë hapa për bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës dhe Urdhrin e Psikologut, si dhe është evidentuar nevoja e trajnimeve me tematika specifike në kuadër të forcimit të kapaciteteve të përmbartuesve gjyqësorë dhe inspektorëve, sa i përket procedurave të ekzekutimit të urdhrave të ekzekutimit.

Në zbatim të ligjit të ri organik dhe me qëllim garantimin e zhvillimit profesional të përmbartuesve gjyqësorë shtetërorë, është miratuar programi i formimit vazhdues, me objektiva të qarta, module trajnimi, strukturë organizimi dhe kohëzgjatje të përcaktuar, si dhe rregulla për ndjekjen dhe vlerësimin e aftësive. Ky program është miratuar me Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. 333, datë 18.06.2024, “Për miratimin e programit të formimit vazhdues për përmbartuesit gjyqësorë shtetërorë”.

Gjithashtu, për garantimin e trajnimit të përmbartuesve gjyqësorë shtetërorë në periudhë prove, janë miratuar rregullat për organizimin dhe përmbajtjen e programit për këtë kategori, përfshirë pjesëmarrjen në trajnim, testimin e njohurive të fituara dhe përmbajtjen e modulit tematik. Këto janë miratuar me Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. 433, datë 30.06.2023.

**% e realizimit të objektivit specifik për janar-dhjetor 2025:**

100%

**Problematikat:**

Mungesë fondesh dhe mbështetje teknike për hartimin e materialeve të reja trajnimi, me shembuj praktikë dhe raste studimore. Vonesat në miratimin e programeve të reja, për shkak të mungesës së bashkërendimit institucional dhe kapaciteteve teknike.

**Hapat që do të vijojnë:**

Finalizimi dhe miratimi i përditësimit të programit të trajnimit bazë dhe të avancuar për përmbartuesit gjyqësor dhe inspektorët. Përfshirja e ekspertëve të fushës, përmbartuesve me përvojë dhe institucioneve akademike në rishikimin e përmbajtjes së moduleve ekzistuese.

**Statusi:**

Në proces.

### **Masa 3.1.6.7**

**Hartimi i analizave, duke përfshirë një plan (nga secili institucion), për ekzekutimin në kohë dhe në mënyrë efikase të vendimeve gjyqësore, identifikimin e arsyeve të vonesave dhe sugjerimin e masave korrigjuese**

#### **Progresi:**

Në kuadër të zbatimit të kësaj mase, Drejtoria e Përgjithshme ka ndërmarrë hapa konkretë për përmirësimin e efektivitetit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Në këtë drejtim, me Urdhër nr. 810 Prot., nr. 62, datë 12.06.2025 është miratuar një plan pune për uljen e numrit të dosjeve përmbare të mbartura, i cili synon ekzekutimin tërësisht të vendimeve gjyqësore dhe dhënien e zgjidhjes ligjore duke reduktuar stokun e çështjeve të pazgjidhura ndër vite.

Gjithashtu janë realizuar analiza statistikore dhe cilësore mbi shkaqet kryesore të vonesave në ekzekutim, përfshirë mungesën e bashkëpunimit nga palët, vështirësitë në identifikimin e pasurive të sekuestrueshme dhe zvarritjet procedurale. Janë propozuar masa korrigjuese për çdo kategori problem të konstatuar.

**Së fundi është miratuar dhe Plani i Integritetit të Shërbimit Përmbare Gjiqësor Shtetëror 2025 – 2027. Ky plan përmban analizën e risqeve institucionale, masat parandaluese dhe planin e veprimit për rritjen e transparencës, etikës profesionale dhe integritetit në ushtrimin e veprimtarisë përmbare.**

#### **% e realizimit të objektivit specifik për janar-dhjetor 2025:**

100%

#### **Problematikat:**

Zbatimi i pabarabartë i planit në të gjitha zyrat vendore përmbare, për shkak të ngarkesës së lartë të punës.

#### **Hapat që do të vijnë:**

Zbatimi i monitorimit periodik të progresit të zbatimit të planit të miratuar për uljen e numrit të dosjeve përmbare të mbartura. Hartimi i analizave periodike mbi efektshmërinë e planit. Forcimi i bashkëpunimit me institucionet e tjera.

#### **Statusi:**

E realizuar.

### **Masa 3.1.6.8**

**Zbatimi i masave të parashikuara në analiza dhe në plan veprimi për ekzekutimin në kohë dhe në mënyrë efikase të vendimeve gjyqësore.**

#### **Progresi:**

Drejtoria e Përgjithshme e Përmbaremit në zbatim të objektivave strategjike për rritjen e efikasitetit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, ka filluar zbatimin e masave të parashikuara në analizat vlerësuese dhe në planin e veprimit të miratuar me Urdhër nr. 810 Prot., nr. 62, datë 12.06.2025 për uljen e numrit të dosjeve të mbartura.

Paralelisht, janë marrë masa konkrete në kuadër të **Planit të Zhvillimit të Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror**, të miratuar me Urdhër nr. 28, datë 07.03.2025, i cili përmban masa afatshkurtra dhe afatmesme për përmirësimin e funksionimit të SHPGJSH, forcimin e kapaciteteve teknike dhe njerëzore, si dhe vendosjen e standardeve të reja në performancë.

Zbatimi i masave ka nisur ndër të tjera përmes identifikimit të dosjeve prioritare, rihetimit të pasurisë së sekuestrueshme të pasurisë së debitorit, bashkëpunimit ndërinstitucional dhe raportimit të brendshëm për matjen e progresit.

**% e realizimit të objektivit specifik për janar-dhjetor 2025:**

100%

**Problematikat:**

Kapacitete të kufizuara njerëzore dhe teknike në disa zyra përmbartimore, që ndikojnë në zbatimin me ritme të njëjta të masave të planifikuara. Mungesë e bashkëpunimit ndërinstitucional.

**Hapat që do të vijojnë:**

Zbatimi i të gjitha masave të përcaktuara në planin e zhvillimit dhe planin e veprimit, me monitorim të vazhdueshëm nga DPP. Inspektime të brendshme tematike në zyrat vendore përmbartimore për të vlerësuar zbatimin në praktikë të masave. Vlerësimi i rezultateve të zbatimit të planit të zhvillimit.

**Statusi:**

Në proces.

**Masa 3.1.6.9**

**Organizimi i trajnimeve me qëllim ngritjen e një mekanizmi efikas për vlerësimin e pranueshmërisë dhe arsyetimin e ankesave për të shmangur praktikën e ankimit automatik në Avokaturën e Shtetit.**

**Progresi:**

Gjatë periudhës raportuese nuk janë realizuar trajnime specifike për këtë qëllim. Megjithatë, nevoja për ngritjen e një mekanizmi efikas për vlerësimin e pranueshmërisë dhe arsyetimin e ankesave është identifikuar si e rëndësishme dhe do të evidentohet në trajnimet e ardhshme që do të organizohen nga Shkolla e Magjistraturës, në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbartimit.

**% e realizimit të objektivit specifik për janar-dhjetor 2025:**

50%

**Problematikat:**

Mungesa e organizimit të trajnimeve të posaçme mbi këtë tematikë. Mungesë bashkëpunimi institucional me Avokaturën e Shtetit për të përcaktuar kritere të qarta mbi rastet që duhen ndjekur me ankesa dhe ato që duhen lënë pa veprim.

**Hapat që do të vijojnë:**

Evidentimi i kësaj nevojë specifike në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, për ta përfshirë si modul të veçantë në programin e trajnimeve për përmbaruesit dhe inspektorët.

**Statusi:**

Në proces.

**Masa 3.1.6.10**

**Përmirësimi i bashkëpunimit dhe koordinimit me institucione të tjera të cilat kanë funksione lidhur me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore nëpërmjet organizimit të takimeve të përbashkëta, seminareve, diskutimeve, masave të përbashkëta etj.**

**Progresi:**

DPP ka evidentuar nevojën e një takimi dy palësh me ASHK dhe DPSHTRR, sa i përket moszbatimit të Urdhrave të Sekuestros nga përmbaruesit gjyqësor, si dhe me IKMT mbi mosmbështetjen në ekzekutim me fadromë dhe fuqi punëtore. Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë duke i propozuar ngritjen e një grupi "ad hoc" me qëllim zgjidhjen e ngërçit ligjor. Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit në funksion të ekzekutimit të titujve ekzekutivë dhe bazuar në problematikat e hasura, të konstatuara nëpërmjet verifikimit të ankesave dhe inspektimeve të kryera pranë Zyrave Përmbarimore ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës dhe Urdhrin e Psikologut. Marrëveshja me Shërbimin e Provës është kryer me qëllim këmbimin e informacionit (në lidhje me adresat e palëve debitoare, orientimin e tyre drejt shërbimeve publike etj.) të të dy institucioneve. Marrëveshja me Urdhrin e Psikologut është lidhur me qëllim ofrimin e shërbimit falas nga psikologët për rastet e pamjaftueshmërisë financiare për titujt ekzekutivë me objekt takim fëmije, marrje fëmije etj. Nëpërmjet kësaj marrëveshje gjithashtu është siguruar trajnimi i përmbaruesve gjyqësorë.

**% e realizimit të objektivit specifik për janar-dhjetor 2025:**

80%

**Problematikat:**

Pengesë në bashkëpunimin nga ASHK dhe DPSHTRR dhe IKMT, duke mos zbatuar urdhrat e sekuestros së përmbaruesve gjyqësorë apo mos ofrimit të mbështetjes në ekzekutim me fadromë dhe fuqi punëtore. Moszbatimit i sekuestrove sjell mosekzekutim të titujve ekzekutivë, uljen e efikasitetit dhe efincencës së shërbimit.

Hapat që do të vijojnë:

Monitorimi i zbatimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit. Organizimi i tryezave të përbashkëta ndër-institucionale

**Statusi:**

Në proces.

**Masa 3.3.4.1**

**Hartimi i analizave duke përfshirë një plan (nga secili institucion), për ekzekutimin në kohë dhe mënyrë efikase të vendimeve penale, identifikimin e arsyeve të vonesave dhe sugjerimin e masave korrigjuese.**

**Progresi:**

Gjatë periudhës raportuese është ndërmarrë një analizë e hollësishme për ekzekutimin e vendimeve penale dhe është hartuar **Plani i Punës** për uljen e numrit të dosjeve të mbartura, miratuar me urdhër nr. 810 Prot., nr. 62, datë 12.06.2025. Ky plan përmban masa konkrete edhe për vendimet penale, duke synuar përmirësimin e ekzekutimit të tyre në kohë dhe me efikasitet.

**Plani i Zhvillimit të Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror** miratuar me urdhër nr. 28, datë 07.03.2025, përfshin objektiva gjithëpërfshirëse për përmirësimin e performacës së zyrave vendore përmbartimore, përfshirë edhe për ekzekutimin e vendimeve penale.

Gjithashtu, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit në funksion të ekzekutimit të vendimeve penale ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës.

**% e realizimit të objektivit specifik për janar-dhjetor 2025:**

100%

**Problematicat:**

Mungesa e trajnimeve të specializuara për procedurat përkatëse të ekzekutimit të vendimeve penale. Ngarkesë e lartë e punës së përmbartuesve gjyqësorë shtetëror.

**Hapat që do të vijojnë:**

Zbatimi i masave të parashikuara në të dy planet. Monitorimi periodik i progresit për të identifikuar në kohë zbatimin e masave dhe adresimin e problematikave. Trajnimi i përmbartuesve mbi ekzekutimin e vendimeve penale.

**Statusi:**

Në proces.

**Masa 3.3.4.2**

**Hartimi i analizës mbi nevojën e ndryshimeve ligjore lidhur me dispozitat e ekzekutimit të vendimeve të gjykatave speciale.**

**Progresi:**

Kjo masë është parashikuar për tu realizuar në vitin 2026. Gjithsesi, gjatë periudhës raportuese janë zhvilluar diskutime të vazhdueshme me përmbartues gjyqësor dhe prokuroritë, si dhe janë hartuar komunikime dhe relacione të brendshme, ku është evidentuar nevoja për ndërhyrje në kuadrin ligjor që rregullon ekzekutimin e vendimeve penale. Në veçanti, është identifikuar një boshllëk ligjor lidhur me mënyrën e ekzekutimit të gjobave penale që përfitojnë nga amnistia, pasi neni 616 i Kodit të Procedurës Civile nuk parashikon pushimin e ekzekutimit të urdhrit të ekzekutimit nga përmbartuesi gjyqësor për shkak të përfitimit nga amnistia. Kjo situatë ka sjellë mospërputhje në praktikë, si nga ana e përmbartuesve, ashtu edhe nga vetë prokuroritë, duke krijuar paqartësi procedurale dhe mungesë të një qëndrimi të unifikuar në interpretimin dhe zbatimin e ligjit.

Në kuadër të përgatitjes së projektprogramit të përgjithshëm analitik të projektakteve për Ministrinë e Drejtësisë për vitin 2026, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit ka përcjellë propozime për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8/2023 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror. Qëllimi i këtij propozimi është përmirësimi i kuadrit ligjor që rregullon veprimtarinë e shërbimit

përmbartimor shtetëror, në drejtim të forcimit të funksionimit institucional, rritjes së transparencës dhe sigurimit të një administrimi më efikas dhe të paanshëm të procedurës së ekzekutimit. Ndryshimet e propozuara synojnë qartësimin e dispozitave ligjore që lidhen me caktimin dhe lirimin nga detyra të drejtuesve të zyrave përmbartimore, saktësimin e procedurave për vlerësim, shpërblim dhe përgjegjësi disiplinore të përmbartuesve, garantimin e barazisë ndërmjet kreditorit dhe debitorit në të drejtën për informim, korrigjimin e pasaktësive terminologjike dhe harmonizimin e kompetencave ndërmjet Drejtorit të Përgjithshëm të Përmbartimit, Këshillit të Përmbartimit dhe Ministrit të Drejtësisë. Objektivi kryesor është përmirësimi i shërbimit përmbartimor gjyqësor shtetëror bazuar në profesionalizëm, përgjegjësi, integritet dhe efikasitet, në përputhje me parimet e ligjshmërisë, transparencës dhe standardet evropiane të administratës publike.

Në raportet e hetimeve administrative të hartuara mbi verifikimin e veprimeve përmbartimore dhe administrative të përmbartuesve gjyqësorë shtetërorë janë evidentuar problematika të cilat lidhen me mungesën e zgjidhjes ligjore si dhe të mungesës së parashikimeve ligjore, në përfundim të së cilave është kërkuar propozimi i ndryshimeve ligjore dhe dërgimi pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Kodifikimit dhe Legjislacionit, pranë Ministrisë së Drejtësisë. Gjithashtu DPP ka përcjellë pranë Ministrisë së Drejtësisë, komentet dhe sugjerime mbi draft Kodin e ri Penal. Komentet e parashtruara mbi draft Kodin e ri Penal, synojnë rritjen e efektivitetit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe forcimin e rolit të përmbartuesit gjyqësor në sistemin e drejtësisë.

#### **% e realizimit të objektivit specifik për janar-dhjetor 2025:**

70%

#### **Problematikat:**

Boshllëk ligjor mbi procedurën që duhet ndjekur nga përmbartuesi kur subjekti përfiton nga ligji për amnistin. Praktikë jo e unifikuar ndërmjet institucioneve, që sjell zvarritje në ekzekutim ose ndërprerje joformale të procedurave. Rrezik për mosrespektim të vendimeve penale për shkak të mungesës së mekanizmave të saktë zbatues në ligj.

#### **Hapat që do të vijojnë:**

Hartimi i analizës mbi nevojën e ndryshimeve ligjore lidhur me dispozitat e ekzekutimit të vendimeve të gjykatave.

#### **Statusi:**

Në proces.

**Sa i përket Pasaportës së Treguesve të Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror, për periudhën Janar – Dhjetor 2025, ku indikatorë është “Numri i dosjeve përmbartimore të ekzekutuara tërësisht në raport me numrin total të dosjeve përmbartimore të regjistruara” ku për vitin 2025 duhet të jetë vlera bazë e vitit 2024 + 5%, rezultojnë të dhënat si më poshtë:**

| Totali i Çështjeve sipas statistikës zyrtare | Në ekzekutim brenda afateve procedurale dhe me afate të plotësuara | Të ekzekutuara tërësisht |
|----------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------|--------------------------|
| 53.978                                       | 39.922                                                             | 8896                     |

Në këtë tabelë nuk përfshihen të dhënat mbi dosjet përmbartimore me objekt - takim fëmijë, pension ushqimor, marrje fëmijë në kujdestari, urdhra mbrojtje dhe urdhra të menjëhershëm mbrojtje.

Në periudhën Janar – Dhjetor 2025 janë derdhur në buxhetin e shtetit **120,841,555 lekë**. Krahësuar me periudhën Janar – Dhjetor 2024, të ardhurat janë rritur me **24,671,627 lekë**, pasi në vitin 2024 të ardhurat e derdhura në buxhet kanë qenë **96,169,928 lekë**.

Gjatë periudhës Janar– Dhjetor 2025, treguesit kryesorë të performancës së Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror dëshmojnë një rritje të konsiderueshme të efikasitetit, veçanërisht në drejtim të të ardhurave të derdhura në buxhetin e shtetit. Ky progres lidhet drejtpërdrejt me forcimin e procedurave përmbartimore, ekzekutimin tërësisht të çështjeve përmbartimore dhe angazhimit të zyrave vendore përmbartimore për të ulur numrin e dosjeve përmbartimore të mbartura, duke u dhënë zgjidhje ligjore. Rritja e të ardhurave shoqërohet gjithashtu me forcimin e inspektimeve dhe me investimet në përmirësimin e infrastrukturës së zyrave, sidomos në hapësirat ku zhvillohen shërbime të ndjeshme si takimet e fëmijëve. Këto rezultate, të kombinuara me rritjen e kapaciteteve profesionale përmes trajnimeve fillestare dhe vazhduese, krijojnë bazën për një shërbim më cilësor, më transparent dhe më të aksesueshëm për qytetarët.

## **STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE E DREJTËSISË PËR TË MITUR 2022 - 2026**

Në kuadër të hartimit të raportit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë për të Mitur 2022 – 2026 për periudhën Janar – Dhjetor 2025, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit ka raportuar si më poshtë:

### **Masa**

**2.1.1 Vlerësimi dhe përmirësimi i legjislacionit në fushën civile, familjare, administrative lidhur me garantimin e të drejtave të fëmijës në përputhje me standardet ndërkombëtare.**

### **Progresi:**

Në raportet e hetimeve administrative të hartuara mbi verifikimin e veprimeve përmbartimore dhe administrative të përmbartuesve gjyqësorë shtetërorë janë evidentuar problematika të cilat lidhen me mungesën e zgjidhjes ligjore si dhe të mungesës së parashikimeve ligjore, në përfundim të së cilave është kërkuar propozimi i ndryshimeve ligjore dhe dërgimi pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Kodifikimit dhe Legjislacionit, pranë Ministrisë së Drejtësisë. Gjithashtu DPP ka përcjellë pranë Ministrisë së Drejtësisë, komentet dhe sugjerime mbi draft Kodin e ri Penal. Komentet e parashtruara mbi draft Kodin e ri Penal, synojnë rritjen e efektivitetit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe forcimin e rolit të përmbartuesit gjyqësor në sistemin e drejtësisë.

**% e realizimit të objektivit specifik për janar-dhjetor 2025:**

100%

### **Problematikat:**

Mungesa e unifikimit të praktikës përbarimore për shkak të nevojës së ndryshimeve ligjore apo mungesës së parashikimeve ligjore.

**Hapat që do të vijnë:**

Në vijim do të përcillen analiza të tjera sipas rastit pranë Ministrisë së Drejtësisë.

**Statusi:**

Realizuar.

**Masa**

**2.1.1.2 Zhvillimi i tryezave me të gjithë profesionistët që punojnë me dhe për fëmijët me qëllim prezantimin dhe diskutimin e gjetjeve, rekomandimeve dhe vlerësimin e nevojave për përmirësime të ligjeve dhe/ose aktet nënligjore në fushën civile, familjare administrative.**

**Progresi:**

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Përbarimit janë zhvilluar takime me përfaqësues të Urdhrit të Psikologut dhe OJF, me qëllim bashkëpunimin ndërinstitucional në funksion të ekzekutimit me sukses të titujve ekzekutivë "takim fëmije" dhe "marrje fëmije", ku do të mundësohet ofrimi falas i shërbimit të psikologut për palët që nuk kanë mundësi financiare, trajnimi i përbaruesve gjyqësorë mbi ekzekutimin e çështjeve që kanë të bëjnë me fëmijët. Nëpërmjet mbështetjes së Terre des Hommes, është mundësuar mbështetje në ekzekutimin e dosjeve përbarimore « takim fëmije » dhe « marrje fëmije », për prindërit që nuk kanë mundësi të paguajnë asistencën e psikologut, dhe kjo gjë është mbuluar financiarisht nga Terre des Hommes. Falë mbështetjes së Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA), zbatuar nga Terre des Hommes Shqipëri, dhe në kuadër të masave të parashikuara në Strategjinë Ndërsëktoriale të Drejtësisë, është përfunduar rikonstrukcioni dhe përshtatja e një hapësire të posaçme për realizimin e takimeve të fëmijëve pranë Zyrës Përbarimore Tiranë. Ky investim synon përmirësimin e mirëqenies së fëmijëve, uljen e konfliktualitetit midis palëve dhe rritjen e efektivitetit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore në këtë fushë.

**% e realizimit të objektivit specifik për janar-dhjetor 2025:**

100%

**Problematikat:**

Nevoja e bashkëpunimit me DPSHTRR dhe ASHK mbi aplikimin e tarifave për vendosjen e sekuestrosve konservative në dosjet përbarimore me objekt - pensione ushqimore.

**Hapat që do të vijnë:**

Do të vijohet me takime periodike me përfaqësues ndërinstitucional dhe OJF me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit përbarimor për ekzekutimin e çështjeve përbarimore që kanë të bëjnë me fëmijët. Do të vijohet me takime me përfaqësues të ASHK, DPSHTRR mbi ekzekutimin e dosjeve me objekt - pensione ushqimore

**Statusi:**

Në proces.

## **Masa**

**2.1.3 Krijimi i praktikave të mira për mbrojtjen e fëmijës dhe marrjen e masave të përkohshme të mbrojtjes së fëmijës në rastet e gjyqimeve familjare, veçanërisht në rastet e kujdestarisë, detyrimi për ushqim, caktimit të përgjegjësisë prindërore, zgjidhjes së martesës të prindërve ose kur fëmija është viktimë e dhunës në familje ose formave të tjera të abuzimit.**

### **Progresi:**

Gjatë periudhës janar–dhjetor, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit ka kontribuar në procesin e hartimit dhe shqyrtimit të katër akteve nënligjore në zbatim të ligjit të ri organik të shërbimit përmbartimor. Këto instrumente synojnë të fuqizojnë kuadrin ligjor dhe institucional për trajtimin me përgjegjësi të çështjeve që përfshijnë fëmijë, veçanërisht në procedurat përmbartimore që lidhen me kujdestarinë, pensionin ushqimor dhe të drejtën e takimit.

Gjithashtu, strukturat përmbartimore shtetërore kanë ndjekur me përparësi dhe përpikmëri zbatimin e vendimeve gjyqësore me objekt "pension ushqimor", "takim me fëmijë" dhe "kujdestari", duke u udhëhequr nga parimi i interesit më të lartë të fëmijës. Aktualisht, janë në shqyrtim mundësitë për forcimin e mëtejshëm të praktikave dhe mekanizmave për mbrojtjen e fëmijës, përfshirë rastet që kërkojnë masa të përkohshme mbrojtjeje.

Nëpërmjet mbështetjes së Terre des Hommes, është mundësuar mbështetje në ekzekutimin e dosjeve përmbartimore « takim fëmije » dhe « marrje fëmije », për prindërit që nuk kanë mundësi të paguajnë asistencën e psikologut, dhe kjo gjë është mbuluar financiarisht nga Terre des Hommes.

### **% e realizimit të objektivit specifik për Janar-Dhjetor 2025:**

100%

### **Problematikat:**

Mbingarkesa dhe volumi i punës.

### **Hapat që do të vijnë:**

Identifikimi i çdo problematike apo praktike të vlefshme në vijimësi dhe adresimi i tyre për tu reflektuar në ndryshime të miratuara me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të akteve ligjore dhe nënligjore në kuadër të përmirësimit dhe garantimit të një shërbimi cilësor sa i përket ekzekutimit të titujve ekzekutivë në terësi si dhe veçanërisht të titujve ekzekutivë me objekt "pension ushqimor" "takim me fëmijë" dhe "kujdestari fëmijë".

Ndjekja në vijimësi e procesit për garantimin e trajnimit të përmbartuesve gjyqësorë shtetërore për këto objekt çështjesh.

### **Statusi:**

Realizuar.

## **Masa**

**2.1.3.5 Monitorimi i zbatimit të përmirësimeve ligjore dhe të ekzekutimit të vendimeve të çështjeve të adresuara në masë.**

### **Progresi:**

Gjatë periudhës Janar–Dhjetor 2025, Drejtoria e Inspektimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit ka ushtruar kontroll mbi veprimtarinë procedurale dhe administrative në zyrat vendore përmbartimore, në zbatim të planit vjetor të inspektimit dhe mbi bazë ankese. Në përfundim të inspektimeve janë dhënë rekomandimet dhe propozimet përkatëse për përmirësimin e punës së përmbartuesve gjyqësorë.

Në vijimësi, mbi bazën e Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Përmbartimit, nga të gjitha zyrat vendore përmbartimore është realizuar raportimi mujor mbi të dhënat statistikore për çështjet përmbartimore, përfshirë ato që kanë për objekt: “takim me fëmijë”, “marrje fëmije në kujdestari” dhe “pension ushqimor”.

Gjithashtu, zbatimi i ligjit nr. 8/2023 “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror” ka qenë një nga objektivat kryesore gjatë kësaj periudhe. Si pjesë e këtij procesi, është dhënë kontribut konkret në vlerësimin dhe hartimin e katër akteve nënligjore në zbatim të ligjit të ri organik, të cilat pritet të garantojnë forcimin e kapaciteteve profesionale të përmbartuesve gjyqësorë shtetërorë, si dhe sigurimin e një procesi ligjor të rregullt dhe pa vonesa për të gjitha çështjet, përfshirë ato që lidhen me fëmijët. Shërbimi Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror ka ndjekur me prioritet veprimet procedurale për realizimin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, brenda afateve të arsyeshme ligjore, për çështjet me objekt “pension ushqimor”, “takim me fëmijë” dhe “kujdestari fëmije”, në përmbushje të misionit për ekzekutimin e titujve ekzekutivë dhe garantimin e të drejtës së kreditorit.

Referuar të dhënave statistikore për periudhën Janar–Dhjetor 2025, rezulton një total prej 10.222 çështjesh përmbartimore që lidhen me të mitur, të ndara si më poshtë:

8646 çështje me objekt “pension ushqimor”, nga të cilat:

64 janë ekzekutuar tërësisht,

8420 janë në proces ekzekutimi të vazhdueshëm,

72 janë pushuar me kërkesë të kreditorit ose me vendim gjykate,

30 janë pezulluar me kërkesë të kreditorit ose me vendim gjykate.

1511 çështje me objekt “takim me fëmijë”, nga të cilat:

26 janë ekzekutuar tërësisht,

1263 janë në proces ekzekutimi të vazhdueshëm,

95 janë pushuar me kërkesë të kreditorit ose me vendim gjykate,

58 janë të pezlluara.

65 çështje me objekt “kujdestari fëmije”, nga të cilat:

8 janë ekzekutuar tërësisht,

44 janë në proces ekzekutimi të vazhdueshëm,

11 janë pushuar me kërkesë të kreditorit ose me vendim gjykate,

2 janë të pezlluara.

### **% e realizimit të objektivit specifik për janar-dhjetor 2025:**

100%

### **Problematikat:**

1-Mbingarkesa dhe volumi i punës, i cili nuk ruan një raport normal midis dosjeve përmbartimore.

2-Infrastruktura e zyrave vendore përmbartimore ka ndikim të ndjeshëm në ekzekutimin e titujve ekzekutivë e për rrjedhojë për të garantuar shërbim cilësor.

3-Vendime gjyqësore ku nuk është vlerësuar parimi i interesit më të lartë të fëmijës, sjellin vështirësi në ekzekutim duke sjellë vështirësi në zbatimin e tyre.

4- Paaftësi paguese e prindit debitor.

5-Mosparapagimi i shpenzimeve (per psikolog) nga kreditori sjell në mosekzekutim të vendimeve gjyqësore, etj.

6-Moszbatimi i urdhrave të sekuestros konservative nga ASHK dhe DPSHTRR pasi kërkojnë tarifë shërbimi edhe për dosjet me objekt – pension ushqimor.

### **Hapat që do të vijojnë:**

Identifikimi i çdo problematike dhe adresimi i tyre për të reflektuar ndryshim dhe përmirësim të praktikave, akteve ligjore dhe ato nënligjore.

Ndjekja në vijimësi e procesit për garantimin e trajnimit të përmbaruesve gjyqësorë shtetërorë për këto objekt çështjesh.

Ndjekja, monitorimi dhe kontrolli me përparësi i ekzekutimit të titujve ekzekutivë me objekt “pension ushqimor”, “takim me fëmijë”, dhe “kujdestari fëmije” në vijimësi, për të garantuar ekzekutim të tyre të udhëhequr nga parimi i interesit më të lartë të fëmijës si dhe parimi i ligjshmërisë.

### **Statusi:**

Në proces.

## **Masa**

**2.2.1 Vlerësimi dhe përditësimi i programeve të formimit fillestar dhe formimit vazhdues nga secili institucion që punon me ose për fëmijët duke specifikuar trajnimet sipas fushave të përcaktuara në KDPM (neni 26 KDPM) dhe bërja transparente e tyre në faqen zyrtare të institucionit.**

### **Progresi:**

Në zbatim të ligjit të ri organik dhe me qëllim garantimin e zhvillimit profesional të përmbaruesve gjyqësorë shtetërorë, është miratuar programi i formimit vazhdues, me objektiva të qarta, module trajnimi, strukturë organizimi dhe kohëzgjatje të përcaktuar, si dhe rregulla për ndjekjen dhe vlerësimin e aftësive. Ky program është miratuar me Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. 333, datë 18.06.2024, “Për miratimin e programit të formimit vazhdues për përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë”.

Gjithashtu, për garantimin e trajnimit të përmbaruesve gjyqësorë shtetërorë në periudhë prove, janë miratuar rregullat për organizimin dhe përmbajtjen e programit për këtë kategori, përfshirë pjesëmarrjen në trajnim, testimin e njohurive të fituara dhe përmbajtjen e modulit tematik. Këto janë miratuar me Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. 433, datë 30.06.2023.

Në funksion të zbatimit të këtyre akteve, gjatë kësaj periudhe është realizuar trajnimi i detyrueshëm i 9 (nëntë) përmbaruesve gjyqësorë në periudhë prove, sipas Urdhrit nr. 53, datë 14.05.2025, me një kohëzgjatje prej 200 orësh, bazuar në një program të detajuar tematik dhe kalendar aktiviteteve.

Për forcimin e bashkëpunimit institucional dhe për rritjen e cilësisë së trajnimeve, janë nënshkruar dy marrëveshje bashkëpunimi:

Me Shkollën e Magjistraturës, për përfshirjen e përmbaruesve gjyqësorë shtetërorë dhe inspektorëve në programin e formimit vazhdues, si dhe për organizimin e konferencave, leksioneve të hapura dhe aktiviteteve

të përbashkëta. Trajnimet do të zhvillohen në klasë të përbashkët me gjyqtarë dhe prokurorë, të cilët gjithashtu janë subjekte që trajtojnë çështje që lidhen me fëmijët.

Me Urdhrin e Psikologut, me qëllim ofrimin e mbështetjes psikologjike falas gjatë procedurave të ekzekutimit, trajnimin e përmbaruesve që trajtojnë çështje të ndjeshme që lidhen me fëmijët dhe edukimin në vazhdim, deri në identifikimin e një liste të përmbaruesve të trajnuar për këtë kategori çështjesh.

Të dy marrëveshjet e bashkëpunimit janë publikuar në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit.

Në vijim, do të sigurohet që përmbajtja e moduleve të formimit t'i referohet drejtpërdrejt fushave të përcaktuara në nenin 26 të KDPM-së, për të garantuar përputhshmëri të plotë me standardet për mbrojtjen e fëmijës.

"Në zbatim të marrëveshjes me Shkollën e Magjistraturës nga përmbaruesit gjyqësor janë duke u ndjekur trajnimet me temë:

1. ""Kujdestaria alternative me bazë familjen dhe ndarja e eksperiencave dhe vendimeve gjyqësore për zbatimin e interesit më të lartë të fëmijës. Të drejtat e fëmijëve"" .

2.Problematika të hasura në praktikën gjyqësore për zbatimin e Konventës së Hagës Për Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijës, 1980, ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me Ligjin nr. 9446/2005. Shtyllat kryesore dhe funksionet e Konventës, mjetet në dispozicion dhe kuptimi i instituteve, fusha e zbatimit. Kuptimi i parimit të interesit më të lartë të fëmijës në rastet e rrëmbimit civil ndërkombëtar. Marrëdhëniet ndërmjet Konventës së Hagës dhe Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, sipas jurisprudencës së GjEDNJ-së.

3. Drejtësia miqësore për të miturit. Teknikat e intervistimit të të miturve.

Nga DPP janë duke u zhvilluar temat e trajnimit për përmbaruesit gjyqësor në periudhe prove, bazuar në Urdhrin nr.162 datë 04.12.2025:

1. Veprimtaria procedurale për ekzekutimin e titujve ekzekutivë me objekt takim fëmije dhe pension ushqimor.

2. Rëndësia e psikologut në titujt ekzekutivë me objekt takim fëmije.

3. Ndalimi i shumës për palën debitore për titujt ekzekutivë me objekt pension ushqimor.

4.Rëndësia e nenit 529 të Kodit të Procedurës Civile në rastet me objekt pension ushqimor.

### **% e realizimit të objektivit specifik për janar-dhjetor 2025:**

90%

### **Problematikat:**

Mungesë fondesh në buxhetin e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor Shtetëror.

### **Hapat që do të vijnë:**

Ndjekja në vijimësi e zbatimit të marrëveshjes së bashkëpunimit me Shkollën e Magjistraturës dhe përfshirja e temave të evidentuara sipas programit të trajnimit, përfshirë edhe nevojat për trajnim lidhur me çështjet përmbarimore me objekt "takim me fëmijë", "pension ushqimor" dhe "kujdestari fëmije" për përmbaruesit gjyqësor shtetëror, në kalendarin e trajnimeve të Shkollës së Magjistraturës për vitin kalendarik 2025 - 2026 dhe ndjekja e trajnimeve sipas kalendarit të miratuar.

Ndjekja në vijimësi e zbatimit të marrëveshjes së bashkëpunimit me Urdhrin e Psikologut dhe realizimin në vijim i trajnimeve të përshtatshme për përmbaruesit gjyqësor shtetëror.

Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit ka mbledhur nevojat e përmbartuesve gjyqësor për trajnimet që do të zhvillohen nga ASPA, në datë 12.11.2025 DPP i është drejtuar ASPA me “Kërkesë për mbështetje në realizimin e trajnimeve” në kuadër të rritjes së performancës së shërbimit, në zbatim të Ligjit 8/2023 si dhe Urdhrit 333 datë 18.06.2024 të Ministrit të Drejtësisë "Për miratimin e programit të formimit vazhdues të përmbartuesit gjyqësor", sipas moduleve të miratuara, bashkëngjitur këtij urdhri.

**Statusi:**

Në proces.

**Masa**

**2.2.1.3 Takime periodike të institucioneve dhe partnerëve vendas dhe ndërkombëtarë trajnuesë në fushën për drejtësi për fëmijët dhe shërbimeve për fëmijët në kontakt/konflikt me ligjin (çdo gjashtë muaj).**

**Progresi:**

Realizimi gjatë kësaj periudhe i dy marrëveshjeve të bashkëpunimit me Shkollën e Magjistratures dhe Urdhrin e Psikologut, për garantimin e trajnimeve si dhe ofrimin e shërbimit psikologjik nga specialistëve të licensuar, falas, për procedurat e ekzekutimit, është mundur nga takimeve periodike të përfaqësve të autorizuar të institucioneve respektive si dhe zbatimi i këtyre marrëveshjeve në vijimësi dhe realizimi i trajnimeve do të mundësojë, edhe takime periodike me gjyqtare, prokurore, psikologë etj .

Nëpërmjet mbështetjes së organizatës Terre des Hommes, është mundur mbështetje në ekzekutimin e dosjeve përmbartimore « takim fëmije » dhe « marrje fëmije », për prindërit që nuk kanë mundësi të paguajnë asistencën e psikologut, dhe kjo gjë është mbuluar financiarisht nga Terre des Hommes.

Falë mbështetjes së Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA), zbatuar nga Terre des Hommes Shqipëri, dhe në kuadër të masave të parashikuara në Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë, është përfunduar rikonstrukcioni dhe përshtatja e një hapësire të posaçme për realizimin e takimeve të fëmijëve pranë Zyrës Përmbartimore Tiranë. Ky investim synon përmirësimin e mirëqenies së fëmijëve, uljen e konfliktualitetit midis palëve dhe rritjen e efektivitetit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore në këtë fushë.

**% e realizimit të objektivit specifik për janar-dhjetor 2025:**

100%

**Problematikat:**

Ecuria e zbatimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit në vijimësi si dhe vendosja e kontakteve të duhura me institucione ndërkombëtare.

**Hapat që do të vijnë:**

Ndjekja në vijimësi e zbatimit të marrëveshjeve. Planifikim dhe përfshirje sipas planifikimit në programet e institucioneve bashkëpunuese dhe zbatimi i tyre. Realizimi i trajnimeve në vijimësi.

**Statusi:**

Realizuar.

**Masa**

#### **2.2.1.6 Publikimi i programeve trajnuese në faqet zyrtare të institucioneve që punojnë me ose për fëmijët bazuar në kërkesat e nenit 32/2 i KDPM**

##### **Progresi:**

Drejtorja e Përgjithshme e Përmbartimit ka publikuar në faqen e saj zyrtare elektronike një sërë dokumentesh që lidhen me organizimin e trajnimeve për përmbartuesit gjyqësorë shtetërorë.

Megjithatë, në përmbajtjen e këtyre publikimeve nuk evidentohen qartësisht programet trajnuese të ndërlidhura specifikisht me kërkesat e nenit 32/2 të Kodit për Drejtësinë Penale për të Mitur (KDPM), të cilat lidhen me standardet e trajnimit për çështjet që përfshijnë fëmijët.

##### **% e realizimit të objektivit specifik për janar-dhjetor 2025:**

80%

##### **Problematikat:**

Ecuria e zbatimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit në vijimësi. Përcaktimi i temave specifike për trajnim sikurse parashikohet në nenet 25 - 32 të KDPM.

##### **Hapat që do të vijnë:**

Publikimi i çdo programi tematik, të miratuar, në zbatim të urdhrit nr. 333, datë 18.06.2024, Urdhërit nr. 433, datë 30.06.2023, si dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit në vijimësi.

##### **Statusi:**

Në proces.

##### **Masa**

**2.2.2 Krijimi/përditësimi i regjistrave të profesionistëve të trajnuar/specializuar në të drejtat e fëmijës dhe sistemin e drejtësisë miqësore për fëmijët nga çdo organ që administron sistemin e drejtësisë ose e mbështet atë dhe profesionistëve në kontakt me fëmijën (në zbatim të nenit 32 pika të KDPM dhe neneve 25-31 të KDPM).**

##### **Progresi:**

Me miratimin e akteve nënligjore që përcaktojnë rregullat për organizimin dhe përmbajtjen e programeve të trajnimit fillestar dhe vazhdues për përmbartuesit gjyqësorë shtetërorë, është përcaktuar detyrimi për krijimin dhe administrimin e regjistrave përkatës nga institucioni trajnues për qëllime administrative dhe akademike. Kjo është parashikuar në Urdhrin nr. 433, datë 30.06.2023, dhe në Urdhrin nr. 333, datë 18.06.2024.

Megjithatë, deri më tani nuk është krijuar, përditësuar apo publikuar ndonjë regjistër i profesionistëve të trajnuar në të drejtat e fëmijës dhe sistemin e drejtësisë miqësore për fëmijët nga Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit apo ndonjë institucion tjetër përkatës. Prandaj, megjithë bazën ligjore të krijuar, kjo masë është në fazën fillestare dhe mbetet ende për t'u realizuar plotësisht.

Në përputhje me këtë, progresi i realizimit të kësaj mase vlerësohet në rreth 50%, duke pasur parasysh miratimin e rregullave dhe organizimin e trajnimeve, por mungesën e krijimit dhe administrimit praktik të regjistrave.

##### **% e realizimit të objektivit specifik për janar-dhjetor 2025:**

50%

**Problematikat:**

Ecuria e zbatimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit në vijimësi. Organizimi i trajnimeve të detyrueshme sipas rastit në vijimësi, si dhe i trajnimeve vazhduese për përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë.

**Hapat që do të vijnë:**

Evidentimi i nevojave për trajnim. Planifikimi në buxhet, sa i përket trajnimeve të detyrueshme. Miratimi i programit tematik. Përfshirja në programin e trajnimeve për përmbarues gjyqësor në kalendarin e aktiviteteve trajnuese të Shkollës së Magjistraturës dhe Urdhrit të Psikologut. Zbatimi i programit dhe realizimit të trajnimeve. Hartimi, miratimi i regjistrit dhe mbajtja e të dhënave për përmbaruesit gjyqësor të trajnuar në regjistrë.

**Statusi:**

Në proces.

**Masa**

**2.2.2.1 Hartimi i një modeli të unifikuar të të dhënave të profesionistëve të trajnuar/specializuar në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse**

**Progresi:**

Me miratimin e akteve nënligjore që përcaktojnë rregullat për organizimin dhe përmbajtjen e programeve të trajnimit fillestar dhe vazhdues për përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë, është përcaktuar detyrimi i institucioneve trajnuese për krijimin dhe administrimin e regjistrave përkatëse të profesionistëve të trajnuar, në funksion të veprimtarisë administrative dhe akademike. Ky detyrim është përcaktuar konkretisht në pikën 3 të nenit 6 të Urdhrit nr. 433, datë 30.06.2023, dhe në nenin 9 të Urdhrit nr. 333, datë 18.06.2024.

Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit ka organizuar trajnimin e detyrueshëm për përmbaruesit gjyqësorë në periudhë prove dhe ka marrë të gjitha masat për të garantuar zhvillimin e trajnimeve vazhduese për përmbaruesit shtetërorë. Megjithatë, modeli i unifikuar i të dhënave për profesionistët e trajnuar nuk është krijuar ende, dhe për pasojë miratimi i një modeli të tillë në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse dhe mbajtja e të dhënave në format të përbashkët mbetet një hap i rëndësishëm që duhet të realizohet në të ardhmen.

Në bazë të këtyre, kjo masë vlerësohet e realizuar në masën 50%, duke u mbështetur në avancimin e kuadrit ligjor dhe organizimin e trajnimeve, por me mungesën e modelit të unifikuar të të dhënave, i cili është planifikuar të hartohet dhe miratohet në vijim.

**% e realizimit të objektivit specifik për janar-dhjetor 2025:**

50%

**Problematikat:**

Organizimi i trajnimeve fillestare dhe vazhduese për përmbaruesit gjyqësor shtetëror.

**Hapat që do të vijnë:**

Evidentimi i nevojave për trajnim. Planifikimi në buxhet, sa i përket trajnimeve të detyrueshme. Miratimi i programit tematik. Përfshirja në programin e trajnimeve për përmbarues gjyqësor në kalendarin e aktiviteteve trajnuese të Shkollës së Magjistraturës dhe Urdhrit të Psikologut. Zbatimi i programit dhe realizimit të trajnimeve. Hartimi, miratimi i regjistrit dhe mbajtja e të dhënave për përmbaruesit gjyqësor të trajnuar në regjistër.

**Statusi:**

Në proces.

**Masa**

**2.2.2.2 Krijimi i regjistrave nga çdo institucion përgjegjës bazuar në modelin e unifikuar me të dhëna të profesionistëve të trajnuar/specializuar**

**Progresi:**

Me miratimin e akteve nënligjore që përcaktojnë rregullat për organizimin dhe përmbajtjen e programeve të trajnimit fillestar dhe vazhdues për përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë, është përcaktuar edhe detyrimi i institucioneve trajnuese për krijimin dhe administrimin e regjistrave përkatëse të profesionistëve të trajnuar, në funksion të veprimtarisë administrative dhe akademike. Konkretisht, ky detyrim përcaktohet në pikën 3 të nenit 6 të Urdhrit nr. 433, datë 30.06.2023, “Për përcaktimin e rregullave për organizimin dhe përmbajtjen e programit të trajnimit, pjesëmarrjen në trajnime, si dhe testimin e njohurive të përfituara për përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë në periudhë prove”, si dhe në nenin 9 të Urdhrit nr. 333, datë 18.06.2024, “Për miratimin e programit të formimit vazhdues për përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë”.

Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit ka organizuar trajnimin e detyrueshëm për përmbaruesit gjyqësorë në periudhë prove dhe ka marrë të gjitha masat për të garantuar zhvillimin e trajnimeve vazhduese në vijimësi për përmbaruesit shtetërorë. Megjithatë, deri tani nuk është krijuar asnjë regjistër i plotë dhe funksional, për pasojë miratimi dhe mbajtja e një regjistri të centralizuar me të dhëna të profesionistëve të trajnuar mbetet një hap që duhet realizuar në të ardhmen.

Kjo masë është vlerësuar e realizuar në masën 50%, duke pasur parasysh avancimin e akteve ligjore dhe organizimin e trajnimeve, por pa krijimin aktual të regjistrave të nevojshëm. Hartimi dhe implementimi i regjistrit sipas një formati të unifikuar në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse mbetet një veprim që do të ndërmerret në vijim për të plotësuar plotësisht këtë detyrim.

**% e realizimit të objektivit specifik për janar-dhjetor 2025:**

50%

**Problematikat:**

Ecuria e zbatimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit në vijimësi. Organizimi i trajnimeve fillestare dhe vazhduese për përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë.

**Hapat që do të vijojnë:**

Evidentimi i nevojave për trajnim. Planifikimi në buxhet, sa i përket trajnimeve të detyrueshme. Miratimi i programit tematik. Përfshirja në programin e trajnimeve për përmbarues gjyqësor në kalendarin e aktiviteteve trajnuese të Shkollës së Magjistraturës dhe Urdhrit të Psikologut. Zbatimi i programit dhe realizimit të

trajnimeve. Hartimi, miratimi i regjistrit dhe mbajtja e të dhënave për përmbauesit gjyqësor të trajnuar në regjistër.

**Statusi:**

Në proces.

**Masa**

**2.2.2.3 Përditësimi i Regjistrave nga çdo institucion**

**Progresi:**

Me miratimin e akteve nënligjore që përcaktojnë rregullat për organizimin dhe përmbajtjen e programeve të trajnimit fillestar dhe vazhdues për përmbauesit gjyqësorë shtetërorë, është përcaktuar detyrimi i institucioneve trajnuese për krijimin dhe administrimin e regjistrave përkatëse të profesionistëve të trajnuar, për qëllime administrative dhe akademike. Ky detyrim formalizohet në pikën 3 të nenit 6 të Urdhrit nr. 433, datë 30.06.2023, si dhe në nenin 9 të Urdhrit nr. 333, datë 18.06.2024.

Drejtoria e Përgjithshme e Përmbaimit ka organizuar trajnime të detyrueshme për përmbauesit gjyqësorë në periudhë prove dhe ka marrë masa për të garantuar vijueshmërinë e trajnimeve për përmbauesit shtetërorë. Megjithatë, deri më tani nuk është krijuar asnjë regjistër funksional dhe i mirëstrukturuar që të mundësojë përditësimin e të dhënave sipas një formati të unifikuar e të miratuar. Për rrjedhojë, as procesi i përditësimit të të dhënave nga institucionet përkatëse nuk ka filluar.

Kjo masë konsiderohet e realizuar në masën 50%, duke pasur parasysh bazën ligjore të vendosur dhe angazhimin institucional për trajnime, por jo funksionimin real të regjistrave apo përditësimin e tyre. Në vijim, do të duhet të krijohet regjistri sipas një modeli të unifikuar në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse dhe të vendoset një mekanizëm periodik për përditësimin e të dhënave.

**% e realizimit të objektivit specifik për janar-dhjetor 2025:**

50%

**Problematikat:**

Ecuria e zbatimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit në vijimësi. Organizimi i trajnimeve fillestare dhe vazhduese për përmbauesit gjyqësor shtetëror. Hartimi dhe miratimi i regjistrit për profesionistët.

**Hapat që do të vijnë:**

Evidentimi i nevojave për trajnim. Planifikimi në buxhet, sa i përket trajnimeve të detyrueshme. Miratimi i programit tematik. Përfshirja në programin e trajnimeve për përmbaues gjyqësorë në kalendarin e aktiviteteve trajnuese të Shkollës së Magjistraturës dhe Urdhrit të Psikologut. Zbatimi i programit dhe realizimit të trajnimeve. Hartimi, miratimi i regjistrit dhe mbajtja e të dhënave për përmbauesit gjyqësorë të trajnuar në regjistër.

**Statusi:**

Në proces.

**Masa**

#### **2.2.2.4 Publikimi i regjistrave në faqet zyrtare të çdo institucioni që punojnë me dhe për fëmijët**

##### **Progresi:**

Me miratimin e akteve nënligjore që përcaktojnë rregullat për organizimin dhe përmbajtjen e programeve të trajnimit fillestar dhe vazhdues për përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë, është sanksionuar detyrimi i institucioneve trajnuese për krijimin dhe administrimin e regjistrave përkatës të profesionistëve të trajnuar, në funksion të veprimtarisë së tyre administrative dhe akademike. Ky detyrim është parashikuar në pikën 3 të nenit 6 të Urdhrit nr. 433, datë 30.06.2023 dhe në nenin 9 të Urdhrit nr. 333, datë 18.06.2024.

Gjithashtu, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit ka zhvilluar trajnimin e detyrueshëm për përmbaruesit gjyqësorë në periudhë prove dhe ka ndërmarrë masat e nevojshme për vazhdimësinë e formimit profesional për këtë kategori. Megjithatë, aktualisht nuk është krijuar ende një regjistër i plotë dhe funksional i të dhënave të profesionistëve të trajnuar, dhe për rrjedhojë nuk është bërë asnjë publikim në faqet zyrtare të institucioneve përkatëse.

Kjo masë konsiderohet e realizuar në masën 50%, duke marrë në konsideratë vendosjen e bazës ligjore dhe angazhimin institucional në trajnimet profesionale. Hapat që mbeten për t'u realizuar përfshijnë: krijimin e regjistrit sipas një modeli të unifikuar, mbajtjen dhe përditësimin e të dhënave në mënyrë të rregullt, si dhe publikimin e regjistrave në faqet zyrtare të çdo institucioni që punon me dhe për fëmijët, në funksion të transparencës dhe përgjegjshmërisë institucionale.

##### **% e realizimit të objektivit specifik për janar-dhjetor 2025:**

50%

##### **Problematikat:**

Ecuria e zbatimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit në vijimësi. Organizimi i trajnimeve fillestare dhe vazhduese për përmbaruesit gjyqësor shtetëror. Hartimi dhe miratimi i regjistrit për profesionistët.

##### **Hapat që do të vijojnë:**

Evidentimi i nevojave për trajnim. Planifikimi në buxhet, sa i përket trajnimeve të detyrueshme. Miratimi i programit tematik. Përfshirja në programin e trajnimeve për përmbarues gjyqësorë në kalendarin e aktiviteteve trajnuese të Shkollës së Magjistraturës dhe Urdhrit të Psikologut. Zbatimi i programit dhe realizimit të trajnimeve. Hartimi, miratimi i regjistrit dhe mbajtja e të dhënave për përmbaruesit gjyqësorë të trajnuar në regjistër.

##### **Statusi:**

Në proces.

##### **Masa**

#### **2.2.10 Fuqizimi i kapaciteteve të punonjësve të shërbimit përmbarimit gjyqësor që trajtojnë çështje të fëmijëve**

##### **% e realizimit të objektivit specifik për janar-dhjetor 2025:**

100%

##### **Progresi:**

Shërbimi Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror, në kuadër të miratimit të ligjit të ri organik dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për rritjen e cilësisë së shërbimit të ekzekutimit, përmes: rritjes së performancës profesionale të përmbartuesve gjyqësorë shtetërorë; garantimit të trajtimit financiar të përshtatshëm me natyrën, përgjegjësitë dhe shkallën e vështirësisë së funksionit; si dhe krijimit të një kuadri të drejtash dhe llogaridhënieje që synon një shërbim përmbartimor gjyqësor të përgjegjshëm, profesional, të besueshëm dhe të orientuar drejt shërbimit ndaj qytetarit.

Ky kuadër ligjor dhe nënligjor është hartuar duke u bazuar në standardet dhe praktikën më të mira ndërkombëtare, duke adresuar në mënyrë të posaçme edhe çështjet që lidhen me të drejtat e fëmijëve.

Referuar të dhënave statistikore mbi çështjet përmbartimore me objekt “pension ushqimor”, “takim me fëmijë” dhe “kujdestari fëmijë”, evidentohet një nivel i lartë përgjegjshmërie nga përmbartuesit gjyqësorë shtetërorë, të cilët në trajtimin e këtyre çështjeve kanë pasur në thelb të veprimtarisë së tyre garantimin dhe efektivitetin e zbatimit të të drejtave të fëmijëve, në nivelin më të lartë të mundshëm.

Fuqizimi i kapaciteteve të përmbartuesve gjyqësorë shtetërorë përmes trajnimeve është tashmë i rregulluar me akte ligjore dhe nënligjore, si dhe është konkretizuar me marrëveshje bashkëpunimi me institucione të akredituara trajnuese. Zbatimi i tyre në praktikë do të vijojë, ndërkohë që është garantuar dhe realizuar pjesërisht përmes trajnimeve të detyrueshme të organizuara për përmbartuesit gjyqësorë në periudhë prove."Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit për vitin 2025 ka vlerësuar dhe përditësuar programet për formimin fillestar dhe vazhdues të përmbartuesve gjyqësor shtetëror dhe në bazë të nevojave të përcjella nga këta të fundit në funksion të përmbushjes së detyrave funksionale si dhe në zbatim të Urdhrit nr.333 datë 18.06.2024 “Për miratimin e Programit të Formimit Vazhdues për përmbartuesit gjyqësorë shtetërorë” ka lidhur Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Shkollën e Magjistraturës nr.801 Prot. datë 10.06.2025, si dhe janë duke u zhvilluar trajnimet për përmbartuesit gjyqësor sipas kalendarit të miratuar. Ky trajnim do të vijojë 6 - mujorin e parë të vitit 2026.

Gjithashtu, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit me urdhër nr.162 datë 04.12.2025 ka miratuar programin e trajnimit të detyrueshëm në periudhë prove. Së bashku me modulën me temat e trajnimit për 2 përmbartues gjyqësor në periudhë prove, bazuar në Urdhrin nr.433 datë 30.06.2023 “Për përcaktimin e rregullave për Organizimin dhe përmbajtjen e programit të trajnimit, pjesëmarrjen në trajnime si dhe testimin e njohurive të përfutuara për përmbartuesit gjyqësor shtetëror në periudhë prove”. Ky trajnim do të vijojë 3 - mujorin e parë të vitit 2026."

### **Problematikat:**

Ecuria e zbatimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit në vijimësi. Organizimi i trajnimeve fillestare dhe vazhduese për përmbartuesit gjyqësor shtetëror. Hartimi dhe miratimi i regjistrit për profesionistët. Mungesa e fondeve në buxhetin e shërbimit përmbartimor gjyqësor shtetëror.

### **Hapat që do të vijnë:**

Evidentimi i nevojave për trajnim. Planifikimi në buxhet. Miratimi i programit tematik. Zbatimi i programit dhe realizimi të trajnimeve. Hartimi i regjistrit, mbajtja e të dhënave dhe përditësimi i tyre për përmbartuesit gjyqësor të trajnuar në regjistrë dhe publikimi i tyre në faqen zyrtare elektronike të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit. Trajnimi i përmbartuesve gjyqësor shtetëror.

### **Statusi:**

Në proces.

## **Masa**

### **2.2.10.1 Vlerësimi periodik i nevojave për trajnim vazhdues**

#### **Progresi:**

Shërbimi Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror, në kuadër të miratimit të ligjit të ri organik dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, ka ngritur një bazë të re ligjore e institucionale që synon rritjen e cilësisë së shërbimit përmbartimor, përmes forcimit të kapaciteteve profesionale të përmbartuesve gjyqësorë shtetërorë. Kjo reformë synon gjithashtu sigurimin e një trajtimi të përshtatshëm financiar në përputhje me përgjegjësitë dhe vështirësinë e funksionit, si dhe vendosjen e një kuadri të drejtash dhe llogaridhënieje që garanton një shërbim përmbartimor të përgjegjshëm, profesional dhe të orientuar nga qytetari.

Në këtë kuadër, është hartuar dhe po zbatohet një kuadër ligjor dhe nënligjor i përputhur me standardet dhe praktikën më të mira ndërkombëtare. Referuar të dhënave statistikore mbi çështje me objekt “pension ushqimor”, “takim fëmije” dhe “kujdestari fëmije”, evidentohet një përkushtim i shtuar i përmbartuesve në trajtimin e këtyre rasteve, me synimin për të garantuar në nivelin më të lartë të mundshëm të drejtat e fëmijëve.

Trajnimi i përmbartuesve gjyqësorë shtetërorë është trajtuar tashmë si një domosdoshmëri për rritjen e profesionalizmit dhe performancës, dhe është i rregulluar me akte përkatëse ligjore e nënligjore. Janë formalizuar marrëveshje bashkëpunimi me institucione të akredituara trajnuese, ndërsa realizimi i trajnimit të detyrueshëm për përmbartuesit në periudhë prove është vlerësuar pozitivisht nga strukturat përgjegjëse.

Vlerësimi dhe identifikimi i nevojave për trajnime në vijimësi është kthyer në një proces të institucionalizuar dhe do të vazhdojë në mënyrë periodike, duke u shoqëruar me hartimin dhe përditësimin e programeve tematike të përshtatura me nevojat e shërbimit dhe zhvillimet ligjore. Bazuar në kërkesat e përcjella nga përmbartuesit gjyqësor, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit i është drejtuar me shkresën nr. 342 prot., datë 28.02.2025 Shkollës Shqiptare të Administratës Publike me qëllim zhvillimin e trajnimeve të përmbartuesve gjyqësor, ku në fokus të kërkesave kanë qënë dhe trajnimet për çështje të së drejtës familjare dhe të miturve. Nderkohë që nga përmbartuesit gjyqësor shtetërorë, në zbatim të marrëveshjes me Shkolën e Magjistraturës janë duke u ndjekur trajnimet me temë: 1. "Kujdestaria alternative me bazë familjen dhe ndarja e eksperiencave dhe vendimeve gjyqësore për zbatimin e interesit më të lartë të fëmijës. Të drejtat e fëmijëve". 2. Problematika të hasura në praktikën gjyqësore për zbatimin e Konventës së Hagës Për Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijës, 1980, ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me Ligjin nr. 9446/2005. Shtyllat kryesore dhe funksionet e Konventës, mjetet në dispozicion dhe kuptimi i instituteve, fusha e zbatimit. Kuptimi i parimit të interesit më të lartë të fëmijës në rastet e rrëmbimit civil ndërkombëtar. Marrëdhëniet ndërmjet Konventës së Hagës dhe Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, sipas jurisprudencës së GjEDNJ-së. 3. Drejtësia miqësore për të miturit. Teknikat e intervistimit të të miturve.

Me qëllim vlerësimin e nevojave për trajnim në muajin Nëntor të 2025 është përcjellë pranë Ministrisë së Drejtësisë tabela përmbledhëse në lidhje me nevojat për trajnim nga Shërbimi Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror. Ky material është dërguar dhe kërkuar nga Shkolla e Administratës Publike në formën e një pyetëso, me qëllim përgatitjen e programit të trajnimit nga ASPA për vitin 2026.

DPP ka dërguar këtë tabelë për plotësim të gjithë punonjësve të Shërbimit Përmbartimor Shtetëror dhe ka reflektuar temat e përzgjedhura prej tyre, shoqëruar me numrin e kërkesave për çdo temë trajnimi. Gjithashtu, me shkresën nr. 342/1 Prot., date 12.11.2025 DPP i është drejtuar ASPA me kërkesë për

mbështetje në realizimin e trajnimeve, në kuadër të rritjes së performancës së shërbimit, në zbatim të Ligjit 8/2023 si dhe Urdhrit 333 datë 18.06.2024 të Ministrit të Drejtësisë "Për miratimin e programit të formimit vazhdues të përmbaruesit gjyqësor", sipas moduleve të miratuara, për vitin 2026.

**% e realizimit të objektivit specifik për janar-dhjetor 2025:**

100%

**Problematikat:**

Mungesa e fondeve në Buxhetin e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor Shtetëror për trajnimin e përmbaruesve gjyqësor shtetëror.

**Hapat që do të vijojnë:**

Identifikimi, mbledhja dhe vlerësimi i nevojave në vijimësi për trajnim për përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë.

**Statusi:**

Në proces.

**Masa**

**2.2.10.2 Trajnimi vazhdues i punonjësve të shërbimit përmbarimor gjyqësor për të drejtat e fëmijëve**

**Progresi:**

Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror, në kuadër të ligjit të ri organik dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, ka hedhur bazat për një sistem të ri të ngritur mbi rritjen e cilësisë së shërbimit të ekzekutimit. Ky sistem synon përmirësimin e performancës profesionale të përmbaruesve gjyqësorë shtetërorë, garantimin e një trajtimi të drejtë financiar në përputhje me përgjegjësitë e funksionit, si dhe forcimin e mekanizmave të llogaridhënies dhe etikës në shërbim të qytetarit.

Bazuar në standardet më të mira ndërkombëtare, është hartuar një kuadër ligjor dhe nënligjor që adreson posaçërisht trajtimin e çështjeve përmbarimore që lidhen me të drejtat e fëmijëve, siç janë ato me objekt "pension ushqimor", "takim me fëmijë" dhe "kujdestari fëmije". Të dhënat statistikore tregojnë një angazhim në rritje të përmbaruesve për garantimin dhe zbatimin efektiv të këtyre të drejtave, në nivelin më të lartë të mundshëm.

Në këtë kuadër, trajnimi vazhdues i përmbaruesve gjyqësorë për çështjet që lidhen me të drejtat e fëmijëve është parashikuar si një prioritet dhe domosdoshmëri për rritjen e kapaciteteve profesionale dhe ndjeshmërisë institucionale. Kjo është e rregulluar tashmë në aktet ligjore dhe nënligjore dhe do të realizohet në bashkëpunim me institucione të akredituara për trajnimin. Tematikat përkatëse janë planifikuar të trajtohen në vijimësi në periudha të caktuara, duke siguruar mbështetje të vazhdueshme profesionale për përmbaruesit gjyqësorë.

**% e realizimit të objektivit specifik për janar-dhjetor 2025:**

100%

**Problematikat:**

Ndjekja në vijimësi e zbatimit të marrëveshjeve të lidhura me institucionet e kredituara për realizimin e trajnimeve vazhduese.

**Hapat që do të vijnë:**

Përfshirja e temave të trajnimit në programin e trajnimit në kalendarin e aktiviteteve të Shkollës së Magjistraturës dhe realizimi i trajnimeve.

**Statusi:**

Në proces.

**Masa****2.2.10.3 Rishikimi dhe përditësimi i programeve të trajnimit të punonjësve të shërbimit të përmbartimit gjyqësor****Progresi:**

Shërbimi Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror, në kuadër të miratimit të ligjit të ri organik dhe akteve nënligjore për zbatimin e tij, ka ndërtuar një bazë të re ligjore dhe institucionale që synon rritjen e cilësisë së shërbimit të ekzekutimit. Kjo reformë ka në thelb përmirësimin e performancës profesionale të përmbartuesve gjyqësorë shtetërorë, sigurimin e një trajtimi të përshtatshëm financiar sipas natyrës dhe përgjegjësisë të funksionit, si dhe ngritjen e një sistemi të drejtash dhe llogaridhënieje për një shërbim përmbartimor të besueshëm, profesional dhe të orientuar nga qytetari.

Në këtë kuadër, janë ndërmarrë hapa konkretë për përmirësimin e kuadrit ligjor e nënligjor, në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare. Njëkohësisht, referuar të dhënave statistikore për çështjet përmbartimore që lidhen me “pensionin ushqimor”, “takimin me fëmijë” dhe “kujdestarinë e fëmijës”, evidentohet një rritje e ndjeshme e ndjeshmërisë dhe përgjegjshmërisë së përmbartuesve në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve.

Trajnimi i përmbartuesve gjyqësorë shtetërorë, veçanërisht në periudhën e provës, është institucionalizuar tashmë dhe realizohet në bashkëpunim me institucione trajnuese kombëtare të akredituara. Programet ekzistuese janë rishikuar dhe përditësuar në përputhje me nevojat e identifikuar nga struktura përkatëse, duke u përshtatur rast pas rasti me zhvillimet ligjore dhe praktike.

Në vijim, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit do të ndërmarrë një proces të thelluar vlerësimi dhe konsultimi ndër-institucional për të përditësuar tërësisht programet e trajnimit, me fokus të veçantë në temat që lidhen me të drejtat e njeriut, etikën profesionale dhe çështjet që lidhen me ekzekutimin e vendimeve në fushën e familjes. Këto programe do të integrohen në mënyrë të strukturuar në trajnimet periodike dhe të detyrueshme për të gjithë përmbartuesit gjyqësor shtetëror.

**% e realizimit të objektivit specifik për janar-dhjetor 2025:**

100%

**Problematikat:**

Ndjekja në vijimësi e zbatimit të marrëveshjeve të lidhura me institucionet e kredituara për realizimin e trajnimeve vazhduese.

**Hapat që do të vijnë:**

Përfshirja e temave të trajnimit në programin e trajnimit në kalendarin e aktiviteteve të Shkollës së Magjistraturës dhe realizimi i trajnimeve.

**Statusi:**

Në proces.

**Masa****2.2.11 Publikimi në faqet zyrtare të institucioneve përkatëse të botimeve të përgatitura dhe shpërndarja tek profesionistët.****Progresi:**

Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit ka ndërmarrë veprime konkrete për rritjen e transparencës dhe qasjes ndaj kuadrit rregullator të shërbimit përmbartimor gjyqësor shtetëror. Çdo akt ligjor dhe nënligjor i miratuar është shpërndarë pranë zyrave vendore të përmbartimit dhe është publikuar në faqen zyrtare elektronike të institucionit.

Në mënyrë të detajuar janë publikuar aktet përkatëse.

Përveç publikimit të akteve normative, në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit publikohen në mënyrë të rregullt analiza mujore dhe progresive, mbi:

Ecurinë e veprimtarisë së ekzekutimit të titujve ekzekutivë;

Ekzekutimin e çështjeve me objekt “takimi me fëmijë”, “kujdestaria e fëmijës”, si dhe “pensioni ushqimor”.

Gjithashtu, çdo informacion mbi veprimtarinë procedurale të shërbimit përmbartimor dhe çdo akt administrativ ligjor i rëndësishëm publikohet në kohë reale në faqen zyrtare të DPP-së, duke garantuar transparencë dhe akses të plotë për profesionistët e fushës.

**% e realizimit të objektivit specifik për janar-dhjetor 2025:**

100%

**Problematikat:**

Mungesa e botimeve të tjera për veprimtarinë ekzekutive.

**Hapat që do të vijojnë:**

Identifikimi i çdo botimi dhe publikimi i tij në faqën zyrtare elektronike si dhe përcjellja e tij zyrave vendore përmbartimore.

**Statusi:**

Realizuar.

**Masa****2.2.11.1 Publikimi në faqet zyrtare të institucioneve përkatëse të botimeve të përgatitura dhe shpërndarja tek profesionistët****Progresi:**

Çdo akt ligjor dhe nënligjor i miratuar që ka të bëjë me kuadrin ligjor rregullator për shërbimin përmbartimor gjyqësor shtetëror është dërguar pranë zyrave vendore përmbartimore si dhe është publikuar në faqen zyrtare elektronike të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit.

Gjithashtu, çdo e dhënë, akt administrativ ligjor, publikim mbi veprimtarinë procedurale të ekzekutimit të titujve ekzekutivë publikohet në faqen zyrtare të DPP-së.

**% e realizimit të objektivit specifik për janar-dhjetor 2025:**

100%

**Problematikat:**

Mungesa e botimeve të tjera mbi veprimtarinë e ekzekutimit.

**Hapat që do të vijojnë:**

Identifikimi i çdo botimi dhe publikimi i tij në faqën zyrtare elektronike, si dhe përcjellja e tij pranë zyrave vendore përmbartimore.

**Statusi:**

Realizuar.

**Masa****2.3.2 Përmirësimi i statistikave për çështjet civile, familjare, administrative dhe penale ku fëmijët janë pjesë ose vendimmarrja ndikon tek fëmijët****Progresi:**

Me urdhrin nr. 36, datë 18.03.2025 "Për raportimin mujor mbi veprimtarinë procedurale dhe administrative të zyrave vendore përmbartimore, Kryetarëve të Zyrave Vendore Përmbarimore dhe përmbartuesve gjyqësorë", është mundësuar përmirësimi i formateve të evidentimit dhe mbledhjes së statistikave mbi veprimtarinë e ekzekutimit të titujve ekzekutivë në përgjithësi si dhe për çështje përmbartimore të adresuara.

Gjithashtu, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit ka përcjellë për miratim draft formatin e ri të statistikave të Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror, po ju drejtohem për të rikujtuar këtë propozim për miratim. Ky format është hartuar me qëllim evindentimin e çështjeve përmbartimore në përputhje me ndryshimet në Kodin e Procedurës Civile dhe për të siguruar një pasqyrim më të saktë të natyrës së dosjeve dhe të statusit të tyre procedural.

**% e realizimit të objektivit specifik për janar-dhjetor 2025:**

100%

**Problematikat:**

Ngarkesa e lartë e punës për përmbartues gjyqësor.

**Hapat që do të vijojnë:**

Ndjekja në vijimësi e zbatimit të urdhrit si dhe identifikimi i nevojës për përmirësim të vazhdueshëm të tij sipas rastit.

**Statusi:**

1 (i realizuar)

**Masa**

### **3.2.5 Përmirësimi i shërbimeve për fëmijët të ofruara në mjedise miqësore në zyrat e shërbimit përmbartimor gjyqësor**

#### **Progresi:**

Shërbimi përmbartimor shtetëror pas shkëputjes nga gjykatat trashëgoi një infrastrukturë jo të përshtatshme, pasojat e të cilës ndikojnë në veprimtarinë përmbartimore, si dhe ndikojnë në veprimtarinë e ekzekutimit të titujve ekzekutivë. Shërbimi Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror ka probleme evidente me mungesën e ambienteve të zyrave. Në kuadër të përmirësimit të shërbimeve të ofruara nga përmbartimi shtetëror si dhe specifikisht në kuadër të përmirësimit të shërbimeve të ofruara në mjedise miqësore në zyrat e shërbimit, është evidentuar nevoja për ambiente si dhe është përsëritur kërkesa për sistemimin e zyrave vendore me ambiente të përshtatshme.

Gjatë kësaj periudhe është mundësuar sistemimi vetëm i Zyrës Përmbartimore Kavajë, Përmet dhe Mat me ambiente të përshtatshme për ushtrim aktiviteti.

#### **% e realizimit të objektivit specifik për janar-dhjetor 2025:**

60%

#### **Problematicat:**

Mungesë fondesh për përshtatje të ambienteve me mjedise miqësore për fëmijë në buxhetin e shërbimit të përmbartimit gjyqësor shtetëror.

#### **Hapat që do të vijojnë:**

Përcaktim i standarteve miqësore për fëmijë, planifikimi në buxhet i kërkesave specifike.

#### **Statusi:**

Në proces.

#### **Masa**

**3.2.5.1 Përcaktimi i standardeve të mjediseve miqësore dhe të përshtatshme për fëmijët në zyrat e shërbimit përmbartimor gjyqësor, përfshirë personat me aftësi të kufizuara.**

#### **Progresi:**

Shërbimi Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror ka probleme evidente me mungesën e ambienteve të zyrave. Në kuadër të përmirësimit të shërbimeve të ofruara nga përmbartimi shtetëror si dhe specifikisht në kuadër të përmirësimit të shërbimeve të ofruara në mjedise miqësore në zyrat e shërbimit, është evidentuar nevoja për ambiente si dhe është përsëritur kërkesa për sistemimin e zyrave vendore me ambiente të përshtatshme.

Gjatë kësaj periudhe është mundësuar sistemimi vetëm i Zyrës Përmbartimore Kavajë, Përmet dhe Mat me ambiente të përshtatshme për ushtrim aktiviteti.

Përshtatja e një ambienti miqësor në zyrat vendore për realizimin e takimeve me fëmijë është një ndër objektivat në vijim për t'u ndjekur dhe realizuar.

#### **% e realizimit të objektivit specifik për janar-dhjetor 2025:**

100%

**Problematikat:**

Mungesë fondesh për përshtatje të ambienteve me mjedise miqësore për fëmijë në buxhetin e shërbimit të përmbartimit gjyqësor shtetëror.

**Hapat që do të vijojnë:**

Përcaktim i standarteve miqësore për fëmijë, planifikimi në buxhet i kërkesave specifike. Për vitin 2026, në Planin e Zhvillimit të Shërbimit është parashikuar në Objektivin nr.10: Rritja e eficiencës së veprimtarisë së përmbartuesve gjyqësorë shtetërorë, në funksion të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore me objekt ""takim fëmije"", ""marrje fëmije në kujdestari"" dhe janë parashikuar si masa në zbatim të këtij objekti.

1-Përmirësimi i shërbimeve për fëmijët të ofruara në mjedise miqësore në zyrat e shërbimit përmbartimor gjyqësor Durrës, Pogradec, Korçë, Gjirokastër.

2- Përcaktimi i standardeve të mjediseve miqësore dhe të përshtatshme për fëmijët në zyrat e shërbimit përmbartimor gjyqësor.

3- Fuqizimi i kapaciteteve me persona të trajnuar në çështjet që kanë lidhje me fëmijët etj.

**Statusi:**

Në proces.

**Masa**

**3.2.5.2 Krijimi i mjediseve miqësore për fëmijën në zyrën e përmbartimit gjyqësor Tiranë**

**Progresi:**

Falë mbështetjes së Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA), zbatuar nga Terre des hommes Shqipëri, dhe në kuadër të masave të parashikuara në Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë, është përfunduar rikonstrukcioni dhe përshtatja e një hapësire të posaçme për realizimin e takimeve të fëmijëve pranë Zyrës Përmbartimore Tiranë. Ky investim synon përmirësimin e mirëqenies së fëmijëve, uljen e konfliktualitetit midis palëve dhe rritjen e efektivitetit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore në këtë fushë.

**% e realizimit të objektivit specifik për janar-dhjetor 2025:**

100%

**Problematikat:**

Mungesë fondesh për përshtatje të ambienteve me mjedise miqësore për fëmijë në buxhetin e shërbimit të përmbartimit gjyqësor shtetëror.

**Hapat që do të vijojnë:**

Zhvillimi i takimeve me fëmijë në ambientin e ri miqësor për fëmijë.

**Statusi:**

Në proces.

## **Masa**

### **3.2.5.3 Përcaktimi në të gjitha zyrat e shërbimit përmbartimor gjyqësor të punonjësve të dedikuar dhe të specializuar për të drejtat e fëmijës**

#### **Progresi:**

Në bazë të nevojave të shërbimit të përmbartimit gjyqësor shtetëror është mundësuar vlerësimi i nevojave për shtim të strukturës sipas ngarkesës që kanë zyrat vendore përmbartimore. Në bazë të këtyre nevojave të identifikuar, Ministri i Drejtësisë me urdhrin nr. 447, datë 10.07.2023 "Për përcaktimin e numrit të përgjithshëm të përmbartuesve gjyqësorë të shërbimit përmbartimor gjyqësor shtetëror", ka përcaktuar si numër të përgjithshëm 144 (njëqind e dyzet e katër) përmbartues gjyqësor shtetëror. Gjithashtu, në zbatim të urdhrin të Ministrit të Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit ka planifikuar në projekt buxhetin për vitin 2026 përfshirjen e kërkesës për shtim progresiv të stafit të profesionistëve, përmbartuesve gjyqësorë, miratimi dhe zbatimi i këtyre kërkesave mbetet për tu realizuar në vijim. Sjellim në vëmendje se edhe në Marrëveshjen me Urdhrin e Psikologut është parashikuar zhvillimi i trajnimeve të përmbartuesve lidhur me të drejtat e fëmijëve.

Në zbatim të marrëveshjes me Shkollën e Magjistraturës për vitin 2026 janë duke u ndjekur trajnimet me temë:

1. "Kujdestaria alternative me bazë familjen dhe ndarja e eksperiencave dhe vendimeve gjyqësore për zbatimin e interesit më të lartë të fëmijës. Të drejtat e fëmijëve".
2. Problematika të hasura në praktikën gjyqësore për zbatimin e Konventës së Hagës Për Aspektet Civile të Rrëmbimit Ndërkombëtar të Fëmijës, 1980, ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me Ligjin nr. 9446/2005. Shtyllat kryesore dhe funksionet e Konventës, mjetet në dispozicion dhe kuptimi i instituteve, fusha e zbatimit. Kuptimi i parimit të interesit më të lartë të fëmijës në rastet e rrëmbimit civil ndërkombëtar. Marrëdhëniet ndërmjet Konventës së Hagës dhe Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së.
3. Drejtësia miqësore për të miturit. Teknikat e intervistimit të të miturve.

Në planin e Zhvillimit të Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor për vitin 2026 janë parashikuar trajnime për rritjen e kapaciteteve të punonjësve të shërbimit përmbartimor gjyqësor në funksion të ekzekutimit të titujve ekzekutivë që trajtojnë çështje të fëmijëve dhe me shkresën nr. 342/1 Prot., datë 12.11.2025 DPP i është drejtuar ASPA me "Kërkesë për mbështetje në realizimin e trajnimeve" në kuadër të rritjes së performancës së shërbimit, në zbatim të Ligjit 8/2023 si dhe Urdhrin 333 datë 18.06.2024 të Ministrit të Drejtësisë "Për miratimin e programit të formimit vazhdues të përmbartuesit gjyqësor", sipas moduleve të miratuara, bashkëngjitur këtij urdhri, për vitin 2026.

#### **% e realizimit të objektivit specifik për janar-dhjetor 2025:**

60%

#### **Problematikat:**

Mungesë fondesh në buxhetin e shërbimit të përmbartimit gjyqësor shtetëror.

#### **Hapat që do të vijnë:**

Propozim për shtim strukture, miratimi dhe zbatimi i saj.

**Statusi:**

Në proces.

**Masa**

**3.3.1 Plotësimi me burimet e nevojshme njerëzore (avokatë, psikologë asistues, punonjës socialë të specializuar, mjekë e infermierë ligjorë, përmbaues gjyqësor etj) dhe të trajnuar për të ofruar shërbime të drejtësisë miqësore për fëmijët tek institucionet që punojnë me dhe për fëmijën**

**Progresi:**

Në zbatim të dispozitave ligjore si dhe në ushtrimin e kompetencave të saj, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbaimit, ka marrë masat dhe ka iniciuar procedurën për plotësim të 4 (katër) vendeve vakante për përmbaues gjyqësorë shtetëror, sipas organikës aktuale të shërbimit, dhe është mundësuar plotësimi i 1 (një) vendi vakant si dhe është në procedurë plotësimi i 3 (tre) vendeve vakante tashmë të shpallura.

Gjithashtu, në kuadër të forcimit dhe konsolidimit të shërbimit përmbaimit gjyqësor shtetëror është kërkuar shtim i organikës së këtij shërbimi duke propozuar dhe kërkuar konkretisht shtim të burimeve njerëzore, përmbaues gjyqësor.

**% e realizimit të objektivit specifik për janar-dhjetor 2025:**

96%

**Problematikat:**

Mosmiratimi i kërkesës së planifikuar në projektbuxhetin e shërbimit për vitin 2026 me staf të shtuar.

**Hapat që do të vijnë:**

Ndjekja në vijimësi e procesit të rekrutimit të përmbauesve sipas organikës aktuale. Përsëritje e kërkesave për shtim të burimeve njerëzore. Miratimi i kërkesave në buxhetin e shërbimit, në organikë. Ndjekja e procedurave të rekrutimit dhe plotësimi me staf profesional.

**Statusi:**

Në proces.

**Masa**

**3.3.1.1 Vlerësimi i nevojave për burimet njerëzore të nevojshme dhe rishikimi i organigramës së çdo institucioni që punon me dhe për fëmijët**

**Progresi:**

Drejtoria e Përgjithshme e Përmbaimit ka mundësuar identifikimin dhe vlerësimin e nevojave për shtim të burimeve njerëzore dhe është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë me propozim për shtim të organikës së Shërbimit të Përmbaimit Gjyqësor Shtetëror.

Bazuar në këtë propozim, Ministri i Drejtësisë ka miratuar numrin e përgjithshëm të përmbauesve gjyqësorë shtetërorë me urdhrin nr. 447, datë 10.07.2023 "Për përcaktimin e numrit të përgjithshëm të përmbauesve gjyqësorë të shërbimit përmbaimit gjyqësor shtetëror".

Gjithashtu, në kuadër të forcimit dhe konsolidimit të shërbimit përmbartimor gjyqësor shtetëror është kërkuar shtim i organikës së këtij shërbimi duke propozuar dhe kërkuar konkretisht shtim të burimeve njerëzore, përmbartues gjyqësor. Miratimi i kërkesave në buxhetin e shërbimit përmbartimor gjyqësor shtetëror dhe miratimi i organikës së shërbimit sipas urdhrit të Ministrit të Drejtësisë është objektiv prioritar për t'u ndjekur në vijimësi.

**% e realizimit të objektivit specifik për janar-dhjetor 2025:**

100%

**Problematikat:**

Mosmiratimi i kërkesave në buxhetin e shërbimit. Mosmiratimi i organikës së shërbimit të përmbartimit gjyqësor shtetëror me staf të shtuar.

**Hapat që do të vijnë:**

Propozim për shtim të strukturës së shërbimit të përmbartimit gjyqësor shtetëror. Miratimi i strukturës. Plotësimi me staf profesional sipas organikës së miratuar. Hartimi i kërkesave në projekt buxhet për vitin në vijim.

**Statusi:**

Në proces.

**Masa**

**3.3.1.2 Rishikimi i buxhetit të çdo institucioni në përputhje me nevojat e ofrimit të shërbimeve mbështetëse miqësore për fëmijët në kontakt/konflikt me ligjin**

**Progresi:**

Propozimi për shtim të organikës strukturore të shërbimit të përmbartimit gjyqësor shtetëror sigurisht është shoqëruar edhe me një vlerësim dhe efekt financiar që do të ketë në buxhetin e shërbimit përmbartimor gjyqësor shtetëror. Me miratimin e kërkesave për shtesë në organikë si dhe të kërkesave për sistemim, blerje, rikonstrukcion dhe përshtatje ambientesh do të rishikohet buxheti i shërbimit.

**% e realizimit të objektivit specifik për janar-dhjetor 2025:**

100%

**Problematikat:**

Mosmiratimi i kërkesave për shtesë fondesh për shtim strukture, për blerje, rikonstrukcion apo përshtatje ambientesh për zyrat vendore përmbartimore, në buxhetin e Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor Shtetëror.

**Hapat që do të vijnë:**

Kërkesë për shtesë fondesh në projekt- buxhet për strukturë të shtuar, dhe me infrastrukturë të kompletuar.

**Statusi:**

Në proces.

## STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE PËR MBROJTJEN E VIKTIMAVE TË KRIMIT 2024 - 2030

Në kuadër të hartimit të raportit të Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024 - 2030 për periudhën Janar – Dhjetor 2025, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit ka raportuar si më poshtë:

### 2.4.1 Vlerësimi dhe përditësimi i programeve të formimit fillestar dhe vazhdues nga çdo institucion që punon me dhe për viktimat.

#### Progresi:

Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit ka kontribuar në zbatimin e kësaj mase përmes përfshirjes aktive në proceset e vlerësimit dhe përmirësimit të programeve të formimit profesional, me qëllim rritjen e kapaciteteve të përmbartuesve gjyqësorë që ekzekutojnë dosjet përmbartimore me objekt – urdhër mbrojtje. Gjithashtu DPP ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me Shkollën e Magjistraturës, për organizimin dhe zhvillimin e trajnimeve të përmbartuesve gjyqësorë shtetërorë. Si rezultat programet e formimit janë përmirësuar dhe përditësuar, duke reflektuar nevojat praktike të punës së përditshme dhe duke forcuar rolin e përmbartuesve gjyqësorë shtetërorë gjatë ekzekutimit të urdhrave të mbrojtjes.

Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit ka mbledhur nevojat e përmbartuesve gjyqësorë për trajnimet që do të zhvillohen nga ASPA. Në datë 12.11.2025 DPP i është drejtuar ASPA me “Kërkesë për mbështetje në realizimin e trajnimeve”, në kuadër të rritjes së performancës së shërbimit, në zbatim të Ligjit 8/2023 si dhe Urdhrit nr. 333 datë 18.06.2024 të Ministrit të Drejtësisë "Për miratimin e programit të formimit vazhdues të përmbartuesit gjyqësor", sipas moduleve të miratuara.

Për periudhën Janar-Dhjetor 2025 rezultojnë të regjistruara për ekzekutim 914 çështje në total me objekt “Urdhër Mbrojtje”, nga të cilat janë ekzekutuar tërësisht 226 çështje, 447 çështje janë në ekzekutim të vazhdueshëm brenda afateve procedurale, 206 çështje të pushuara, 27 çështje të pezulluara dhe 7 çështje të transferuara.

Për periudhën Janar-Dhjetor 2025 rezultojnë të regjistruara për ekzekutim 1189 çështje në total me objekt “Urdhër i Menjëhershëm Mbrojtje”, nga të cilat janë ekzekutuar tërësisht 282 çështje, 439 çështje janë pushuar, 415 çështje janë në ekzekutim të vazhdueshëm brenda afateve procedurale, 39 çështje të pezulluara dhe 19 çështje të transferuara.

#### Problematika:

Mungesë fondesh në buxhetin e Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor Shtetëror.

#### Hapat që do të vijnë:

Ndjekja në vijimësi e zbatimit të marrëveshjes së bashkëpunimit me Shkollën e Magjistraturës dhe përfshirja e temave të evidentuara sipas programit të trajnimit, përfshirë edhe nevojat për trajnim lidhur me çështjet përmbartimore me objekt - urdhër mbrojtje, për përmbartuesit gjyqësor shtetëror, në kalendarin e trajnimeve

të Shkollës së Magjistraturës për vitin kalendarik 2025 -2026 dhe ndjekja e trajnimeve sipas kalendarit të miratuar.

#### **% e realizimit të aktivitetit:**

100%

#### **2.4.1.1 Evidentimi i programeve të formimit fillestar dhe vazhdues që adresojnë çështjet e viktimave të krimit.**

##### **Progresi:**

Gjatë periudhës raportuese është kryer evidentimi i programeve të formimit fillestar dhe vazhdues që trajtojnë dosjet përmbartimore me objekt - urdhrat e mbrojtjes. Janë identifikuar module trajnimi që lidhen me kuadrin ligjor, procedurat përmbartimore.

Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit për vitin 2025 ka vlerësuar dhe përditësuar programet për formimin fillestar dhe vazhdues të përmbartuesve gjyqësorë shtetërorë dhe në bazë të nevojave të përcjella nga këta të fundit në funksion të përmbushjes së detyrave funksionale si dhe në zbatim të Urdhrit nr.333 datë 18.06.2024 “Për miratimin e Programit të Formimit Vazhdues për përmbartuesit gjyqësorë shtetërorë” ka lidhur Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Shkollën e Magjistraturës nr. 801 Prot. datë 10.06.2025. Janë duke u zhvilluar trajnimet për përmbartuesit gjyqësor sipas kalendarit të miratuar. Ky trajnim do të vijoj 6 - mujorin e parë të vitit 2026.

Gjithashtu, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit me urdher nr.162 datë 04.12.2025 ka miratuar programin e trajnimit të detyrueshëm në periudhë prove, së bashku me modulën me temat e trajnimit për 2 përmbartues gjyqësorë në periudhë prove, bazuar në Urdhrin nr.433 datë 30.06.2023 “Për përcaktimin e rregullave për organizimin dhe përmbajtjen e programit të trajnimit, pjesëmarrjen në trajnime si dhe testimin e njohurive të përfutura për përmbartuesit gjyqësor shtetëror në periudhë prove”. Ky trajnim do të vijoj 3 - mujorin e parë të vitit 2026. Në zbatim të ligjit të ri organik dhe me qëllim garantimin e zhvillimit profesional të përmbartuesve gjyqësorë shtetërorë, është miratuar programi i formimit vazhdues, me objektiva të qarta, module trajnimi, strukturë organizimi dhe kohëzgjatje të përcaktuar, si dhe rregulla për ndjekjen dhe vlerësimin e aftësive. Ky program është miratuar me Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. 333, datë 18.06.2024, “Për miratimin e programit të formimit vazhdues për përmbartuesit gjyqësorë shtetërorë”.

Gjithashtu, për garantimin e trajnimit të përmbartuesve gjyqësorë shtetërorë në periudhë prove, janë miratuar rregullat për organizimin dhe përmbajtjen e programit për këtë kategori, përfshirë pjesëmarrjen në trajnim, testimin e njohurive të fituara dhe përmbajtjen e modulit tematik. Këto janë miratuar me Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. 433, datë 30.06.2023.

Në funksion të zbatimit të këtyre akteve, gjatë kësaj periudhe është realizuar trajnimi i detyrueshëm i 9 (nëntë) përmbartuesve gjyqësorë në periudhë prove, sipas Urdhrit nr. 53, datë 14.05.2025, me një kohëzgjatje prej 200 orësh, bazuar në një program të detajuar tematik dhe kalendar aktivitetesh.

Për forcimin e bashkëpunimit institucional dhe për rritjen e cilësisë së trajnimeve, janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Shkollën e Magjistraturës, për përfshirjen e përmbartuesve gjyqësorë shtetërorë

dhe inspektorëve në programin e formimit vazhdues, si dhe për organizimin e konferencave, leksioneve të hapura dhe aktiviteteve të përbashkëta. Trajnimet do të zhvillohen në klasë të përbashkët me gjyqtarë dhe prokurorë, të cilët gjithashtu janë subjekte që trajtojnë çështje që lidhen me viktimat.

#### **Problematika:**

Mungesë fondesh në buxhetin e Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor Shtetëror.

#### **Hapat që do të vijnë:**

DPP ka dërguar formularin për plotësim të gjithë nëpunësve të Shërbimit Përmbartimor Shtetëror dhe ka reflektuar temat e përzgjedhura prej tyre, shoqëruar me numrin e kërkesave për çdo temë trajnimi. Gjithashtu me shkresën nr. 342/1 Prot., datë 12.11.2025, DPP i është drejtuar ASPA me "Kërkesë për mbështetje në realizimin e trajnimeve" në kuadër të rritjes së performancës së shërbimit, në zbatim të Ligjit nr. 8/2023 si dhe Urdhrit nr. 333 datë 18.06.2024 të Ministrit të Drejtësisë "Për miratimin e programit të formimit vazhdues të përmbartuesit gjyqësor", sipas moduleve të miratuara, për vitin 2026.

#### **% e realizimit të aktivitetit**

100%

#### **2.4.1.2 Rishikimi i programit fillestar dhe vazhdues nga çdo institucion që punon me/për viktimat e krimit me qëllim përditësimin e programeve sipas problemeve të evidentuara.**

#### **Progresi:**

Gjatë periudhës raportuese është ndërmarrë rishikimi i programeve të formimit fillestar dhe vazhdues me fokus identifikimin e mangësive dhe nevojave për përditësim në përmbajtjen e tyre, në përputhje me problematikat e evidentuara. Procesi ka synuar përafrimin e programeve të trajnimit me ndryshimet ligjore, nevoja praktike e përmbartuesve gjyqësorë që ekzekutojnë vendime gjyqësore me objekt - urdhër mbrojtje.

Bazuar në kërkesat e përcjella nga përmbartuesit gjyqësorë, ndryshimet ligjore etj, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit i është drejtuar me shkresën nr. 342 prot., datë 28.02.2025 Shkollës Shqiptare të Administratës Publike me qëllim zhvillimin e trajnimeve të përmbartuesve gjyqësorë, ku në fokus të kërkesave kanë qënë dhe trajnimet për viktimat e dhunës.

Në kalendarin e miratuar dhe të dakordësuar me Shkollën e Magjistraturës në bazë të marrëveshjes së lidhur, janë miratuar temat për trajnim si vijon:

1. Akses i grave në drejtësi, të drejtat e grave, barazia gjinore, shmangia e stereotipizimit gjinor dhe përdorimi i metodave të marrjes në pyetje me ndjeshmëri gjinore. Legjislacioni vendas dhe standardet ndërkombëtare në fushën e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje. Detyrimet që burojnë nga Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) dhe Rekomandimet e Komitetit Grevio dhe CEDA për sistemin e drejtësisë. Zbatimi i dispozitave të Konventës së Stambollit dhe interpretimi i dispozitave ligjore kombëtare nën frymën e saj dhe fushave

specifike të saj. Roli i psikologut dhe punonjësit social në kuadrin e aksesit qytetar në organet e drejtësisë, si dhe për mbrojtjen e interesit më të lartë të të miturve.

2.Format e dhunës me bazë gjinore. Parashikimet ndërkombëtare dhe praktika e GJEDNJ-së. Masat ndaj dhunës me bazë gjinore. Zbatimi i masës mbi largimin menjëherë të dhunuesit nga banesa (Ligji 125/2020), për mbrojtjen e duhur të të mbijetuarave të dhunës me bazë gjinore, dhunës në familje e praktikave të dëmshme.

3. Zbatimi i ndalimit me ligj të krimeve të urrejtjes dhe gjuhës së urrejtjes me fokus LGBTIQ+. Efikasiteti i ndjekjes penale në rastet e dhunës me bazë gjinore. Efektiviteti i zbatimit të urdhrave të mbrojtjes dhe procedimet në rast të shkeljes së tyre.

4.Dhuna në familje sipas nenit 130/a të Kodit Penal. Ndryshimet e dispozitës dhe raporti me ligjin për dhunën në familje. Interpretimi i termave “gjini e afërt” dhe “krushqi e afërt”. Praktikave ndryshme gjyqësore lidhur me rrethin e pjesëtarëve të familjes që janë subjekt i veprës penale të dhunës në familje. Interpretimi i rrethanës cilësuese “më shumë se njëherë” dhe “në praninë e fëmijëve” sipas paragrafit të katërt të nenit 130/a të Kodit Penal. Parashikimet ndërkombëtare dhe praktika gjyqësore.

5.Dhuna me bazë gjinore ndaj grave. Efikasiteti i ndjekjes penale në rastet e dhunës me bazë gjinore. Efektiviteti i zbatimit të urdhrave të mbrojtjes dhe procedimet në rast të shkeljes së tyre. Problematikat në praktikën gjyqësore lidhur me deklarin e viktimave të dhunës se nuk kërkojnë ndjekje penale përveç pajisjes me urdhër mbrojtje dhe qëndrimi i organit procedues. Detyrimi i gjykatës për referimin e rasteve në organin procedues. Mbrojtja e viktimës së dhunës me bazë gjinore. Efekti i procedimeve penale lidhur me dhunën në familje mbi vendimmarrjet e gjykatës për zgjidhjen e martesës dhe ushtrimin e përgjegjësisë prindërore pas zgjidhjes së martesës.

Gjithashtu në modulën e trajnimeve për përmbartuesit gjyqësor në kapitullin “Kuatrë ligjor i zbatueshëm në Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor” është parashikuar trajnim në lidhje me dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore.

### **Problematika:**

Mungesë e një mekanizimi të strukturuar për vlerësimin periodik të efektivitetit të trajnimeve dhe reflektimin sistematik të problematikave të konstatuara.

### **Hapat që do të vijnë:**

Në vijim do të përgatiten dhe përditësohen modulet e formimit fillestar në bazë të gjetjeve të rishikimit. Do të forcohet bashkëpunimi me Shkollën e Magjistraturës.

### **% e realizimit të aktivitetit**

100%

## 6. ORGANIZIMI I BRENDSHËM I SHPGJSH

### 6.1 Drejtimi administrativ i Zyrave Vendore Përmbaremore

Aktualisht pranë Shërbimit Përmbaremore Gjyqësor Shtetëror e *ushtrojnë detyrën 8 përmbaremes gjyqësor të emëruar në cilësinë e Kryetarit të Zyrës Përmbaremore* si më poshtë:

- 1) **Z. Granit Guxho kryetar i emëruar** nga Ministri i Drejtësisë me Urdhrin nr.478 datë 24.07.2023 në Zyrën Përmbaremore Elbasan.
- 2) **Znj.Olta Shkëmbi kryetar i emëruar** nga Ministri i Drejtësisë me Urdhrin nr.178/1 datë 14.04.2024 në Zyrën Përmbaremore Korçë.
- 3) **Znj.Satbere Shahu kryetar i emëruar** nga Ministri i Drejtësisë me Urdhrin nr. 130 datë 09.03.2021 në Zyrën Përmbaremore Kukës.
- 4) **Z.Dritan Nika kryetar i emëruar** nga Ministri i Drejtësisë me Urdhrin nr. 645/1 datë 09.12.2014 në Zyrën Përmbaremore Mat.
- 5) **Znj.Athinela Lybesha kryetar i emëruar** nga Ministri i Drejtësisë me Urdhrin nr. 555/1 datë 14.11.2014 në Zyrën Përmbaremore Pogradec.
- 6) **Z.Asaf Stroka kryetar i emëruar** nga Ministri i Drejtësisë me Urdhrin nr. 1126/1 datë 13.02.2015 në Zyrën Përmbaremore Sarandë.
- 7) **Z.Eduart Mrishaj kryetar i emëruar** nga Ministri i Drejtësisë me Urdhrin nr. 4285/ datë 21.05.2012 në Zyrën Përmbaremore Tropojë.
- 8) **Z.Fitim Koçiaj kryetar i emëruar** nga Ministri i Drejtësisë me Urdhrin nr.190/1 datë 16.01.2015 në Zyrën Përmbaremore Vlorë.

Gjithashtu *ushtrojnë detyrën 13 përmbaremes gjyqësor të komanduar sipas përcaktimeve të ligjit 8730 datë 18.01.2001, të shfuqizuar, si dhe të caktuar sipas përcaktimeve të ligjit 8/2023 “Për Organizimin dhe Funksionimin” në cilësinë e Kryetarit të Zyrës Përmbaremore:*

1. **Z. Pjetër Caka kryetar i komanduar** nga Drejtori i Përgjithshëm me Urdhrin nr. 650 datë 11.03.2019 në Zyrën Përmbaremore Tiranë.
2. **Z. Ilir Çipi kryetar i komanduar** nga Drejtori i Përgjithshëm me Urdhrin nr. 1042 datë 23.05.2017 në Zyrën Përmbaremore Berat.
3. **Znj. Anisa Losha kryetar i komanduar** nga Drejtori i Përgjithshëm me Urdhrin nr.66 datë 21.10.2022 në Zyrën Përmbaremore Dibër.
4. **Z. Julian Hoxhaj kryetar i komanduar** nga Drejtori i Përgjithshëm me Urdhrin nr. 715 datë 15.03.2019 në Zyrën Përmbaremore Fier.
5. **Znj.Arlinda Kovaçi kryetar i caktuar** nga Drejtori i Përgjithshëm me Urdhrin nr. 117 datë 30.09.2025 në Zyrën Përmbaremore Gjirokastrë.
6. **Z.Gerd Llanaj kryetar i caktuar** nga Drejtori i Përgjithshëm me Urdhrin nr. 06 datë 08.01.2025 në Zyrën Përmbaremore Kavajë.
7. **Znj. Erisa Mirashaj kryetar i caktuar** nga Drejtori i Përgjithshëm me Urdhrin nr.136 datë 25.12.2024 në Zyrën Përmbaremore Krujë.
8. **Znj. Rovenë Prenga kryetar i caktuar** nga Drejtori i Përgjithshëm me Urdhër nr.95 datë 09.09.2025 në Zyrën Përmbaremore Kurbin.
9. **Znj. Stela Gjergji kryetar i caktuar** nga Drejtori i Përgjithshëm me Urdhrin nr.59 datë 10.05.2024 në Zyrën Përmbaremore Lezhë.

- 10. Znj. Brikena Luto kryetar i caktuar** nga Drejtori i Përgjithshëm me Urdhrin nr.93 datë 13.12.2022 në Zyrën Përmbartimore Lushnjë.
- 11. Z. Tedi Xhani kryetar i caktuar** nga Drejtori i Përgjithshëm me Urdhrin nr.52 datë 03.10.2022 në Zyrën Përmbartimore Përmet
- 12. Z. Zef Kolombi kryetar i caktuar** nga Drejtori i Përgjithshëm me Urdhrin nr.49 datë 03.10.2022 në Zyrën Përmbartimore Pukë.
- 13. Z. Tauland Muja kryetar i caktuar** nga Drejtori i Përgjithshëm me Urdhrin nr.30 datë 29.08.2022 në Zyrën Përmbartimore Shkodër.

## **6.2 Transferime të përkohshme**

Në kuadër të garantimit të ekzekutimit të titujve ekzekutivë dhe përmbushjen objektivave të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit, në zyrat të cilat janë karakterizuar nga një ngarkesë e lartë çështjesh përmbartimore, evidencave të punës për përmbartues gjyqësor dhe problematikës së krijuar për shkak të vakancave, është mundësuar transferimi i përkohshëm i një përmbartuesi gjyqësorë për nevoja pune.

Kështu në vlerësim të situatës, është mundësuar:

- transferimi i përkohshëm i 1 përmbartuesi gjyqësor nga Zyra Përmbartimore Fier në Zyrën Përmbartimore Tiranë.

## **6.3 Transferime të përhershme**

Për vitin 2025 nuk rezulton të jetë kryer asnjë transferim i përhershëm i përmbartuesve gjyqësorë shtetërorë.

## **6.4 Komandime si inspektor në Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbartimit**

Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit ka ndjekur të gjitha procedurat për shpalljen e 1 (një) vendi vakant si inspektor i komanduar, në përfundim të së cilës është komanduar 1 përmbartues gjyqësor që ka emërimin në Zyrën Përmbartimore Fier, konform Urdhrit nr.6 datë 30.06.2023 "Për caktimin e rregullave të hollësishme për procedurën e komandimit të përmbartuesit gjyqësor".

## **6.5 Rekrutimi i Përmbartueseve Gjyqësor Shtetëror dhe punonjëseve me Kod Pune**

Gjatë Janar – Dhjetor 2025, janë marrë masat në përputhje me aktet ligjore dhe nëligjore në fuqi për plotësimin e organikës në çdo zyrë vendore përmbartimore, duke kryer lëvizjet e nevojshme brenda shërbimit për të garantuar shërbim për shtetasit, duke plotësuar vendet vakante të personelit administrativ në nivel qendror dhe vendor apo duke ndjekur procedurat përkatëse për shpalljen e vendeve vakante për përmbartues gjyqësor.

Kështu është mundësuar shpallja e 4 vendeve vakante për përmbartues gjyqësor, konkretisht 1 (një) vend vakand në Zyrën Përmbartimore Tiranë, 1 (një) vend vakand në Zyrën Përmbartimore Durrës, 1 (një) vend vakand në Zyrën Përmbartimore Kukës, 1 (një) vend vakand në Zyrën Përmbartimore Lushnjë.

Ndjekja e procedurave përkatëse ligjore dhe plotësimi i 3 (tre) vendeve vakante. Kështu, është mundësuar plotësimi i vendit vakand për përmbartues gjyqësor në Zyrën Përmbartimore Tiranë, Durrës dhe Kukës.

Në zbatim të ligjit nr. 08, datë 02.02.2023 « *Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror* », VKM-së nr. 326, datë 31.05.2023 « *Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike* », shkronja (ç), pika 2, pika 9 dhe pika 10, shkronja (a), në Strukturën Organike të Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror, të miratuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 222, datë 14.12.2023, ku evidentohet ndryshim në emërtimin e disa prej pozicioneve mbështetëse, si dhe në zbatim të VKM-së nr. 39, datë 24.01.2024 « *Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2024 në njësitë e qeverisjes qendrore* », ku për Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror, për vitin 2025, ka patur të miratuar 3 (tre) punonjës me kontratë të përkohshme dhe kohëzgjatje 6/orë në ditë.

Janë emëruar në përputhje me ligjin organik dhe dispozitat e Kodit të Punës në Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror 3 (tre) nëpunës, konkretisht:

- 1 (një) Specialist Financë/Buxheti/Arkivë/Protokolli në Zyrën Përmbartimore Durrës;
- 1 (një) Shofer, Sektori i Shërbimeve Mbështetëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbartimit;
- 1 (një) Mirëmbajtës, punonjës me kontratë në Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbartimit.

Janë larguar nga detyra 7 (shtatë) nëpunës të administratës së shërbimit përmbartimor gjyqësor shtetëror, si më poshtë:

- 1 (një) Specialist Financë/Buxheti/Arkivë/Protokolli në Zyrën Përmbartimore Durrës;
- 2 (dy) Inspektorë/Drejtoria e Inspektimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbartimit ;
- 1 (një) Mirëmbajtës, punonjës me kontratë në Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbartimit.
- 1 (një) Përmbartues gjyqësor në Zyrën Përmbartimore Gjirokastrë;
- 1 (një) Përmbartues gjyqësor në Zyrën Përmbartimore Tiranë;
- 1 (një) Përmbartues gjyqësor në Zyrën Përmbartimore Kurbin.

Në dhjetor të vitit 2025 rezultojnë vende vakante si më poshtë:


- 1 (një) përmbartues gjyqësor në Zyrën Përmbartimore Lushnje;
- 1 (një) përmbartues gjyqësor në Zyrën Përmbartimore Gjirokastrë;
- 1 (një) përmbartues gjyqësor në Zyrën Përmbartimore Kurbin;
- 2 (dy) inspektor në Drejtorinë e Inspektimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbartimit.

## **METODOLOGJIA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE PËR PUNONJËS PRANË SHPGJSH**


Gjatë vitit 2025 në kuadër të detyrave funksionale për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe rekrutimin e punonjësve të rinj në shërbim, me Urdhër nr. 128 datë 14.10.2025 është miratuar “Metodologjia e vlerësimit të kandidatëve për punonjës pranë Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor”, me qëllim sigurimin e një procesi të drejtë, transparent dhe objektiv në përzgjedhjen e kandidatëve për ushtrimin e detyrave publike. Kjo metodologji është ndjekur për plotësimin e vakancave në pozicionin e inspektorit në Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbartimit dhe pozicionin e specialistit të arkivë/protokoll/financë/buxhet në Zyrën Përmbartimore Durrës.

## 6.6 Veprimtari në kuadër të rritjes së kapaciteteve të stafit.

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit janë zhvilluar trajnimet në përmbushje të detyrimeve funksionale të përcaktuara në Urdhër nr. 433, datë 30.06.2023 “Për përcaktimin e rregullave për organizimin dhe përmbajtjen e programit të trajnimit, pjesëmarrjen në trajnime, si dhe testimin e njohurive të përfituara për përmbaruesit gjyqësor shtetëror në periudhë prove”, për përmbaruesit gjyqësor në periudhë prove në Zyrat Përmbarimore Tiranë, Dibër, Krujë, Shkodër, Lezhë, Elbasan dhe Durrës.



Gjatë zhvillimit të trajnimit fillestar të përmbaruesve gjyqësorë në periudhë prove



Gjatë zhvillimit të trajnimit fillestar të përmbaruesve gjyqësorë në periudhë prove

Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit në funksion të përmbushjes së detyrave funksionale si dhe në zbatim të Urdhrit nr. 333 datë 18.06.2024 “Për miratimin e Programit të Formimit Vazhdues për përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë” ka lidhur Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Shkollën e Magjistraturës nr. 801 Prot., datë 10.06.2025 dhe janë duke zhvilluar trajnimet për përmbaruesit gjyqësor sipas kalendarit të miratuar. Modulet e trajnimit janë ndjekur nga përmbaruesit gjyqësor në vitin 2025 si dhe do të vijojnë edhe 6 - mujorin e parë të vitit 2026 sipas kalendarit të miratuar nga Shkolla e Magjistraturës.

Gjithashtu, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit me urdhër nr.162 datë 04.12.2025 ka miratuar programin e trajnimit të detyrueshëm në periudhë prove, së bashku me modulën me temat e trajnimit për 2 përmbarues gjyqësor në periudhë prove në Zyrën Përmbarimore Tiranë dhe Kukës, bazuar në Urdhrin nr.433 datë 30.06.2023 “Për përcaktimin e rregullave për Organizimin dhe përmbajtjen e programit të trajnimit, pjesëmarrjen në trajnime si dhe testimin e njohurive të përfituara për përmbaruesit gjyqësor shtetëror në periudhë prove”. Ky trajnim ka filluar në muajin Dhjetor të vitit 2025 dhe do të vijojë 3 - mujorin e parë të vitit 2026.

Me shkresën nr. 342 Prot., datë 24.02.2025 Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit i është drejtuar ASPA me “Kërkesë për mbështetje në realizimin e trajnimeve” në kuadër të rritjes së performancës së shërbimit, në zbatim të Ligjit nr. 8/2023 si dhe Urdhrit nr. 333, datë 18.06.2024 të Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e programit të formimit vazhdues të përmbaruesit gjyqësor”, sipas moduleve të miratuara. Nga ASPA nuk është përcjellë përgjigje pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit, dhe për këtë arsye gjatë vitit 2025 nuk ka pasur trajnime për stafin administrativ dhe përmbaruesit gjyqësor nga kjo e fundit.

Në vijim të ushtrimit të detyrave funksionale Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit ka mbledhur informacion nga zyrat përmbartimore vendore mbi temat e trajnimit që duan të trajnohen në vitin 2026, informacion të cilin e ka përcjellë pranë Ministrisë së Drejtësisë elektronikisht, sipas kërkesës së kësaj të fundit. Me shkresën nr. 342/1 Prot., datë 12.11.2025 Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit i është drejtuar ASPA me “Kërkesë për mbështetje në realizimin e trajnimeve” për vitin 2026, në kuader të rritjes së performancës së shërbimit, në zbatim të Ligjit nr. 8/2023 si dhe Urdhrit nr. 333, datë 18.06.2024 të Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e programit të formimit vazhdues të përmbartuesit gjyqësor”, sipas moduleve të miratuara.

#### **6.7 Përmbartuesit në periudhë prove.**

Gjati vitit 2025 është mundësuar plotësimi i vendit vakant për përmbartues gjyqësor në 3 (tre) zyra vendore, Zyrën Përmbartimore Tiranë, Durrës dhe Kukës, ku një përmbartues gjyqësor në periudhë prove ka plotësuar periudhën e provës dhe pasi ka kaluar provimin me shkrim ka marrë emërimin e përhershëm në Zyrën Përmbartimore Durrës. Aktualisht janë dy (dy) përmbartues gjyqësorë në periudhë prove:

- 1 (një) përmbartues gjyqësor në periudhë prove në Zyrën Përmbartimore Tiranë;
- 1 (një) përmbartues gjyqësor në periudhë prove në Zyrën Përmbartimore Kukës.

#### **6.8 Procesi i vlerësimit fillestar dhe i vazhdueshëm i përmbartuesve gjyqësorë, sipas parashikimeve në dispozitat e Ligjit nr. 8/2023.**

Në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në Ligjin nr.8/2023 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror” si dhe Urdhrit nr.167 datë 25.03.2024 të Ministrit të Drejtësisë “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Përmbartimit”, Vendimit nr. 72 datë 21.10.2025 i Këshillit të Përmbartimit për miratimin e “Formulari i vetvlerësimit për përmbartuesit gjyqësor shtetëror” dhe “Formulari i vetvlerësimit për kryetarët e zyrave përmbartimore”, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit ka propozuar miratimin e programit si dhe periudhën e vlerësimit të kryetarëve të zyrave përmbartimore dhe përmbartuesve gjyqësor për vitin 2026 sipas formularëve të miratuar në mbledhjen e datës 21.10.2025 të Këshillit të Përmbartimit.

Qëllimi i kryerjes së këtij procesi është rritja e efektivitetit, transparencës dhe integritetit në ushtrimin e detyrës së kryetarit të zyrës përmbartimore dhe përmbartuesit gjyqësor në funksion të përmirësimit të cilësisë së shërbimit publik të përmbartimit, ekzekutimi i vendimeve gjyqësore. Nëpërmjet procesit të vlerësimit synohet analiza e nevojave për zhvillim profesional dhe trajnime shtesë të subjekteve të vlerësimit.

## **7. TRANSPARENCA DHE MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN**

### **7.1 E drejta e informimit**

Bazuar në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, çdo individ gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik që disponon Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit në përputhje me parashikimet e legjislacionit për të drejtën e informimit.

Sipas detyrimeve të parashikuara në ligjin nr. 119/2014, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit krijon, mban dhe bën publik një regjistër të posaçëm të kërkesave dhe përgjigjeve, ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre. Ky regjistër përditësohet çdo muaj dhe publikohet në faqen e internetit të Drejtorisë. Identiteti i kërkuarve të informacionit nuk pasqyrohet në regjistër.

Kërkesa për informim bëhet me shkrim dhe dërgohet dorazi, me postë ose me postë elektronike, duke paraqitur saktë identitetin e kërkuarit dhe nënshkrimin e tij. Në çdo rast, kërkesa regjistrohet në regjistrin e posaçëm dhe trajtohet sipas dispozitave të legjislacionit për të drejtën e informimit.

### **7.2 Koordinatori për të Drejtën e Informimit**

Drejtorja e Përgjithshme e Përmbarimit gjatë vitit 2025 ka përmirësuar dhe përditësuar Programin e Transparencës të publikuar në faqen zyrtare të DPP. Gjithashtu, nga ana e DPP publikohen në faqen zyrtare Shpalljet për Vendet e Lira të punës, është i publikuar legjislacioni përkatës, Regjistri i Kërkesave dhe Ankesave. Nga ana e DPP-së nëpërmjet adresës elektronike të Koordinatorit Për të Drejtën e Informimit përcillen te Komisioneri për të Drejtën e Informimit, çdo muaj Regjistri i Kërkesave dhe Ankesave të hyra në DPP, pa cënuar privatësinë e palëve apo të procesit të ekzekutimit.

Gjithashtu, nga Koordinatori për të Drejtën e Informimit janë mbajtur dhe publikuar Regjistrat e Kërkesë/Ankesave të përcjella në Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbarimit, regjistra të cilat janë publikuar në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit.

Për vitin 2025, janë paraqitur elektronikisht 2(dy) kërkesa për informim publik pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit.

### **7.3 Komunkimi me masmedian**

Është mundësuar monitorimi i mediave për lajmet që kanë të bëjnë me përmbarimin dhe përditësimi i faqes zyrtare elektronike të institucionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit sa i përket njoftimeve për vende vakante, rezultateve të testimit etj.

Në bashkëpunim me strukturat e AKSH-it është krijuar faqe e re e Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit, me përditësimet e duhura. Në faqen zyrtare të DPP përveçse është publikuar Programi i Transparencës së Institucionit, gjendet informacion mbi adresën e zyrave përmbarimore, statistikat mujore, shpalljet publike,

vakancat për pozicionet e lira të punës, ankandet etj. Kjo faqe përditësohet në mënyrë të vazhdueshme nga personi i ngarkuar me kryerjen e këtyre detyrave.

Nëpërmjet faqes zyrtare në Facebook dhe Instagram të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit publikohen në mënyrë periodike analizat e të dhënave statistikore të shërbimit, Buletini mujor, rastet e suksesit në ekzekutimin e titujve ekzekutivë nga zyrat përmbartimore si dhe publikohen aktivitetet e zhvilluara nga Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit dhe nga zyrat përmbartimore rast pas rasti etj.

#### **7.4 Rrjetet sociale. FB/INSTA**

Gjatë vitit 2025 Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit ka rritur nivelin e transparencës dhe informimit publik përmes publikimeve në faqen zyrtare Facebook dhe Instagram.

Janë shpërndarë rregullisht njoftime për aktivitete institucionale, vendimet e rëndësishme, procedurat dhe ndryshimet ligjore që prekin shërbimin përmbartimor.

Janë publikuar analiza, raporte dhe të dhëna statistikore mbi aktivitetin e përmbartuesve, për të ofruar informacion të qartë dhe të verifikueshëm për qytetarët dhe institucionet partnere.

Faqet online kanë shërbyer gjithashtu për të evidentuar rastet e suksesit dhe praktikatat më të mira në ekzekutimin e detyrimeve përmbartimore, duke rritur besimin e publikut dhe promovuar transparencën në punën e përmbartuesve.

#### **7.5 Edukimi Ligjor si mënyrë komunikimi**

Duke e vlerësuar edukimin ligjor si mënyrë komunikimi Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit, përveç publikimit të informacionit për publikun në faqen zyrtare dhe në faqet Facebook dhe Instagram, ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me emisionin radiofonik “Ligj dhe Drejtësi”, me anë të së cilit u mundësohet dëgjuesve të marrin informacion profesional, të bëjnë pyetje për vendimet gjyqësore dhe mënyrën ekzekutimit të tyre.



Drejtori i Përgjithshëm i Përmbarimit z. Ergys Qirici gjatë nënshkrimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit me emisionin radiofonik "Ligj me Drejtësi".

## 8. ANALIZA FINANCIARE

Kjo analizë paraqet ecurinë financiare të Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror për periudhën Janar – Dhjetor 2025, duke reflektuar nivelin e realizimit të shpenzimeve buxhetore, performancën në mbledhjen e të ardhurave, si dhe arritjen e objektivave të përcaktuara në kuadër të planifikimit buxhetor dhe të performancës institucionale.

Analiza bazohet në të dhënat zyrtare të konfirmuara nga Dega e Thesarit Tiranë dhe degët përkatëse të thesarit në rrethe, për njësitë shpenzuese ku ushtrojnë veprimtarinë zyrat përmbarimore vendore. Gjatë vitit 2025, Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror ka operuar me 23 njësi shpenzuese, duke siguruar një nivel të lartë realizimi të buxhetit dhe rritje të ndjeshme të treguesve të performancës financiare dhe operative.

- Fondi i planifikuar për shpenzime personeli (600+601) është realizuar në masën 97%.
- Fondi i planifikuar për shpenzime operative (602+606) është realizuar në masën 90.4%.
- Shpenzimet buxhetore në total për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror për periudhën Janar – Dhjetor 2025 janë realizuar në masën 96.3%.


Gjatë vitit 2025, Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror ka funksionuar me 23 njësi shpenzuese.

## 8.1 Realizimi i shpenzimeve buxhetore

Realizimi i shpenzimeve buxhetore për periudhën Janar – Dhjetor 2025

| Përshkrimi                    | Plani       | Fakti       | Realizimi ne % |
|-------------------------------|-------------|-------------|----------------|
| Shpenzime Personeli(600+601)  | 257,426,000 | 249,837,193 | 97%            |
| Shpenzime operative (602+606) | 32,900,000  | 29,735,694  | 90.4%          |
| TOTALI                        | 290,326,000 | 279,572,887 | 96.3%          |

**Realizimi i shpenzimeve buxhetore Janar -Dhjetor 2025**




## 8.2. Të ardhurat buxhetore

Në periudhën Janar – Dhjetor 2025 janë derdhur në buxhetin e shtetit **120,841,555 lekë**. Krahasuar me periudhën Janar – Dhjetor 2024, të ardhurat janë rritur me **24,671,627 lekë**, pasi në vitin 2024 të ardhurat e derdhura në buxhet kanë qenë **96,169,928 lekë**.

**Krahasimi i të ardhura të derdhura në buxhetin e shtetit për periudhën Janar – Dhjetor 2024 & 2025**

| Periudha Kohore                                                     | Shuma e derdhur në buxhet |
|---------------------------------------------------------------------|---------------------------|
| Të ardhura të derdhura në buxhet për periudhën Janar – Dhjetor 2024 | 96,169,928                |
| Të ardhura të derdhura në buxhet për periudhën Janar – Dhjetor 2025 | 120,841,555               |




- Të ardhura të derdhura në buxhet për periudhën Janar – Dhjetor 2024
- Të ardhura të derdhura në buxhet për periudhën Janar – Dhjetor 2025


## 9. Statistikat e dosjeve të ekzekutuara nga çdo përmbarues dhe nga çdo zyrë vendore përmbarimore

### 9.1 Statistikat për çdo zyrë\Statistikat për çdo përmbarues.

Nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse është mundësuar mbledhja, verifikimi dhe përpunimi i të dhënave statistikore mujore dhe progresive të shërbimit përmbarimor mbi ekzekutimin e titujve ekzekutivë. Kështu veprimtaria dhe arritjet progresive të ekzekutimit të titujve ekzekutivë për vitin 2025 nga shërbimi përmbarimor gjyqësor shtetëror, sipas formatit të statistikës zyrtare rezultojnë, si më poshtë:



Shënim: Në tabelën e mësipërme nuk janë përfshirë të dhënat statistikore mbi çështjet përmbarimore me objekt (takim fëmije, kujdestari fëmije, pensione ushqimore, urdhër mbrojtje dhe urdhër i menjëhershëm mbrojtje).



# PASQYRA PËRMBLEDHËSE JANAR – DHJETOR 2025 PËR SHËRBBIMIN PËRMBARIMOR GJYQËSOR SHTETËROR

| Lloji<br><br>i titullit ekzekutiv<br><br>(Kind of Execution)                               |                                  |               | Çështje në total<br><br>(Total) | Çështje me afate procedurale të plotësuar (me shume se 6 muaj)<br><br>(Cases terminated outside the term) |                         |                   | Çështje brenda afateve procedurale(brenda afatit 6 muaj)<br><br>(Cases terminated ëithin procedural term) |                               |                           | (Refused) Të refuzuara | Pezulluar vendimi<br><br>(Suspend ed) | Të transferuara<br><br>(Transfer red) | Të pushuara me 616/c | Gjobat e përbarimit<br><br>(Fines) | Kallëzim ndjekje pen.<br><br>(denuncia tion) |
|--------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------|---------------|---------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------|-------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------|---------------------------|------------------------|---------------------------------------|---------------------------------------|----------------------|------------------------------------|----------------------------------------------|
|                                                                                            |                                  |               |                                 | (Pe Në ndi ekzeku ng) tim                                                                                 | (Ex Ekzek ecut utua ra) | (Ca Pushu se ara) | (pe Në ndi ekzeku ng) tim                                                                                 | Ekzek utuar<br>(Ex utuar ecut | (Ca Pushu se ar dro 616/d |                        |                                       |                                       |                      |                                    |                                              |
| Detyrime në të holla dhe ato kontraktuale (Obligations & contractual money)                | Shteti debitor (State debtor)    |               | 654                             | 338                                                                                                       | 19                      | 2                 | 241                                                                                                       | 27                            | 4                         | 5                      | 8                                     | 5                                     | 5                    | 1                                  |                                              |
|                                                                                            | Shteti kreditor (State creditor) | ATK           | 425                             | 128                                                                                                       | 1                       | 17                | 186                                                                                                       | 16                            | 13                        | 2                      | 19                                    | 21                                    | 22                   |                                    |                                              |
|                                                                                            |                                  | OSHEE         | 2                               | 1                                                                                                         | -                       | -                 | 1                                                                                                         | -                             | -                         | -                      | -                                     | -                                     | -                    |                                    |                                              |
|                                                                                            |                                  | Firma piramid | 595                             | 412                                                                                                       | 1                       | 1                 | 110                                                                                                       | -                             | 1                         | 68                     | 1                                     | -                                     | 1                    |                                    |                                              |
|                                                                                            |                                  | Të ndryshme   | 17,491                          | 3,063                                                                                                     | 303                     | 330               | 8,233                                                                                                     | 3,133                         | 1,239                     | 67                     | 300                                   | 324                                   | 499                  | 2                                  | 1                                            |
| Detyrimet në të holla dhe kontraktuale private (Private obligations dhe contractual money) |                                  |               | 3,461                           | 660                                                                                                       | 46                      | 46                | 2,108                                                                                                     | 265                           | 20                        | 21                     | 87                                    | 22                                    | 186                  |                                    |                                              |
| Gjobat penale (Fines)                                                                      |                                  |               | 31,350                          | 9,973                                                                                                     | 898                     | 61                | 14,468                                                                                                    | 4,187                         | 303                       | 65                     | 174                                   | 1,036                                 | 185                  |                                    |                                              |
| TOTALI                                                                                     |                                  |               | 53,978                          | 14,575                                                                                                    | 1,268                   | 457               | 25,347                                                                                                    | 7,628                         | 1,580                     | 228                    | 589                                   | 1,408                                 | 898                  | 3                                  | 1                                            |


Shënim: Në tabelën e mësipërme nuk janë përfshirë të dhënat statistikore mbi çështjet përmbareme me objekt (takim fëmije, kujdestari fëmije, pensione ushqimore, urdhër mbrojtje dhe urdhër i menjëhershëm mbrojtje).

## PASQYRA PËRMBLEDHËSE JANAR – DHJETOR 2025 PËR SHËRBBIMIN PËRMBARIMOR GJYQËSOR SHTETËROR

| <i>Rrethet</i> | <i>C.Total</i> | <i>Me afat te plotesuar</i> |              |              | <i>Brenda afatit</i> |              |              | <i>Refuz.</i> | <i>Pez.<br/>V.<br/>Gjyk.</i> | <i>Te<br/>transferuara</i> | <i>Push.</i> | <i>Gjob<br/>perm</i> | <i>Kall.pen.</i> |
|----------------|----------------|-----------------------------|--------------|--------------|----------------------|--------------|--------------|---------------|------------------------------|----------------------------|--------------|----------------------|------------------|
|                |                | <i>Ne<br/>ekz.</i>          | <i>Ekz.</i>  | <i>Push.</i> | <i>Ne ekz.</i>       | <i>Ekz.</i>  | <i>Push.</i> |               |                              |                            |              |                      |                  |
| Berat          | 1,760          | -                           | -            | -            | 1,425                | 221          | 109          | -             | -                            | 5                          | -            | -                    | -                |
| Diber          | 732            | 188                         | 100          | 1            | 194                  | 199          | 1            | 1             | -                            | 47                         | 1            | -                    | -                |
| Durres         | 10,600         | -                           | -            | -            | 8,365                | 1,237        | -            | 1             | 160                          | 245                        | 592          | -                    | -                |
| Elbasan        | 4,880          | -                           | -            | -            | 3,163                | 721          | 934          | -             | 2                            | 49                         | 11           | -                    | -                |
| Fier           | 1,966          | -                           | -            | -            | 1,304                | 524          | 15           | 2             | 5                            | 110                        | 6            | -                    | -                |
| Gjirokaster    | 1,236          | -                           | -            | -            | 1,145                | 78           | -            | -             | -                            | 6                          | 7            | -                    | -                |
| Kavaje         | 1,405          | -                           | -            | -            | 1,034                | 367          | -            | -             | -                            | 4                          | -            | -                    | -                |
| Korce          | 1,490          | 16                          | 1            | 2            | 521                  | 664          | 200          | 22            | 5                            | 55                         | 4            | 1                    | -                |
| Kruje          | 725            | -                           | -            | -            | 621                  | 93           | -            | -             | 2                            | 9                          | -            | -                    | -                |
| Kukes          | 579            | 171                         | 3            | -            | 133                  | 197          | -            | 1             | -                            | 11                         | 63           | -                    | -                |
| Kurbin         | 472            | -                           | -            | -            | 169                  | 212          | 8            | -             | 68                           | 15                         | -            | -                    | -                |
| Lezhe          | 751            | -                           | -            | -            | 425                  | 243          | 2            | 18            | 31                           | 32                         | -            | -                    | -                |
| Lushnje        | 762            | 233                         | 70           | 12           | 154                  | 201          | 4            | -             | -                            | 9                          | 79           | 1                    | -                |
| Mat            | 206            | 54                          | 21           | -            | 24                   | 65           | 2            | -             | 31                           | 5                          | 4            | -                    | -                |
Ky rast përfaqëson angazhimin e vazhdueshëm të Zyrës së Përmbarrimit Fier për zbatimin me korrektësi të vendimeve gjyqësore, pavarësisht vështirësive apo kohëzgjatjes së proceseve.

## Zyra e Përmbarrimit Tiranë garanton të drejtën për takim fëmije përmes ekzekutimit ligjor

Gjatë muajit Maj, realizuar me sukses një procedurë përmbarrimore me objekt "Takim fëmije", të regjistruar më 27 shkurt 2025. Pas përpjekjes për ekzekutim vullnetar dhe moszbatimit të vendimit nga pala debitore, u ndërmorën veprimet për ekzekutim të detyruar, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile dhe Kodit të Familjes. Procedura u zhvillua me praninë e psikologut, shërbimeve sociale dhe Policisë së Shtetit, duke garantuar respektimin e të drejtave të fëmijëve dhe zbatimin e ligjit. Takimi u realizua me sukses dhe palët u shprehën se takimet në vijim do të kryhen pa praninë e institucioneve. Veprimet përmbarrimore u dokumentuan sipas kërkesave ligjore përmes procesverbalit zyrtar.

Ky rast dëshmon profesionalizmin dhe ndjeshmërinë me të cilën përmbarruesit gjyqësorë trajtojnë çështjet që përfshijnë të mitur dhe të drejtat e tyre.

## Trajnim online për përmbarruesit në periudhë prove

Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarrimit zhvilloi një trajnim online për përmbarruesit gjyqësorë në periudhë prove, me fokus në çështje praktike dhe procedurale të veprimtarisë përmbarrimore.

Temat përfshinë njoftimin e debitorit, ekzekutimin e detyrimeve solidare dhe procedurën e ankandit nga sekuestrimi deri te vendosja në posedim të blerësit.

Gjithashtu, u trajtuan përgatitja dhe korrigjimi i akteve, aksesit në sistemin elektronik dhe trajtimi i transaksioneve financiare. Trajnimi synon forcimin e kapaciteteve profesionale dhe unifikimin e praktikës përmbarrimore.



## Zyra Vendore e Përmbarrimit Gjyqësor Shtetëror Mat, në ambientet e ish-Gjykatës së Rrethit Mat

Në zbatim të urdhrit nr. 277, datë 23.04.2025, të Ministrit të Drejtësisë, Zyra Vendore e Përmbarrimit Gjyqësor Shtetëror Mat do të ushtrojë veprimtarinë e saj administrative në ambientet e ish-Gjykatës së Rrethit Mat.

Kjo hapësirë, tashmë në administrim të zyrës përmbarrimore, do të shërbejë për një ofrim më cilësor të shërbimeve ndaj qytetarëve dhe përmbushjen e detyrave institucionale.

### ● Shërbime online të ofruara

Gjatë muajit maj, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarrimit ka vijuar ofrimin e shërbimeve online përmes platformës e-Albania, duke lehtësuar aksesin e qytetarëve dhe subjekteve publike e private në dokumentacionin përmbarrimor.

Në total janë lëshuar:

- 988 vërtetime për Detyrim Përmbarrimor
- 36 vërtetime për Pension Ushqimor

Këto shërbime synojnë të rrisin transparencën dhe efikasitetin në ofrimin e dokumentacionit zyrtar.

# BULETINI INFORMATIV

## DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT



### Takim për analizen e punës së Zyrave Përmbartimore Vendore Janar-Maj 2025

Drejtorja e Përgjithshme e Përmbartimit, e drejtuar nga z. Ergys Qirici, zhvilloi një takim pune me Kryetarët e Zyrave Vendore Përmbartimore për të analizuar performancën mujore të zyrave për periudhën janar-maj 2025, në funksion të ekzekutimit të titujve ekzekutivë. Këto analiza, të cilat do të zhvillohen çdo tre muaj, synojnë përmirësimin e shërbimit përmbartimor dhe do të fokusohen në:

- Vlerësimin e treguesve kryesorë të performancës, bazuar në të dhëna statistikore dhe financiare;
- Identifikimin e problematikave të hasura në praktikë dhe gjatë inspektimeve;
- Propozimin e zgjidhjeve konkrete për përmirësim.

Masat e parashikuara janë në përputhje me objektivat e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024-2030 dhe kanë për qëllim rritjen e eficiencës, transparencës dhe mbikëqyrjes në Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror.

Në përfundim të takimit, z. Qirici theksoi rëndësinë e përkushtimit të plotë në përmbushjen e misionit të shërbimit përmbartimor dhe zbatimit të planeve. Ai kërkoi gjithashtu që çdo zyrë të raportojë problematikën dhe të japë propozime konkrete për përmirësim në analizat e ardhshme.



### Nënshkruhet Memorandum Bashkëpunimi midis Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit dhe Shkollës së Magjistraturës

Në datën 10 qershor 2025, u nënshkrua një marrëveshje bashkëpunimi mes Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit dhe Shkollës së Magjistraturës, nga drejtori i Përgjithshëm i Përmbartimit, z. Ergys Qirici, dhe drejtori i Shkollës së Magjistraturës, z. Arben Rakipi.

Kjo marrëveshje synon forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe rritjen e kapaciteteve profesionale në sistemin e drejtësisë, me fokus të veçantë në përmirësimin e praktikave në fushën e përmbartimit dhe trajnimin e vazhdueshëm të punonjësve.

Bashkëpunimi do të përfshijë:

- Pjesëmarrjen e përmbartuesve dhe inspektorëve në trajnimet e organizuara nga Shkolla e Magjistraturës;
- Zhvillimin e konferencave, leksioneve të hapura dhe aktiviteteve të tjera të përbashkëta;
- Shkëmbimin e informacionit dhe analizave për të mbështetur përmirësimin e punës institucionale.

Të dy institucionet do të bashkëpunojnë ngushtë për zbatimin e kësaj marrëveshjeje, në funksion të arritjes së objektivave të përbashkëta.

## Kryetaret e Zyrave Vendore Përbarimore zhvilluan trajnim ne QKB

Kryetarët e Zyrave Vendore Përbarimore janë trajnuar në QKB për përdorimin e një shërbimi të ri në platformën e-Albania.

Ky shërbim ka për qëllim regjistrimin online të vendimeve dhe akteve të lëshuara nga gjykatat, zyrat përbarimore apo autoritete të tjera publike, të cilat lidhen me të dhënat e regjistruara ose me veprimtarinë e subjekteve tregtare.

Trajnimit synon të sigurojë zbatim të saktë dhe uniform të këtij shërbimi, në funksion të dixhitalizimit të procesit përbarimor dhe përmirësimit të shërbimeve për qytetarët dhe bizneset.



## Përmbillet me sukses trajnimi i përbaruesve të rinj shtetërorë

Në kuadër të zbatimit të Urdhrit nr. 433, datë 30.06.2023 të Ministrit të Drejtësisë, z. Ulsi Manja, Drejtoria e Përgjithshme e Përbarimit organizoi një trajnim intensiv për përbaruesit gjyqësorë shtetërorë në periudhë prove. Trajnimi përfshiu më shumë se 200 orë akademike dhe kërkimore në një periudhë 6-mujore, duke ofruar njohuritë e nevojshme për përgatitjen profesionale dhe ushtrimin cilësor të funksionit përbarimor.

e Përgjithshme e Përbarimit finalizoi fazën përgatitore të përbaruesve të rinj gjyqësorë shtetërorë. Në vijim, pas vlerësimit të arritjeve dhe përgatitjes së tyre profesionale, përbaruesit do të marrin emërimin përfundimtar nga Ministri i Drejtësisë, z. Ulsi Manja.



## Prezantohet Plan i punës 2025-2030 per uljen e stokut te dosjeve permbarimore te mbartura

Në kuadër të rritjes së eficiencës së sistemit përbarimor, është prezantuar Plan i Punës për vitet 2025-2030 me qëllim uljen e stokut të dosjeve përbarimore të mbartura në 22 Zyra Përbarimore Vendore. Aktualisht, një ndër problematikat më të theksuara është numri i lartë i çështjeve për gjyko penale, i cili kap shifrën 31,690 dosje.

Plan i përfshin 9 masa strategjike të cilat synojnë:

- Identifikimin dhe trajtimin me prioritet të çështjeve që kërkojnë zgjidhje të menjëhershme;
- Njoftimin e palëve kreditore dhe pezullimin e çështjeve kur mungon interesi për ndjekjen e ekzekutimit;
- Vlerësimin e çështjeve të paekzekutueshme për arsye objektive ose që lidhen me përfundimin e statusit ligjor të fëmijëve;
- Trajtimin e dosjeve pa pasuri të identifikueshme dhe me mungesë bashkëpunimi nga kreditorët;
- Zbatimin e akteve për amnistinë penale dhe administrative për subjektet përfituese;
- Vlerësimin e rasteve me objekt "shpenzime gjyqësore" kur detyrimi është minimal dhe nuk dihet vendndodhja e debitorëve;
- Trajtimin e dosjeve përbarimore të mbartura me objekt "lirim, dorezim sendi" ku mungon mbështetja institucionale IKMT
- Zbatimin e ligjit të ri për shfuqizimin e gjobave administrative për periudhën 2015-2024;
- Monitorimin dhe raportimin periodik çdo 6 muaj të zbatimit të këtij plani.

Objektivi final i planit është ulja me 25% e stokut të dosjeve përbarimore deri në vitin 2030.

Ky plan përfaqëson një qasje të strukturuar, ligjore dhe institucionale për të lehtësuar ngarkesën në sistemin përbarimor dhe për të përmirësuar eficiencën e shërbimit ndaj qytetarëve.

## Ekzekutim i suksesshëm përbarimor nga Zyra Përbarimore Shkodër

Pranë Zyrës së Përbarimit Shkodër u regjistrua një vendim gjyqësor për një pronë prej 9 dyqanesh, me sipërfaqe totale 2414 m<sup>2</sup>. Pas ndjekjes së të gjitha procedurave ligjore, përbaruesi gjyqësor arriti të zbatojë vendimin brenda 12 ditësh. Procesi përfundoi me firmosjen e procesverbalit nga të dyja palët dhe përmbylljen me sukses të çështjes. Ky është një shembull i rëndësishëm se si zbatimi i vendimeve gjyqësore mund të sjellë zgjidhje efektive në kohë dhe në përputhje me ligjin.

### • Shërbime online të ofruara



Gjatë muajit Qershor, Drejtoria e Përgjithshme e Përbarimit ka vijuar ofrimin e shërbimeve online përmes platformës e-Albania, duke lehtësuar aksesin e qytetarëve dhe subjekteve publike e private në dokumentacionin përbarimor.

Në total janë lëshuar:

- 1114 vërtetime për Detyrim Përbarimor
- 45 vërtetime për Pension Ushqimor





# DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT

## BULETINI INFORMATIV

### Zhvillohet provimi me shkrim për kandidatët për përmbarues gjyqësor

Në funksion të plotësimit të vendeve vakante për përmbarues gjyqësor shtetëror, Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror zhvilloi provimin me shkrim për kandidatët e kualifikuar. Provimi u mbajt në ambientet e Ministrisë së Drejtësisë, në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Thirrja për shprehje interesi u bë në zbatim të vendimeve të Këshillit të Përmbarimit dhe të akteve përkatëse që rregullojnë organizimin e procesit të pranimit. I gjithë procesi u zhvillua në mënyrë transparente dhe konform kriterëve të përcaktuara për organizimin, përmbajtjen dhe vlerësimin e provimit të pranimit.



### Zyra e Përmbarimit Durrës zhvillon takim pune me Shërbimin e Provës

Në ambientet e Zyrës Përmbarimore Vendore Durrës u zhvillua një takim pune ndërmjet Kryetares së Zyrës, znj. Mustafaj, dhe Drejtoreshës së Shërbimit të Provës Durrës, znj. Hoti. Takimi u organizua në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve në nivel qendror, me synimin për të forcuar bashkëpunimin institucional dhe për të përmirësuar koordinimin në zbatimin e vendimeve gjyqësore dhe mbikëqyrjen e ekzekutimeve alternative. Ky bashkëpunim synon të rrisë efikasitetin dhe integrimin në ofrimin e shërbimeve publike, në funksion të ligjshmërisë dhe drejtësisë.

### • Zyra e Përmbarimit Mat në një vendndodhje të re

Zyra e Përmbarimit Mat është zhvendosur në një vendndodhje të re, duke ofruar kushte më të përshtatshme për qytetarët dhe punonjësit. Shërbimi do të vijojë në ambientet e reja, të cilat ndodhen pranë ish-Gjykatës së Rrethit Mat.


### Zyra e Përmbarimit dhe Prokuroria Gjirokastrë në takim për koordinimin e ekzekutimit të vendimeve penale

Në kuadër të bashkëpunimit institucional për përmirësimin e ekzekutimit të vendimeve penale, Zyra e Përmbarimit Gjirokastrë mori pjesë në një takim ndër-institucional të organizuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Në takim ishin të pranishëm përfaqësues të Prokurorisë, Shërbimit të Provës Gjirokastrë dhe Përmet, si dhe Kryetarja e Zyrës së Përmbarimit Gjirokastrë, znj. Brenzina Balili. Diskutimet u fokusuan në problematikat që lidhen me zbatimin e vendimeve penale, veçanërisht dënimet alternative, si dhe në rritjen e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve përkatëse. U theksua nevoja për koordinim më të mirë, efikasitet më të lartë në procedura dhe përcaktim të qartë të detyrimeve të secilës palë. Takimi përfundoi me dakordësi për të vijuar me takime të rregullta, në funksion të forcimit të komunikimit dhe zbatimit më efektiv të drejtësisë penale.



## Takim pune në Zyrën e Përmbartimit Sarandë për zbatimin e marrëveshjes me Shërbimin e Provës

Në ambientet e Zyrës Përmbartimore Sarandë, u zhvillua një takim pune ndërinstucional ndërmjet Kryetarit të Zyrës, z.Stroka dhe Drejtoreshës së Shërbimit të Provës Sarandë, znj. Gramozi si dhe Specialistes Znj. Viola Iljazi.



Takimi u zhvillua në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit, me qëllim forcimin e bashkëpunimit institucional dhe përmirësimit e koordinimit në funksion të zbatimit të vendimeve gjyqësore.

## Zyra e Përmbartimit Gjirokastrë merr pjesë në ceremoninë e nënshkrimit të Kartës Evropiane për Barazi Gjinore

Me ftesën për pjesëmarrje nga Bashkia Dropull, Zyra e Përmbartimit Gjirokastrë së bashku me institucione të qarkut, mori pjesë në ceremoninë e nënshkrimit të Kartës Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Vendore, një dokument kyç që promovon përfshirjen e barazisë gjinore në të gjitha nivelet e vendimmarrjes dhe shërbimeve publike. Ky aktivitet u zhvillua me mbështetjen e UN Women dhe fondeve të Bashkimit Evropian, në kuadër të projektit "Bashkimi Evropian për Barazinë Gjinore në Shqipëri II". Ky angazhim i përbashkët synon të nxisë një qeverisje vendore më të drejtë, barazi dhe respekt për të drejtat e qytetarëve në të gjitha proceset përmbartimore dhe ligjore.

## Takim për zbatimin e marrëveshjes me Shërbimin e Provës



U zhvillua një takim pune ndërmjet Zyrës së Përmbartimit Permet dhe Shërbimit të Provës. U diskutua bashkëpunimi për informimin dhe ndërgjegjësimin e të dënuarve me masa alternative për detyrimet financiare të papaguara.



Në ambientet e Zyrës së Përmbartimit Gjirokastrë u zhvillua një takim pune me përfaqësues të Drejtorisë Vendore të Shërbimit të Provës, në vijim të marrëveshjes së bashkëpunimit. Qëllimi i këtij bashkëpunimi është forcimi i mekanizmave për mbikëqyrjen e të dënuarve me masa alternative dhe zbatimi i vendimeve gjyqësore, nëpërmjet informimit dhe orientimit të tyre për shlyerjen e detyrimeve.



Zyra e Përmbartimit Pukë ka zhvilluar takim pune me zyren Shërbimit të Provës Lezhë për ofrimin e shërbimeve sa më efektive ndaj individëve që i nënshtrohen masave alternative ndaj dënimit me burgim si dhe përmbushja me efikasitet e detyrimeve që rrjedhin nga vendimet gjyqësore. Palët u angazhuan për vijimin e bashkëpunimit përmes takimeve periodike.

## Zyra Përmbartimore Lezhë në takim koordinues me Shërbimin e Provës



Në Zyrën e Përmbartimit Lezhë u zhvillua një takim me përfaqësues të Shërbimit të Provës, në kuadër të marrëveshjes për bashkëpunim institucional. Diskutimet u fokusuan në informimin e të dënuarve me shërbim prove për detyrimet financiare dhe udhëzimin e tyre për pagesat. Palët u angazhuan për koordinim më të ngushtë në funksion të zbatimit të ligjit.

### • Shërbime online të ofruara

Gjatë muajit Korrik, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit ka vijuar ofrimin e shërbimeve online përmes platformës e-Albania, duke lehtësuar aksesin e qytetarëve dhe subjekteve publike e private në dokumentacionin përmbartimor. Në total janë lëshuar:

1. 1296 vërtetime për Detyrim Përmbartimor
2. 26 vërtetime për Pension Ushqimor

## DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT

### ZBATIM I AMNISTISË: NUK EKZEKUTOHEN GJOBAT E PANDEMISË

- Drejtori i Përgjithshëm i Përmbaarimit, z.Ergys Qirici, në një intervistë për Top Channel bëri të ditur se një pjesë e rreth 49 mijë dosjeve të përmbaarimit nuk do të ekzekutohen, përfshirë gjobat e vendosura gjatë pandemisë që nuk ishin ekzekutuar nga institucionet, si rezultat i amnistisë së miratuar.



### ZHVILLOHET FAZA E DYTË E PROVIMIT PËR KANDIDATËT PËR PËRMBARUES GJYQËSOR

- Në vijim të plotësimit të vendeve vakante për përmbaarues gjyqësorë shtetërorë, mbas provimit me shkrim, Shërbimi Përmbaarimor Gjyqësor Shtetëror zhvilloi dhe provimin me gojë për kandidatët e kualifikuar. Provimet u organizuan në ambientet e Ministrisë së Drejtësisë, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Procesi u zhvillua në mënyrë transparente sipas kriterëve të përcaktuar për organizimin dhe vlerësimin e kandidatëve.



### TAKIM PËR ZBATIMIN E MARRËVESHJES ME SHËRBIMIN E PROVËS

- Në ambientet e Zyrës së Përmbaarimit Korçë u zhvillua një takim pune me përfaqësues të Drejtorisë Vendore të Shërbimit të Provës, në vijim të marrëveshjes së bashkëpunimit. Qëllimi i këtij takimi është forcimi i mekanizmave për mbikëqyrjen e të dënuarve me masa alternative dhe zbatimi i vendimeve gjyqësore, nëpërmjet informimit dhe orientimit të tyre për shlyerjen e detyrimeve.
- Në Zyrën e Përmbaarimit Lushnje u zhvillua një takim me përfaqësues të Shërbimit të Provës, në kuadër të marrëveshjes për bashkëpunim institucional. Diskutimet u fokusuan në informimin e të dënuarve me shërbim prove për detyrimet financiare dhe udhëzimin e tyre për pagesat. Palët u angazhuan për koordinim më të ngushtë në funksion të zbatimit të ligjit.



### ANKESA TË TRAJTUARA

Gjatë muajit Gusht, janë trajtuar 27 ankesa të adresuara pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Përmbaarimor Gjyqësor Shtetëror, 2 ankesa të administruara përmes Sistemit të Menaxhimit të Ankesave (Platforma e Bashkëqeverisjes). Për secilën prej ankesave, qytetarëve u është ofruar informacioni i nevojshëm dhe dokumentacioni përkatës në lidhje me veprimtarinë procedurale të kryer nga strukturat përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet e transparencës institucionale.

## ZYRAT PËRMBARIMORE NË TAKIM KOORDINUES ME SHËRBIMIN E PROVËS

- ▶ Zyra e Përmbarimit Krujë ka zhvilluar takim pune me zyren Shërbimit të Provës Krujë për ofrimin e shërbimeve sa më efektive ndaj individëve që i nënshtrohen masave alternative ndaj dënimit me burgim, si dhe përmbushja me efikasitet e detyrimeve që rrjedhin nga vendimet gjyqësore. Palët u angazhuan për vijimin e bashkëpunimit përmes takimeve periodike.
- ▶ Në ambientet e Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës Kurbin u zhvillua një takim pune me Zyrën Përmbarimore Vendore Kurbin, në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit. Takimi u fokusua te koordinimi për njoftimin dhe ndjekjen e personave nën mbikëqyrje dhe krijimi i një linje të drejtpërdrejtë komunikimi ndërmjet institucioneve. U diskutua gjithashtu raportimi i përbashkët mbi ekzekutimin e vendimeve gjyqësore penale dhe shlyerjen e shpenzimeve gjyqësore.
- ▶ Në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës dhe Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror, Zyra Përmbarimore Vendore Kukës zhvilloi sot një takim pune me Degën e Shërbimit të Provës Kukës mbi nevojën për një bashkëpunim ndërinstytucional në ofrimin e shërbimeve më efektive dhe përmbushjen e objektivave ligjore, me qëllim ekzekutimim e titujve ekzekutive penal.
- ▶ Në datën 13.08.2025, Zyra Përmbarimore Berat zhvilloi takimin me Drejtorinë Vendore të Shërbimit të Provës. Dy objektivat kryesore të takimit ishin diskutimi i problematikave të hasura në shkëmbimin e informacioneve në lidhje me zbatimin e vendimeve gjyqësore dhe forcimi i bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve.
- ▶ Në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit, Zyra Përmbarimore Mat zhvilloi një takim pune me zyrën vendore të Shërbimit të Provës Mat, me qëllim forcimin e bashkëpunimit institucional dhe koordinimin e veprimeve në funksion të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore për personat që janë nën mbikëqyrje nga Shërbimi i Provës, por që janë njëkohësisht edhe në proces ekzekutimi nga Shërbimi Përmbarimor.



## SHËRBIME ONLINE TË OFRUARA

Gjatë muajit Gusht, Zyrat Vendore Përmbarimore kanë vijuar ofrimin e shërbimeve online përmes platformës e-Albania, duke lehtësuar aksesin e qytetarëve dhe subjekteve publike e private në dokumentacionin përmbarimor. Në total janë lëshuar:

1279 vërtetime për Detyrim Përmbarimor

12 vërtetime për Pension Ushqimor

...



Shtator 2025

# BULETINI INFORMATIV

## DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT

### Takim për analizën e dytë të punës së Zyrave Përmbarimore Vendore

Në ambjentet e Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit, nën drejtimin e Drejtorit të Përgjithshëm z. Ergys Qirici, u zhvillua analiza e tretë e punës për vitin 2025. Në fokus të diskutimit ishin ulja e dosjeve përmbarimore të mbartura, arritja e objektivave të Strategjisë së Drejtësisë 2024-2030, evidentimi i çështjeve me "gjoja penale" që përfitojnë nga Ligji për Amnistinë dhe i atyre me "gjoja administrative" që trajtohen sipas ligjit "Për shfuqizimin e masave administrative". Në perfundim të mbledhjes u diskutua edhe draft-formatin e ri statistikor të zyrave vendore përmbarimore. Këto mbledhje periodike synojnë transparencë dhe një shërbim më efikas në funksion të qytetarëve.



### Rritje e ekzekutimeve dhe masa të reja për transparencë e mbrojtje të përmbaruesve

Drejtori i Përgjithshëm i Përmbarimit, z. Ergys Qirici, në një intervistë për RTSH, bëri të ditur se është shënuar rritje e dosjeve të ekzekutuara dhe të ardhurave krahasuar me një vit më parë. Ai theksoi se, në kuadër të ndryshimeve të Kodit të Ri Penal, është propozuar mbrojtje e veçantë për përmbaruesit gjyqësorë. Për muajt në vijim, bazuar në Strategjinë Ndërsëktoriale të Drejtësisë 2024-2030, janë ndërmarrë masa për uljen e stokut të dosjeve, rritjen e transparencës dhe të performancës së përmbaruesve.



### Institucionet diskutojnë përmirësimin e proceseve në ASHK

Agjencia Shtetërore e Kadastrës, në bashkëpunim me Ministrin e Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, znj. Adea Pirdeni, zhvilloi tryezën e rrumbullakët "Vlerësimi i riskut të integritetit në ASHK". Në aktivitet morën pjesë institucione vendase e ndërkombëtare, ku përfaqësuesit e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror kontribuan me ide për rritjen e transparencës dhe përmirësimin e proceseve.



### Ankesa të trajtuara gjatë muajit Shtator

Janë trajtuar 16 ankesa të adresuara pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit, 3 ankesa të administruara përmes Sistemit të Menaxhimit të Ankesave (Platforma e Bashkëqeverisjes).

Për secilën prej ankesave, qytetarëve u është ofruar informacioni i nevojshëm dhe dokumentacioni përkatës në lidhje me veprimtarinë procedurale të kryer nga strukturat përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet e transparencës institucionale.

## Zyrat Përmbaremore në takim koordinues me Shërbimin e Provës

Në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit, Zyra Përmbaremore Fier zhvilloi një takim pune me Zyrën Vendore të Shërbimit të Provës. Qëllimi i takimit ishte forcimi i bashkëpunimit institucional dhe koordinimi i veprimeve për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore ndaj personave që janë nën mbikëqyrjen e Shërbimit të Provës dhe njëkohësisht në proces ekzekutimi nga Shërbimi Përmbaremore.

Në ambientet e Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës u zhvillua një takim pune me Zyrën Përmbaremore Shkodër. Diskutimet u përqendruan në koordinimin për njoftimin dhe ndjekjen e personave nën mbikëqyrje, si dhe krijimin e një kanali të drejtpërdrejtë komunikimi mes institucioneve. Gjithashtu, u trajtua raportimi i përbashkët mbi ekzekutimin e vendimeve gjyqësore penale dhe shlyerjen e shpenzimeve gjyqësore.



## Zyra Përmbaremore Mat pjesëmarrës në nismën për barazine gjinore

Zyra Përmbaremore Vendore Mat mori pjesë në aktivitetin e zhvilluar në Bashkinë Klos, me rastin e firmosjes së Kartës Europiane për Barazinë e Grave dhe Burrave në Jetën Vendore. Ky moment i rëndësishëm, i mbështetur nga UN Women dhe Bashkimi European, synon nxitjen e barazisë gjinore dhe forcimin e rolit të grave në vendimmarrjen vendore. Pjesëmarrja e Zyrës Përmbaremore Vendore Mat në këtë nismë thekson angazhimin e institucionit për të mbështetur parimet e barazisë, të drejtësisë sociale dhe forcimit të bashkëpunimit me institucionet vendore dhe partnerët ndërkombëtarë.

## Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional për rastet e dhunës në familje

Zyra e Përmbaremit Tiranë mori pjesë në takimin me temë "Qasja Ndërinstitucionale dhe Përmirësimi i Menaxhimit të Rasteve të Dhunës në Familje", organizuar nga Qendra "Strehëza Edlira Haxhiymeri" në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë. Gjatë diskutimeve u theksuan sfidat që shfaqen në menaxhimin e rasteve të dhunës në familje, si dhe u evidentuan pikat e forta dhe boshllëqet në bashkëpunimin ndërinstitucional. Qëllimi kryesor ishte forcimi i koordinimit mes institucioneve për të garantuar shërbime më efikase dhe mbrojtje më të mirë për viktimat.



## Shërbime online të ofruara

Gjatë muajit Shtator, Zyrat Vendore Përmbaremore kanë vijuar ofrimin e shërbimeve online përmes platformës e-Albania, duke lehtësuar aksesin e qytetarëve dhe subjekteve publike e private me dokumentacionin përmbaremore.

Në total janë lëshuar:

1325 vërtetime për Detyrim Përmbaremore

51 vërtetime për Pension Ushqimor



## DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT



Me mbështetjen e Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsion dhe në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme Antikorrupsion, u zhvillua një tryezë diskutimi mbi vlerësimin e Planit të Veprimit për Menaxhimin e Riskut të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Përfaqësues i Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbaramit në këtë tryeze kërkoi që në këtë plan veprimi të këtë parashikime edhe mbi arritjen e një marrëveshje ndërinstitucionale sa i përket zbatimit të urdhrave të sekuestrove konservative, në funksion të ekzekutimit të titujve ekzekutiv.



Përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbaramit morën pjesë në takimin për zbatimin e Strategjisë Ndërsëktoriale të Drejtësisë, për periudhën janar-qershor 2025. Gjatë takimit u diskutua mbi ecurinë e masave të parashikuara në strategji, arritjet dhe sfidat në drejtim të rritjes së efikasitetit të drejtësisë dhe forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional. Në raportin përfundimtar, Drejtoria e Përgjithshme e Përmbaramit u vlerësua për realizimin e një sërë masash të rëndësishme, si lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me Shkollën e Magjistraturës, Urdhrin e Psikologut dhe Shërbimin e Provës, si dhe për organizimin e trajnimeve profesionale për përmbaruesit gjyqësorë.



Zyra e Përmbaramit Tiranë ishte e pranishme në tryezën e rrumbullakët me temë "Gjykata në Mbrojtje të Viktimave: Studim mbi vendimet gjyqësore në çështjet e dhunës në familje". Gjatë këtij takimi u prezantuan gjetjet kryesore të studimit me aktorët kyç institucionalë dhe shoqërisë civile. Përfaqësuesit e Zyrës së Përmbaramit Tiranë sugjeruan që vendimet gjyqësore në pjesën e arsyetimit dhe të dispozitivit të kenë përcaktime të qarta dhe konkrete për të gjitha palët e përfshira, në mënyrë që ekzekutimi të jetë më efikas në ndihmë të viktimave të dhunës.



e institucioneve në garantimin e mbrojtjes së tyre ligjore dhe sociale.

Në kuadër të 11 Tetorit- Ditës Ndërkombëtare të Vajzave, Zyra Përmbartimore Gjirokastrë në bashkëpunim me Zyrën e Ndihmës Juridike Gjirokastrë dhe Zyren e Shërbimit të Provës, zhvilluan një takim ndërgjegjësuës me synim nxitjen e respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të vajzave të mitura në shoqërinë tonë. Gjatë këtij takimi u diskutua mbi sfidat që hasin vajzat e mitura në fushën e arsimit, sigurisë, drejtësisë dhe mundësive të barabarta, si dhe mbi rolin



Gjatë muajit Tetor, Zyrat Vendore Përmbartimore kanë vijuar ofrimin e shërbimeve online përmes platformës e-Albania, duke lehtësuar aksesin e qytetarëve dhe subjekteve publike e private me dokumentacionin përmbartimor. Në total janë lëshuar: 1511 vërtetime për Detyrim Përmbartimor 99 vërtetime për Pension Ushqimor



Gjatë muajit Tetor janë trajtuar -- ankesa të adresuara pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimit, 2 ankesa të administruara përmes Sistemit të Menaxhimit të Ankesave (Platforma e Bashkëqeverisjes). Për secilën prej ankesave, qytetarëve u është ofruar informacioni i nevojshëm dhe dokumentacioni përkatës në lidhje me veprimtarinë procedurale të kryer nga strukturat përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet e transparencës institucionale.



në forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, duke synuar zgjidhje më të shpejta, më efikase ndaj dhunës.

Zyra e Përmbartimit Tiranë ishte e pranishme në takimin "Nga Kuadri Ligjor në Zbatim Efektiv: Forcimi i Bashkëpunimit Ndërinstitucional dhe Shoqërisë Civile ndaj Dhunës në me Bazë Gjinore në Bashkinë Tiranë". Ky aktivitet u realizua nga Instituti për Zhvillim Strategjik në kuadër të projektit "Shëndet, Drejtësi dhe Mbrojtje Efektive për Gratë dhe Vajzat Viktimë të Dhunës në Familje dhe Dhunës me Bazë Gjinore në Bashkitë Tiranë dhe Kukës". Qëllimi i këtij aktiviteti ishte kalimi nga kuadri ligjor tek zbatimi praktik, duke vënë theksin



NËNTOR 2025

# BULETINI INFORMATIV

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT

## Bashkëpunimi me emisionin "Ligj dhe Drejtësi" për informacion ligjor ndaj qytetarëve

Është nënshkruar marrëveshja midis Drejtorit të Përgjithshëm të Përmbarimit, z. Ergys Qirici, dhe moderatorës së emisionit "Ligj dhe Drejtësi" znj. Blerina Hamzollari, në Radio Tirana. Me pjesëmarrjen e përfaqësuesëve Shërbimit Përmbarimor gjatë puntatave të emisionit, do t'u ofrojmë dëgjuesve informacion të saktë dhe profesional mbi vendimet gjyqësore dhe mënyrën e ekzekutimit të tyre. Ky emision shërben si një kanal i drejtpërdrejtë komunikimi me qytetarët, duke u dhënë atyre përgjigje të qarta, të bazuara në ligj dhe në kohë reale.



## Drejtori i Përgjithshëm z. Ergys Qirici në konferencën 'Nga procedura te mbrojtja reale': Hapësira miqësore dhe zbatimi i vendimeve për fëmijët

Në konferencën "Nga procedura te mbrojtja reale- drejtësia që i shërben fëmijëve", organizuar nga Terre des hommes dhe Agjensia Austriake për Zhvillim, ishte i pranishëm edhe Drejtori i Përgjithshëm i Përmbarimit, z. Ergys Qirici, i cili trajtoj rëndësinë e zbatimit të vendimeve gjyqësore që përfshijnë fëmijët, si takimet me prindin dhe pensionet ushqimore.

Ai njoftoi edhe krijimin e hapësirave miqësore për fëmijët në Zyrën Përmbarimore Tiranë, me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë, si dhe zgjerimin e këtij modeli në të gjitha zyrat vendore.



## Zyra Përmbarimore Tiranë në takimin e Mekanizmit të Referimit për Dhunën në Familje

Në Bashkinë Tiranë u zhvillua mbledhja e Mekanizmit të Referimit për Dhunën në Familje, ku morën pjesë edhe përfaqësues të Zyrës Përmbarimore Tiranë.

Takimi kishte qëllim forcimin e bashkëpunimit mes institucioneve dhe ndërtimin e hapave konkretë për të përmirësuar reagimin dhe mbështetjen ndaj rasteve të dhunës në familje.



## Shërbime online të ofruara



Gjatë muajit Nëntor, Zyrat Vendore Përmbarimore kanë vijuar ofrimin e shërbimeve online përmes platformës e-Albania, duke lehtësuar aksesin e qytetarëve dhe subjekteve publike e private me dokumentacionin përmbarimor. Në total janë lëshuar:

**1232 vërtetime për Detyrim Përmbarimor**

**32 vërtetime për Pension Ushqimor**

## Zyra Përmbartimore Gjirakastër në fushatën “16 Ditët kundër Dhunës”

Zyra Përmbartimore Gjirakastër mori pjesë në aktivitetin ndërgjegjëses të organizuar me rastin e 25 Nëntorit, Ditës Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave, duke shënuar nisjen e fushatës globale “16 Ditët e Aktivizimit kundër Dhunës me Bazë Gjinore”.

Përfaqësuesit e Zyrës Përmbartimore theksuan rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional për identifikimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës, si dhe nevojën për të krijuar një mjedis të sigurt dhe mbështetës për viktimat.

Gjatë diskutimeve u ndanë sfidat aktuale dhe u theksua angazhimi i përbashkët për të forcuar mekanizmat e mbrojtjes në komunitet.



## Zyra Përmbartimore Mat në takimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit

Zyra Përmbartimore Vendore Mat mori pjesë në takimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit në Bashkinë Klos, organizuar nga ACPD në bashkëpunim me UNFPA-në.

Në takim u diskutua mbi sfidat në trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe me bazë gjinore, si dhe rëndësia e zbatimit të procedurave standarde dhe protokolleve për ofrimin e një shërbimi sa më efektiv dhe të koordinuar.

## Shërbimi Përmbartimor i prezantuar në emisionin “Ligj dhe Drejtësi” në Radio Tirana

Përfaqësuesja e Shërbimit Përmbartimor znj. Lorena Xhymerti mori pjesë në emisionin “Ligj dhe Drejtësi” në Radio Tirana. Ajo shpjegoi në mënyrë të qartë si funksionon institucioni dhe cilat janë hapat kryesorë të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore.

Gjatë intervistës, u dhanë këshilla praktike për qytetarët dhe u sqaruan pyetjet e dëgjuesve që telefonuan në studio. Ky komunikim synon t'i informojë qytetarët më mirë dhe t'i ndihmojë të kuptojnë procedurat përmbartimore.



## Zyra Përmbartimore Kurbin në takimin mbi monitorimin e vendimeve gjyqësore

Zyra Përmbartimore Kurbin mori pjesë në takimin e zhvilluar në Bashkinë Kurbin, ku u prezantua raporti i monitorimit të vendimeve gjyqësore që lidhen me krimet seksuale dhe veprën penale të përndjekjes.

Takimi përfshiu gjithashtu përfaqësues të institucioneve zbatuese në nivel vendor dhe kishte si qëllim përmirësimin e koordinimit dhe zbatimit të vendimeve gjyqësore.



DHJETOR 2025

## DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT

# BULETINI INFORMATIV

### Inaugurohet Hapësira Miqësore për fëmijët pranë Zyrës Përmbartimore Tiranë

Është inauguruar hapësira e re miqësore për fëmijët pranë Zyrës Përmbartimore Tiranë, e konceptuar për të rritur sigurinë dhe mbështetjen e fëmijëve gjatë procedurave me objekt "Takim fëmijë". Projekti, i realizuar nga Terre des Hommes Albania me mbështetjen e Agjencisë Austriake për Zhvillim, përfshin rikonstruksionin e ambientit dhe ofrimin e mbështetjes psikologjike falas për fëmijët në nevojë. Ky investim përbën një hap të rëndësishëm në kuadër të Strategjive Ndërsektoriale të Drejtësisë dhe synon shtrirjen e modeleve të ngjashme edhe në zyra të tjera përmbartimore.



### Pjesëmarrje në Konferencë Kombëtare për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve

Zyra Përmbartimore Tiranë mori pjesë, përmes përfaqësuesve të saj, në Konferencën Kombëtare "Strehëzat – Një jetë e sigurt për gratë dhe fëmijët që i mbijetojnë dhunës: Nga mbrojtja drejt fuqizimit të qëndrueshëm". Konferenca shërbeu si një platformë dialogu mes institucioneve shtetërore, organizatave të shoqërisë civile, mediave dhe partnerëve ndërkombëtarë. Fokusi i diskutimeve ishte garantimi i sigurisë, mbështetjes psikosociale dhe krijimi i rrugëve të qëndrueshme drejt fuqizimit për gratë dhe fëmijët viktimë të dhunës.



042400321




[www.dpp.gov.al](http://www.dpp.gov.al)



## Pjesëmarrje në Mekanizmin e Referimit kundër Dhunës në Familje - Durrës

Zyra e Përmbarrimit Durrës mori pjesë, me ftesë të Bashkisë Durrës, në Mbledhjen e Komitetit Drejtues të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit, në kuadër të fushatës "16 Ditët e Aktivizmit kundër Dhunës me Bazë Gjinore". Takimi shërbeu si një hap i rëndësishëm për forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe përmirësimit të mekanizmave të bashkërendimit në trajtimin e rasteve të dhunës në familje.



## Forcim i Bashkëpunimit Ndërinstitucional kundër Dhunës në Familje - Mat

Zyra Përmbarrimore Mat mori pjesë në aktivitetin e organizuar në kuadër të forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, nga Zyra për Djem dhe Burra, në bashkëpunim me Qendrën "Gruaja tek Gruaja" dhe Bashkinë Mat. Synohet forcimi i koordinimit ndërinstitucional dhe promovimin e një qasjeje të integruar, që përfshin edhe trajtimin e autorëve të dhunës si pjesë e mbrojtjes së viktimave dhe fuqizimit të familjes.



## Trajnim Profesional për Përmbarruesit Gjyqësorë në Periudhë Prove



Përmbarruesit e rinj gjyqësorë në periudhë prove ndjekin programin 6-mujor të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarrimit. Programi përfshin rreth 200 orë leksionesh dhe veprimtarish kërkimore, të orientuara drejt përgatitjes dhe zhvillimit profesional.

## Përmbyllja e Fushatës "16 Ditët e Aktivizmit" në Bashkinë Mat

Zyra Përmbarrimore Mat mori pjesë në aktivitetin përmbjllës të fushatës "16 Ditët e Aktivizmit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore", të zhvilluar në Bashkinë Mat.



Në aktivitet u përfshinë të rinj, aktivistë dhe përfaqësues të institucioneve pjesë e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje.

## Ankesa të trajtuara

Gjatë muajit Dhjetor janë trajtuar 5 ankesa të adresuara pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarrimit, 2 ankesa të administruara përmes Sistemit të Menaxhimit të Ankesave (Platforma e Bashkëqeverisjes). Për secilën prej ankesave, qytetarëve u është ofruar informacioni i nevojshëm dhe dokumentacioni përkatës në lidhje me veprimtarinë procedurale të kryer nga strukturat përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet e transparencës institucionale.

## 11. OBJEKTIVAT PËR VITIN 2026

Në përmbushje të misionit institucional dhe në zbatim të Ligjit nr. 8/2023 "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror", si dhe dokumenteve strategjike kombëtare për drejtësinë (SND, SDMVK, SNDM), Drejtoria e Përgjithshme e Përmbartimit ka hartuar objektivat e punës për vitin 2026, të cilat do të udhëheqin veprimtarinë e institucionit gjatë vitit 2026, në funksion të rritjes së eficiencës, ligjshmërisë, profesionalizmit dhe besimit të publikut në shërbimin përmbartimor gjyqësor shtetëror.

OBJEKTIVI NR. 1. Rritja e eficiencës në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore përmes zbatimit të planeve të punës, analizës së shkaqeve të vonesave dhe përmirësimit të organizimit të veprimtarisë përmbartimore.

**Rritja e eficiencës në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore përmes zbatimit të planeve të punës, analizës së shkaqeve të vonesave dhe përmirësimit të organizimit të veprimtarisë përmbartimore.**

| Masat                                                                                                                                                                          | Produkti                                                                                                                                               | Spektori Përgjegjës             | Afati                                                                                      |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Masa 1.1 Zbatimi Planit të Punës për uljen e numrit të dosjeve përmbartimore të mbartura, përfshirë ndjekjen periodike të ecurisë së ekzekutimit të vendimeve gjyqësore</b> | Rritja e numrit të dosjeve përmbartimore të mbartura të ekzekutuara dhe me zgjidhje ligjore.<br><br>Ulja e stokut të dosjeve përmbartimore të mbartura | 22 Zyrtat Vendore Përmbartimore | 3- mujtari i I-rë,<br>3-mujtari i II-të,<br>3 mujtari i III-të,<br>3 mujtari i IV-të, 2026 |
| <b>Masa 1.2 Monitorimi i Planit të Punës për uljen e numrit të dosjeve</b>                                                                                                     | Raportet mujore periodike mbi monitorimin e Planit të Punës për uljen e numrit të dosjeve përmbartimore të                                             | Drejtoria e Inspektimit         | 3- mujtari i I-rë,<br>3-mujtari i II-të,<br>3 mujtari i III-të,<br>3 mujtari i IV-të, 2026 |

|                                                                                                                           |                                                                                              |                               |                                                                                        |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Masa 1.3 Hartimi, përditësimi dhe ndjekja e analizave mbi shkaqet e vonesave në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore,</b> | Raporte analitike periodike mbi shkaqet e mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore              | Drejtoria e Inspektimit       | 3- mujori i I-rë,<br>3-mujori i II-të,<br>3 mujori i III-të,<br>3 mujori i IV-të, 2026 |
| <b>Masa 1.4 Ndërmarrja e masave korrigjuese për përmirësimin e eficiencës</b>                                             | Plan masash korrigjuese për përmirësimin e eficiencës së ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. | 22 Zyrat Vendore Përmbarimore | 3- mujori i I-rë,<br>3-mujori i II-të,<br>3 mujori i III-të,<br>3 mujori i IV-të, 2026 |

OBJEKTIVI NR. 2. Ngritja e kapaciteteve profesionale të shërbimit përmbarimor gjyqësor shtetëror nëpërmjet trajnimeve fillestare dhe vazhduese, si dhe përditësimit të programeve të formimit

| <b>Ngritja e kapaciteteve profesionale të shërbimit përmbarimor gjyqësor shtetëror nëpërmjet trajnimeve fillestare dhe vazhduese si dhe përditësimit të programeve të formimit</b> |                                                                                                                                          |                                                              |                                                                                        |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Masat</b>                                                                                                                                                                       | <b>Produkti</b>                                                                                                                          | <b>Sektori Përgjegjës</b>                                    | <b>Afati</b>                                                                           |
| <b>2.1 Vlerësimi periodik i nevojave për trajnim vazhdues dhe trajnim i specializuar sipas fushave. (Ref. SND)</b>                                                                 | Raport vlerësimi periodik mbi nevojat për trajnim fillestar dhe vazhdues të përmbaruesve gjyqësorë dhe trajnim të punonjësve mbështetës. | 22 Zyrat Vendore Përmbarimore<br><br>Drejtoria e Inspektimit | 3- mujori i I-rë,<br>3-mujori i II-të,<br>3 mujori i III-të,<br>3 mujori i IV-të, 2026 |
| <b>2.2 Trajnimi vazhdues i punonjësve të shërbimit përmbarimor gjyqësor lidhur me procedurat e</b>                                                                                 | Raporte për realizimin e trajnimeve.                                                                                                     | Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse                           | 3- mujori i I-rë,<br>3-mujori i II-të,<br>3 mujori i III-të,<br>3 mujori i IV-të, 2026 |

|                                                                                                                                                                                          |                                                                                                              |                                    |                                                                                        |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>ekzekutimit (Ref SND)</b>                                                                                                                                                             |                                                                                                              |                                    |                                                                                        |
| <b>2.3 Rishikimi dhe përditësimi i programeve të trajnimit të punonjësve të shërbimit të përmbarimit gjyqësor për procedurat e ekzekutimit (Ref SND)</b>                                 | Programe trajnimi të rishikuara dhe të përditësuara për procedurat e ekzekutimit.                            | Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse | 3- mujori i I-rë,<br>3-mujori i II-të,<br>3 mujori i III-të,<br>3 mujori i IV-të, 2026 |
| <b>2.4 Vlerësimi dhe përditësimi i programeve të formimit fillestar dhe vazhdues nga çdo përmbarues që ekzekuton vendime të urdhrave të mbrojtjes, (punon me viktimat). (Ref. SNMVK)</b> | Programe formimi fillestar dhe vazhdues për përmbaruesit që ekzekutojnë urdhrat e mbrojtjes                  | Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse | 3- mujori i I-rë,<br>3-mujori i II-të,<br>3 mujori i III-të,<br>3 mujori i IV-të, 2026 |
| <b>2.5 Evidentimi i programeve të formimit fillestar dhe vazhdues që adresojnë çështjet e viktimave të krimit (Ref. SDMVK)</b>                                                           | Raport evidentues i programeve të formimit që adresojnë çështjet e viktimave të krimit (urdhrat e mbrojtjes) | Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse | 3- mujori i I-rë,<br>3-mujori i II-të,<br>3 mujori i III-të,<br>3 mujori i IV-të, 2026 |
| <b>2.6 Rishikimi i programit fillestar dhe vazhdues nga çdo zyrë që punon</b>                                                                                                            | Programe formimi të rishikuara dhe të përditësuara nga përmbaruesit që                                       | Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse | 3- mujori i I-rë,<br>3-mujori i II-të,<br>3 mujori i III-të,<br>3 mujori i IV-të, 2026 |

|                                                                                                                  |                                 |  |  |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------|--|--|
| <b>me/për viktimat e krimit me qëllim përditësimin e programeve sipas problemeve të evidentuara. (Ref SDMVK)</b> | ekzekutojnë urdhrat e mbrojtjes |  |  |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------|--|--|

OBJEKTIVI NR. 3: Forcimi i menaxhimit të burimeve njerëzore të shërbimit përmbartimor gjyqësor shtetëror, përmes identifikimit të nevojave, ndjekjes së procedurave të rekrutimit dhe plotësimit të vendeve vakante

